MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS



RAPORT PËR GJENDJEN E NATYRËS
2015-2017

Prishtinë, 2019

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

RAPORT PËR GJENDJEN E NATYRËS

2015-2017

Prishtinë, 2019

"Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi për secilin"

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Të nderuar lexues,

Njeriu është pjesë e natyrës dhe jo zotërues i saj, andaj edhe kërkesat dhe interesat e tij duhet të jenë në harmoni me ligjet e natyrës dhe me balancën ekologjike të saj.

Trashëgimia natyrore e një vendi është një ndër pasuritë më të rëndësishme të tij. Parqet Kombëtare, ekosistemet pyjore, monumentet e natyrës dhe burimet ujore, përveç që janë vendbanime të shumë llojeve të rralla bimore e shtazore dhe që bartin në vete shumë fenomene e dukuri të rralla e interesante gjeologjike, morfologjike, hidrologjike e peizazhore janë edhe burime të rëndësishme për zhvillim ekonomik, mirëqenie shoqërore, edukim dhe rekreacion. Me gjithë këtë, shfrytëzimi i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i këtyre vlerave dhe burimeve natyrore, mund të sjellë dëme të pariparueshme të cilat do të kenë për pasojë edhe zhdukjen e llojeve të rralla bimore dhe shtazore dhe dëmtimin e fenomeneve të rralla natyrore.

Duke u nisur nga ky fakt, institucionet e Kosovës kanë vënë në kuadër të prioriteteve të tyre, mbrojtjen dhe konservimin e vlerave të rralla të trashëgimisë natyrore. Sot, Kosova ka 11.5 % të territorit të saj të mbrojtur me ligj, në kuadër të së cilit përfshihen zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme si: rezervatet strikte të natyrës, parqe kombëtare, parqe të natyrës, peizazhe, monumente të natyrës si dhe zona tjera natyrore më rëndësi të veçantë. Gjithashtu, me qëllim të menaxhimit më efikas dhe të qëndrueshëm të këtyre vlerave përveç hartimit të legjislacionit përkatës në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit janë hartuar edhe strategji, plane të veprimit, plane hapësinore, plane menaxhuese (disa në proces) si dhe programe qoftë për natyrën e Kosovës në përgjithësi ose për zona të caktuara në veçanti. Me qëllim të promovimit të vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës dhe sensibilizimit të opinionit të gjerë për rëndësinë e tyre, ato janë bërë pjesë jo vetëm e projekteve dhe iniciativave nacionale por edhe e projekteve regjionale dhe ndërkombëtare. Përkundër kësaj, nevojitet edhe më tej angazhim i vazhdueshëm i të gjitha institucioneve dhe organizatave të tjera por edhe i gjithë shoqërisë sonë për te mbrojtur dhe konservuar këto vlera natyrore dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme për të mirën e gjeneratave të sotme dhe të atyre që do të vijnë.

Dr.sc. Ilir Morina
Kryeshef ekzekutiv i AMMK-së

PËRMBAJTJA

1. PJESA HYRËSE 14
1.1. Karakteristikat e përgjithshme të Kosovës 1.2. 14
Qëllimi i raportit 16
1.3. Historiku i mbrojtjes së natyrës në Kosovë 17

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E NATYRËS 18
2.1. Korniza ligjore 18
2.1.2. Aktet nënligjore të miratuara 18
2.1.3. Aktet në procedurë 2015 – 2017 20
2.1.4. Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve komunale 20
2.1.5. Lejet dhe licencat për mbrojtjen e natyrës që janë lëshuar nga DMMU 21

3. KORNIZA INSTITUCIONALE 22
3.1. Organet vendimmarrëse 22
3.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitet 2011- 2020 23

4. KLASIFIKIMI I ZONAVE TË MBROJTURA 26
4.1. Rezervat Strikt Natyrës 26
4.2. Park Kombëtar 26
4.3. Zona e Veçantë e Mbrojtur 27
4.4. Park i Natyrës 27
4.5. Monument i Natyrës 27
4.6. Peizazh i Mbrojtur 28
4.7. Monument i Arkitekturës së Parkut 28

5. KRONOLOGJIA E ZONAVE TË MBROJTURA 29

6. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS 30

6.1. REZERVATET STRIKTE 31
6.1.1. Lëndina e Shenjtë 32
6.1.2. Shutmani 32
6.1.3. Bredhiku 33
6.1.4. Pashallarë 34
6.1.5. Gryka 35
6.1.6. Lumbardhi 36
6.1.7. Luboteni 36
6.1.8. Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit 37
6.1.9. Koritniku 38
6.1.10. Kobilica 39
6.1.11. Dupnica 39
6.1.12. Bistra 40
6.1.13. Malet e Prilepit 41

6.1.14. Gubavci 42
6.1.15. Rusenica 42
6.1.16. Oshlaku 43
6.1.17. Maja e Arnenit 44
6.1.18. Pisha e Madhe 45
6.1.19. Kamilja 46
6.1.20. Gjendja ekzistuese e rezervateve strikte 47
6.1.21. Rekomandimet 50

6.2. PARKU KOMBËTAR "SHARRI" 51
6.2.1. Gjendja e resurseve natyrore në Prakun Kombëtar "Sharri" 51
6.2.2. Ekosistemet pyjore 51
6.2.3. Ekosistemet barishtore 52
6.2.4. Zonat e para të mbrojtjes – Zonat strikte natyrore 53
6.2.5. Resurset ujore 54
6.2.6. Fauna 55
6.2.7. Masat sanitare për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve 56
6.2.8. Zonat turistike dhe ndërtimet në PK "Sharri" 57
6.2.9. Sfidat dhe problemet në Parkun Kombëtar "Sharri" 58
6.2.10. Rekomandimet 59

6.3. PARKU KOMBËTAR "BJESHKËT E NEMUNA" 61
6.3.1. Gjendja e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 62
6.3.2. Hartimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 69
6.3.3. Sfidat dhe problemet në menaxhimin e Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 70
6.3.4. Rekomandimet 70

6.4. ZONAT E VEÇANTA – ZVM dhe ZVR 72
6.4.1. Ligatina e Hencit/Radeves 72
6.4.2 Gjendja 73
6.4.3. Rekomandimet 74

6.5. PARK NATYRE 74
6.5.1. Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës 74
6.5.2. Rekomandimet 75

6.6. MONUMENTET E NATYRËS 76
6.6.1. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" 76
6.6.2. Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushës 79
6.6.3. Bifurkacioni i Lumit Nerodime 81
6.6.4. Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit 84
6.6.5. Muzeu i kristaleve 85
6.6.6. Gryka e Rugovës dhe Shpella Gryka e Madhe 87
6.6.7. Ndërhyrjet në Monumentet e Natyrës 89

6.7. PEIZAZHET E MBROJTURA **91**
6.7.1. Peizazhi i mbrojtur "Gërmia" 91
6.7.2. Peizazhi i mbrojtur "Shkugza" 95

7. ZONAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJE **98**

8. ZONAT TJERA TË MBROJTURA **99**
8.1. Zonat Natura 2000 100
8.2. Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë 101
8.2.1. Vendgjuetia me rëndësi të veçantë "Blinaja"
8.2.2. Vendgjuetia me rëndësi të veçantë "Duboçaku" 102
8.2.3. Pylli i Arinjëve – Prishtina 104

9. BIODIVERSITETI **106**
9.1. Biodiversiteti 106
9.1.1. Gjendja e biodiversitetit 106
9.1.2. Flora 106
9.1.3. Vegjetacioni 108
9.1.4. Gjendja e faunës 110
9.1.5. Monitorimi i llojeve të rrezikuara të gjitarëve në Parqet Kombëtare 111

10. PYJET E KOSOVËS **114**
10.1. Gjendja e ekosistemeve pyjore në Kosovë 115
10.2. Menaxhimi i ekosistemeve pyjore dhe sfidat 119
10.3. Konkluzionet dhe rekomandimet 121

11. EKOTURIZMI **123**
11.1. Ekoturizmi i zonave të mbrojtura

12. PROJEKTET NACIONALE DHE TË FINANCUAR NGA DONATORËT **126**
12.1. Shënjezimi i Monumenteve të Natyrës (MMPH) 126
12.2. Libri i Kuq i Faunës (SIDA) 126
12.3. Rritja e Menaxhimit të Zonave Ndërkufitare Natyrore 127
12.4. Inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazëve, tipat e vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre 127
12.5. Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Biodiversiteti (ORF-BD) 128
12.6. Projekti BORN - BORderless Nature (Mbrojtja dhe Zhvillimi i Biodiversitetit të Parqeve Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Prokljetije") 129
12.7. Bashkëpunimi me Shoqatën Evropiane "Brezi i Gjelbër" 131
12.8. Bashkëpunimi me Univerzitetin e Konstanzës 132
12.8.1. Shkolla Verore 2015-2017 132
12.8.2. Unazimi i Shpendëve 133
12.9. Projekti i Zonës së Pyjeve të Ahut të Vjetër 134
12.10. Ekspeditë Hulumtuese Speleologjike 135

13. MASAT E NDERMARRA PËR MBROJTJEN E NATYRËS 136
13.1. Inspektimi i zonave të mbrojtura 136
13.2. Procedurat kundërvajtës në fushën e mbrojtjes së natyrës 2015-2017 137
13.3. Rajonet Bio-Gjeografike 138

14. PJESMARRJA NË AKTIVITETET PËR MBROJTJEN E NATYRËS 140
14.1. Aktivitetet e organizuara nga MMPH dhe partneret e saj 140
14.1.1. Shënimi i Ditës Ndërkombëtarë të Biodiversiteti (2015) 140
14.1.2. Shënimi i Ditës Ndërkombëtarë të Biodiversiteti (2017) 140
14.2. Raportimi në EEA/EIONET 141
14.3. Pjesmarrje në Konferencën e 9-të Pan-Evropiane e Brezit të Gjelbër 141
14.4. Pjesëmarrje në vizitën studimore në Austri, Itali dhe Slloveni (SIDA Programi Mjedisor Për Kosovën 2017) 142
14.5. Pjesëmarrje në punëtorinë "Gjeoparqet e Evropës Juglindore" 143
14.6. Pjesemarrja në Vizitën Studimore në Itali në kuadër të Projektit BorN 143

15. KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET 144

16. REFERENCAT 146

17. SHTOJCA I: Harta e Zonave të Mbrojtura 149
18. SHTOJCA II: Lista e Zonave të Mbrojtura në Kosovë (2017) 150
19. SHTOJCA III: Vendimi për aprovimin e raportit për gjendjen e natyrës 2015-2017 162

Treguesi i shkurtesave

AKP	*Agjencioni Kosovar i Privatizimit*
AMMK	*Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës*
APK	*Agjencioni Pyjor i Kosovës*
BDTF	*Task Forca e Biodiversitetit*
BE	*Bashkësia Evropiane*
BIMR	*Rrjeti Rajonal për Menaxhimin e Informacionit të Biodiversitetit dhe Raportimin*
BKK	*Buxheti i Konsoliduar i Kosovës*
BMZ	*Bashkëpunimi Ekonomik dhe Zhvillimor*
BORN	*Vlerat Natyrore Ndërkufitare*
CDDA	*Baza e të dhënave të përbashkëat mbi zonat e caktuara*
CITES	*Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara*
DAPK	*Drejtoria e Administritmi të Parkut Kombëtar*
DMMU	*Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujrave*
DPK	*Drejtoria e Parkut Kombëtar*
ECRAN	*Rrjeti Regjional Mjedisi dhe Klima*
EEA	*Agjencioni Evropian i Mjedisit*
EIONET	*Rrjeti Evropian i Sistemit të Informimit dhe Mbikqyerjes*
EKMN	*Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës*
ENVSEC	*Nisma për Sigurinë dhe Mjedisin*
ERA	*Organizata Joqeveritare Mjdisore*
ERASMUS	*Bashkëpunimi i Komunitetit Europian me Studentët Universitar*
ESAV	*Vlerësimi i Shërbimeve të Ekosistemit*
EUNIS	*Organizimi i Sistemeve të Informacionit të Universitetit Evropian*
EURING	*Unioni Evropian për Unazim*
FAO	*Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (Food and Agriculture Organisation)*
FOUR PAWS	*Fondacioni Austriak për Mbrojtjen e Kafshëve*
FSHMN	*Fakultetit i Shkencave Matematike dhe Natyrore*
GIS	*Sistemi i Informatave Gjeografike*
GIZ	*Bashkëpunimi Teknik Gjerman*
GPS	*Sistemi i Pozicionit Gjeografik*
GZK	*Gazeta Zyrtare e Kosovës*
GZRK	*Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*
IKMN	*Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës*
IPA	*Instrument për Ndihmë Para-antarësimit*
IPH	*Instituti për Planifikim Hapësinor*
ISCC	*Sekretariati i Përkohshëm i Konventës së Karpateve*
IUCN	*Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës*
JICA	*Agjensioni Japonez për Bashkëpunim Ndërkombëtar*

KEERC	*Qendra për Edukim dhe Hulumtim Mjedisor në Kosovë*
KPMM	*Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve*
MAPL	*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
MASHAV	*Agjensioni Izraelit për Zhvillim dhe Bshkëpunim Ndërkombëtar*
MAVA	*Fondacioni Norvegjez*
MBPZHR	*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural*
MMPH	*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
MNRV	*Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë*
MZHE	*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*
OJQ	*Organizata Joqeveritare*
OKB	*Organizata e Kombeve të Bashkuara*
ORF-BD	*Fondi i Hapur Rajonal i Evropës Juglindore për Biodiversitetin*
PK	*Park Kombëtar*
PKVM	*Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis*
RCC	*Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit*
REC	*Qendra Rajonale e Mjedisit*
SIDA	*Agjensioni Sudez për Zhvillim*
SKM	*Strategjia e Kosovës për Mjedis*
TAIEX	*Instrumenti për Ndimë Teknike dhe Shkëmbim të Infromacioneve*
TEM	*Menaxhimi i Ekosistemeve Ndërkufitare*
UNDP	*Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim*
UNEP	*Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin*
UNSECO	*Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë*
UP	*Universiteti i Prishtinës*
VGJRV	*Vendgjueti me Rëndësi të Veçantë*
VIER PFOTEN	*Fondacioni për Mbrojtjen e Kafshëve*
VNM	*Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis*
WWF	*Fondacioni i Kafshëve të Egra*
ZVM	*Zonë e Veçantë e Mbrojtjes*
ZVR	*Zonë e Veçantë e Ruajtjes*

Treguesi i tabelave

		Faqe
Tabela 1.	*Harmonizimi me Direktivat e Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes së natyrës*	*25*
Tabela 2.	*Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2017)*	*31*
Tabela 3.	*Prerja e pyjeve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 2015-2017*	*63*
Tabela 4.	*Numri i vizitorëve në Monumentin e Natyrës me Rendësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" 2014-2017*	*77*
Tabela 5.	*Zonat e mbrojtura që i kanë humbur vlerat natyrore*	*90*
Tabela 6.	*Objektet e trashëgimisë natyrore në Komunën e Gjakovës*	*98*
Tabela 8.	*Zjarret në pyje 2015-2017*	*116*
Tabela 9.	*Zonat e inspektuara gjatë vitit 2017*	*137*
Tabela 10.	*Inicimet e procedurave kundërvajtëse në fushën e mbrojtjes së natyrës 2015-2017*	*138*
Tabela 11.	*Zonat e Mbrojtura (2017)*	*150*

Treguesi i figurave

		Faqe
Figura 1.	*Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2017*	*29*
Figura 2.	*Harta e Rezervateve Strikte*	*49*
Figura 3.	*Harta e zoonimit të Parkut Kombëtar "Sharri"*	*54*
Figura 4.	*Harta e zoonimit të PK "Bjeshkët e Nemuna"*	*69*
Figura 5.	*Zona e* propozuar për *mbrojtur (Bifurkacionit i Nerodimes)*	*83*
Figura 6.	*Natyra 2000 bazë e Direktivës së Zogjëve dhe Direktivës së Habitateve*	*99*
Figura 7.	*Llojet bimore me status ndërkombëtar në PK "Sharr"*	*107*
Figura 8.	*Rrezikshmëria e llojeve bimore*	*108*
Figura 9.	*Harta e Web-GIS-it e realizuar në kuadër të projektit rrjeti ekologjik ndërkufitar*	*131*
Figura 10.	*Harta e Brezit të Gjelbër*	*131*
Figura 11.	*Harta e Regjioneve Biogjeografike*	*139*
Figura 12.	*Performanca e përgjithshme e shteteve në raportimin e vitit 2017*	*141*
Figura 13.	*Harta e Zonave të Mbrojtura*	*149*

Treguesi i fotove

Foto 1.	*Panja e heldrahut (Pinus heldreichii)*	*32*
Foto 2.	*Bornmullera e dieckit (Bornmullera dieckii)*	*32*
Foto 3.	*Genciana pranverore (Gentiana verna L.)*	*33*
Foto 4.	*Mëlaka e maleve (Geum montuam)*	*33*
Foto 5.	*Arunku dioik (Aruncus dioicus)*	*33*
Foto 6.	*Lulekambana gjetheshumë (Campanula foliosa)*	*33*
Foto 7.	*Sanëza (Gerntina lutea)*	*35*
Foto 8.	*Zambaku shqiptar (Lilium albanicum)*	*35*
Foto 9.	*Telekia e ukur (Telekia speciosa)*	*35*
Foto 10.	*Klokëza e rëndomtë (Silene vulgaris)*	*35*
Foto 11.	*Karafili i Sharrit (Dinathus scardicus)*	*36*
Foto 12.	*Barpezmi i ndarë shumë (Achillea multifidia)*	*36*
Foto 13.	*Burgulli (Sempervivum hirtum*	*37*
Foto 14.	*Gencianza bullgare (Gentianella bulgarica)*	*37*
Foto 15.	*Rrëqebulli në Rezervati Strikt "Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit"*	*37*
Foto16.	*Bashkësia pyjore e Rrobullit (Pinetum heldreichii)*	*38*
Foto 17.	*Habitat i llojeve të rralla të bimëve kalcifite dhe hezmofite*	*39*
Foto18.	*Pajme nga Rezervati Strikt "Dupnica"*	*40*
Foto19.	*Pajme nga Rezervati Strikt "Bistra"*	*41*
Foto 20.	*Rusenica - Habitat i Rreqebullit (Lynx lynx)*	*43*
Foto 21.	*Oshlaku-Habitat i Rrobillit (Pinus Heldreichii) & (Rupicapra rupicapra)*	*44*
Foto 22.	*Bashkësitë pyjore të Rrobullit (Pinus heldreihii) & Ahut (Fagus montanum)*	*45*
Foto 23.	*Pisha e Madhe - Shqiponja e minjve (Buteo buteo)*	*46*
Foto 24.	*Nderhyrjet në Rezervatet Strikte*	*48*
Foto 25.	*Dëmët pyjore nga zjarret në pyjet e rrobullit në Koritnik*	*52*
Foto 26.	*Kullosat e maleve të larta në PK. "Sharri", Restelicës*	*53*
Foto 27.	*Zona e veçantë "Prrocka e Durlës"*	*55*
Foto 28	*Nderhyrjet në Prrockës së Durlës për hidrocentral*	*55*
Foto 29.	*Ariu i murrmë dhe dhija e egër në PK "Sharri"*	*56*
Foto 30.	*Ski qendra "Brezovica"*	*58*
Foto 31.	*Peizash nga PK "Bjeshkët e Nemuna"*	*61*
Foto 32.	*Prerjet e pyjeve brenda territorit të PK "Bjeshkët e Nemuna".*	*63*
Foto 33.	*Ndërtimet ilegale në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"*	*64*
Foto 34.	*Aktiviteti i gurthyesve brenda territorit të PK "Bjeshkët e Nemuna"*	*65*
Foto 35.	*Rrëshqitja nga hapja e rrugëve në PK "Bjeshkët e Nemuna"*	*66*
Foto 36.	*Ndërtimi i hidrocentrali në Grykën e Deçanit, PK "Bjeshkët e Nemuna".*	*67*
Foto 37.	*Ligatina e Hencit - Radevës*	*72*
Foto 38.	*Bilbilthi fushor i kallamave*	*73*
Foto 39.	*Gakthi*	*73*
Foto 40.	*Kokoçel i Koshaninit*	*74*

Foto 41.	*Kokoçel i purpurt i errët*	*74*
Foto 42.	*Mali Pashtrik dhe Kanioni i Drinit të Bardh*	*75*
Foto 43.	*MNRV Shpella e Gadimes*	*77*
Foto 44.	*Ujëvarat e lumit Mirusha*	*80*
Foto 45 .	*Ndërtimet ilegale në MNRV "Ujëvarat e Mirushës"*	*81*
Foto 46.	*Bifurkacioni i lumit Nerodime*	*82*
Foto 47.	*Drini i Bardh dhe Shpella e Radacit*	*84*
Foto 48	*Objekti i Muzeut*	*86*
Foto 49.	*Kristalet në Muze*	*86*
Foto 50.	*Gryka e Rugovës*	*87*
Foto 51.	*Hulumtimi i korridoreve dhe i galerive te reja në shpellën e Gryka e Madhe*	*88*
Foto 52.	*Trungu i Qarrit (Quercus cerris L) në Drenovc*	*89*
Foto 53.	*Shkatërrimi i hapësirës mbi shpellën e Temeqines*	*89*
Foto 54.	*Dëmtimi i Trungut të Plepit në Gërdoc*	*89*
Foto 55.	*Dëmtimi i tabela informuese*	*90*
Foto 56.	*Bashkësia pyjore e ahut (Fagetum moesiacum montanum)*	*92*
Foto 57.	*Vingjra lulemadhe (Lathyrus grandiflorus)*	*93*
Foto 58.	*Koeloglosi i blertë(Coeloglossum iride)*	*93*
Foto 59.	*Ptilostemi i pirpiktë(Ptilostemen strictus)*	*93*
Foto 60.	*Kokëzogëza (Anguis fragilis)*	*93*
Foto 61.	*Bilbili (Luscinia megarhynchos)*	*93*
Foto 62.	*Peizazhi i mbrojtur "Shkugza"*	*95*
Foto 63.	*Micropterna lateralis*	*96*
Foto 64.	*Triturus vulgaris*	*96*
Foto 65	*Fauna në vendgjuetin "Blinaja"*	*102*
Foto 66.	*Përkujdesja për Arinjtë*	*105*
Foto 67.	*Keqpërdorimi i bimëve mjekësore*	*107*
Foto 68.	*Dëmtimet e vegjetacionit pyjor në kuadër të zonave të mbrojtura*	*109*
Foto 69.	*Shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos)*	*110*
Foto70.	*Hardhuca e mureve (Podarcis muralis)*	*110*
Foto 71.	*Aglais urticae*	*111*
Foto 72.	*Calopteryx splendens*	*111*
Foto 73.	*Mmonitorimi i faunës me kamera kurth*	*111*
Foto 74.	*Vendosja e kamerave kurthe*	*112*
Foto 75.	*Fotot e Rrëqebullit ballkanik të hasura me kamerën kurth*	*113*
Foto 76	*Nga regjistrimet e kamerave kurthe*	*113*
Foto 77.	*Zone e propozuar per rezervat te rrëqebullit*	*113*
Foto 78.	*Pyjet e ahut dominojnë në Sharr*	*115*
Foto 79.	*Pyjet halor në Bjeshkët e Nemuna*	*115*
Foto 80.	*Pasojat e prerjeve ilegale në zonën e Firajës*	*117*
Foto 81.	*Dëmët pyjore nga fatkeqësia natyrore, në Sharr*	*117*
Foto 83.	*Insekti dëmtues vemja e pishës*	*118*
Foto 84.	*Veshtulla (Viscum album) në bredhin*	*118*
Foto 85.	*Tturizmi malor gjatë dimrit (foto Hiking njeri)*	*124*

Foto 86.	*Turizmi rekreativ dhe sportiv (hiking njeri)*	*125*
Foto 87.	*Shenjëzimi i monumenteve të natyrës*	*126*
Foto 88.	*Punë në terren dhe unazimit të shpezëve*	*133*
Foto 89.	*Unazimi i llojeve të ndryshme të shpendëve të egër*	*134*
Foto 90.	*Nga takimi i Nivelit Kombëtar në Ministrinë e Mjedisit, në Bon*	*135*
Foto 91	*Ekspedita hulumtuese Speleologjike*	*136*
Foto 92.	*Shënimi i ditës ndërkombëtarë te biodiversiteti 2015-2016*	*140*
Foto 93.	*Shënimi i ditës ndërkombëtarë të biodiversiteti*	*140*
Foto 94.	*Pjesmarraja në Konferencën e 9-të Pan-Evropiane e Brezit të Gjelbër*	*142*
Foto 95.	*Parku Kombëtar "Hohe Tauern" Austri*	*142*
Foto 96.	*Punëtoria për Gjeoparqet në Slloveni*	*143*

1. PJESA HYRËSE

1.1. Karakteristikat e përgjithshme të Kosovës

Rajoni: Evropa Juglindore

Gjerësia: 41 51' 21 dhe 43 16' Gjatësia: 19 59' dhe 21 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Sipërfaqja: 10,908 km^2

Popullsia: 1,771,604 (2015 e vlerësuar)

Dendësia e popullsisë: 162 banorë në $1km^2$

Gjatësia e përgjithshme e kufirit: 743. 5 km

Gjatësia e kufijve: Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror .

- Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim 113.5 km
- Republikën e Maqedonisë në jug 170.7 km
- Republikën e Malit të Zi në veri-perëndim 79.1 km
- Republikën e Serbisë në veri dhe lindje 380.1 km

Relievi: kodrinorë-malorë

- 63 % kodrinorë-malorë
- 37% fushorë

Lartësia mesatare mbidetare: 810 m

- Pika me e ulët 270 m (luginën e Drinit të Bardhë, në kufi me Shqipërinë)
- Pika më e lartë 2656 m (maja e Gjeravicës)

Klima: e mesme kontinentale

Lumi më i gjatë: Drini i Bardhë 111.5 km

Liqeni kryesor: Ujmani (Gazivodë) 9.10 km^2

Numri i zonave të mbrojtura: 184 (2017)

Sipërfaqja e zonave të mbrojtura (2017) sipërfaqja 126119 ha

- ***Rezervate strikte:*** 19, (10885 ha)
- ***Parqe kombëtarë:*** 2, (115957 ha)
- ***Monument Natyre:*** 156, (6059 ha)
- ***Park Natyre:*** 1, (5934 ha)
- ***Peizazh i Mbrojtur:*** 5, (2437 ha)
- ***Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve*** 1 (109 ha)

Zonat biogjeografike: kontinentale dhe alpine

- Zona kontinentale 90% të sipërfaqes së Kosovës
- Zona alpine 10% të sipërfaqes së Kosovës

Pyjet: sipërfaqja e përgjithshme 481000 ha (44 %)

- Pyjet e larta: 24%
- Pyjet e mesme: 62%
- Shkurre: 14%

Flora: mbi 3000 lloje të florës vaskulare

Fauna: rreth 350 lloje të kurrizorëve, (220 lloje të shpendëve, rreth 20 lloje te reptilëve, mbi 10 lloje te ambifeve, mbi 30 lloje të peshqëve) dhe rreth 600 lloje të pakurrizorëve (prej tyre rreth 180 lloje të flutrave).

Numri i komunave: 38

Numri i vendbanimeve: 1469

1.2. Qëllimi i raportit

Hartimi i Raportit për gjendjen e natyrës në Kosovë, është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës e rregulluar sipas Ligjit për Mbrojtje e Natyrës, nenit 142.

Qëllimi kryesor i raportit është informimi i publikut për gjendjen e natyrës, zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit të Kosovës, mirëpo përmes këtij raporti, synohet të ndikohet edhe në përmirësimin e politikave për menaxhimin dhe konservimin e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit. Ky raport mund të shërbejë edhe si një udhëzues i mirë për orientimin e projekteve dhe mbështetjes së donatorëve në sektorin e mbrojtjes së natyrës.

Raporti përmban të dhëna për kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale në sektorin e natyrës, gjendjen e zonave të mbrojtura të natyrës, biodiversitetin, llojet e rralla bimore e shtazore, ekosistemet pyjore, ekoturizmi, ndërhyrjet në zonat e mbrojtura dhe aktivitetet e realizuar me qëllim të mbrojtjes së natyrës. Pjesë e rëndësishme e raportit janë edhe masat e ndërmarra për mbrojtjen e natyrës, konkluzionet dhe rekomandimet.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë mbledhur gjatë vizitave në terren nga IKMN, nga organet menaxhuese të zonave të mbrojtura, si dhe institucione tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Pjesë e Raportit janë edhe informatat nga ligjet, strategjitë, publikimet, raportet dhe dokumentet tjera relevante për sektorin e mbrojtjes së natyrës.

Të dhënat e Raportit i referohen periudhës 2015-2017, mirëpo në disa raste në mungesë të të dhënave dhe për aspekte të krahasimit, janë prezantuara të dhëna edhe për periudhat e më hershme.

1.3. Historiku i mbrojtjes së natyrës në Kosovë

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të 50 - ta. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës. Në vitin 1974 me Vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, themelohet Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, i cili vazhdoi punën me të njëjtin emër sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut. Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit.

Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës", me seli në Prishtinë. Në maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe në kuadër të tij përfshihen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Mali Sharr".

Pas formimit të organeve qeverisëse të Kosovës (2001) formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Në vitin 2002 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.2002/8 (Rreg.2003/22) ku sipas këtij Ligji është paraparë që të themelohet Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, dhe në kudër të tij të përfshihet Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Instituti Hidrometeorologjik.

Në vitin 2006 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Rreg. 2006/22), sipas këtij Ligji, Instituti kryen punët e mbrojtjes së natyrës (neni 9 paragrafi 2). Ne vitit 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës.

Nga viti 2006 në kuadër te AMMK ka vepruar sektori për mbrojtjen e natyrës, ndërsa në vitin 2013 ri themelohet Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Aktualisht, detyrat dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e natyrës realizohet përmes Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i cili vepron në kuadër të AMMK-së, me staf të pamjaftueshëm vetëm me katër (4) zyrtarë.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E NATYRËS

2.1. Korniza ligjore

Mbrojtja e Natyrës bazën themelore e ka në Kushtetutën e Republikës së Kosovës ku në nenin 52 theksohet përgjegjësia për mjedisin. Kuadri ligjor ekzistues për mbrojtjen e natyrës gjatë periudhës 2015 - 2017 është përmirësuar dhe plotësuar me disa akte nënligjore konform kërkesave për harmonizim me bazën ligjore të BE-së.

Në kuadër të obligimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 – 2010, gjatë kësaj periudhe janë miratuar tetëmbëdhjetë (18) vendime nga Qeveria e Kosovës, po ashtu janë miratuar tri (3) Udhëzime Administrative dhe katër (4) Vendime të Ministrit të cilat kanë ndikim në mbrojtjen e natyrës.

2.1.2 Aktet nënligjore të miratuara

- Udhëzimi Administrativ i MMPH, Nr. 02/15 për Lejimin e Zbatimit të Hulumtimeve Shkencore në Natyrë (03.03.2015);
- Udhëzim Administrativ Nr. 03/2016 MMPH për caktimin e tarifave për lëshimin e pëlqimeve, lejeve, licencave, certifikatave dhe vërtetimeve të parapara me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës (11.08.2016);
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 12/2017 për shpalljen e llojeve të egra strikt të mbrojtura (22.08.2017)
- Vendimi i Ministrit Nr. 54/2015, për vënien nën Mbrojtje Paraprake të një pjese të Malit Pashtriku dhe Liqenit të Vërmicës, si zonë potenciale për shpallje Vlerë e Mbrojtur e Natyrës në kategorinë e Parkut të Natyrës (13.11.2015);
- Vendimi i Ministrit Nr. 55/2015 për vënien nën Mbrojtje Paraprake të Zonës së Bifurkacionit të Lumit Nerodime, si zonë potenciale për shpallje, Vlerë e Mbrojtur e Natyrës në kategorinë e Monumentit të Natyrës të Rëndësisë së Veçantë (13.11.2015);
- Vendimi i Ministrit Nr. 514/15 për Miratimin e Listës së Kuqe të Florës Vaskulare të Kosovës (04.02.2015);
- Vendimi i Ministrit Nr. 1212/15 për miratimin e Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar "Sharri" (17.03.2015);
- Vendim i QRK-së Nr. 01/74 për vënien nën mbrojtje strikte të pyjeve të pastra të Arnenit të kuq (*Pinus heildrichii*), në "Pisha e Madhe" pjesë e masivit malor Koxha Ballkan PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 02/74 për vënien nën mbrojtje strikte të pyjeve të pastra të Arnenit të Kuq (*Pinus heildrechii*) në "Maja e Arnenit", PK "Sharri"(10.02.2016);

- Vendim i QRK-së Nr. 03/74 për vënien nën mbrojtje strikte të pyjeve të pastra të Arnenit të Kuq (*Pinus heildrechii)* në "Oshlak" PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.04/74 për vënien nën mbrojtje strikte të vendbanimit natyror të Rrëqebullit ballkanik *(Lynx lynx balcanicus*) në "Rusenicë", PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.05/74 për vënien nën mbrojtje strikte të vendbanimit natyror të llojit të mbrojtur Forzicia (*Forsythia europea)* "Gubavci" në PK "Bjeshkët e Nemuna"(10.02.2016)*;*
- Vendim i QRK-së Nr. 06/74 për vënien nën mbrojtje strikte të Panja e heldrahit (*Acer heildreichii*) dhe Arneni (*Pinus peuce*), në "Malet e Prilepit" në PK "Bjeshkët e Nemuna" (10.02.2016);
- Vendim i QRK –së Nr. 07/74 për vënien në mbrojtje strikte të "Bjeshkës së Kozhnjerit" – Maja e Ropsit në PK ,"Bjeshkët e Nemuna" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 08/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës malore "Bistra" PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 09/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës malore "Dupnica" PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 10/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës malore "Kobilica" PK "Sharri"(10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 11/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës malore "Luboteni" PK "Sharri"(10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 12/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës së burimit dhe ujërrjedhjes së epërme të „Lumbardhit" PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr. 13/74 për vënien në mbrojtje strikte të zonës malore që karakterizohet me bashkësinë Fageto - Taxetum baccata - bashkësia e rëndësishme autoktone pyjore të reliktit terciar tisit (*Taxus baccata*) me ahun (*Fagus mosaicae)* në "Gryka", PK "Sharri"(10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.14/74 për vënien nën mbrojtje strikte të pyjeve endemorelikte të rrobullit *(Pinus heildreichii)* dhe vegjetacionet barishtore të pasura me bimë të rralla dhe endemike në "Koritnik", PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.15/74 për vënien nën mbrojtje strikte të zonës së maleve të larta në serpentin me ekosistemet e rralla dhe specifike pyjore të rrobullit (*Pinus heildrichii*), arnenit (*Pinus peuce*), bredhit (*Abies alba*), hormoqit (*Picea abies*) dredhakut (*Pinus mugo*) dhe ahut (*Fagus moesiaca*) në "Pashallare", PK "Sharri" (10.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.16/74 për vënien nën mbrojtje të vendbanimit natyror të llojit të veçantë të Bredhit maqedonas (*Abies borisi - regis*) dhe Ariut të murrmë (*Ursus arctos*) në "Bredhik", PK "Sharri" (16.02.2016)*;*

- Vendim i QRK-së Nr.17/74 për vënien nën mbrojtje strikte të zonës së maleve të larta në silikat që karakterizohet me vlera të veçanta biologjike, gjeologjike, gjeomorfolgjike, hidrografike dhe peisazhore në "Shutman" PK "Sharri" (16.02.2016);
- Vendim i QRK-së Nr.18/74 për vënien nën mbrotje strikte të zonës malore në serpentin dhe habitat i llojit stenoendemik Bornmullera e Dieckit (*Bornmuelleria diecki*) në "Lëndina e Shenjtë" PK "Sharri"(16.02.2016);
- Vendimi i MMPH-së Nr. 142/2016, datë 14.09.2016 dhe konkluzioni Nr. 152/2016, datë 29.09.2016 për themelimin e grupit koordinues ndërinstitucional për themelimin e rrjetit NATURA 2000. Grupi Punues është sqaruar për detyrat dhe ka miratuar termat e referencës;
- Vendimi Nr.20/2016 i MMPH-së për tarifat e kompensimit, veprimet e lejuara, masat për parandalimin e dëmeve dhe kriteret shtesë për përcaktimin e kompensimit për dëmin e shkaktuar nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura tek kafshët shtëpiake (02.09.2016);
- Licencimi i personave fizik dhe juridik për hartimin e raportit për vlerësimin dhe kompensimin e dëmit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura (10.11.2016);
- Vendimi i KK të Prishtinës për ri kategorizimin e Parkut Rajonal Natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i Mbrojtur (18.01.2017);
- Vendim Nr.23/2017 për llojet e egra të mbrojtura për të cilat lejohet marrja nga natyra dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm (25.04.2017).

2.1.3. Aktet në procedurë 2015 – 2017

Plani i Veprimit për Biodiversitet 2016 - 2020 (i miratuar 30.05.2018);

Koncept dokumenti për përmirësimin e menaxhimit të parqeve kombëtare në Kosovë;

Hartimi i Planit Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna";

Hartimi i Planit Menaxhues për PK "Bjeshkët e Nemuna";

Vendimi i Komunës së Ferizajt për kategorizimin e Bifurkacionit të Lumit Nerodime.

2.1.4 Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve komunale

Në bazë të kërkesës së MAPL, Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të kuvendeve komunale për 46 monumente natyrore dhe për një peizazh të mbrojtur.

2.1.5 Lejet dhe licencat për mbrojtjen e natyrës që janë lëshuar nga DMMU

Gjatë periudhës së viteve 2015 - 2017, Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës ka lëshuar tetë leje për zbatimin e hulumtimeve shkencore në natyrë, në bazë të kërkesave të bëra kryesisht nga institucionet universitare vendore dhe të huaja si dhe organizatat joqeveritare. Po ashtu gjatë vitit 2016 është lëshuar edhe një Leje për transferimin-importin e tre arinjve nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës nga Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfoten Kosova" Prishtinë. Ky është një rezultat i zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 26/2012 për qarkullimin ndërkufitar dhe tregtinë me llojet e egra të mbrojtura, edhe pse nuk jemi palë nënshkruese e Konventës CITES.

MMPH gjatë vitit 2016 ka lëshuar pesë licenca për personat fizik dhe juridik të cilët pas mbajtjet se trajnimeve adekuate nga ana e MMPH do të bëjnë hartimin e raportit për vlerësimin dhe kompenzimin e dëmit që shkaktohen nga llojet e egra të shtazëve strikt të mbrojtura.

Deri më tani në Kosovë nuk ka asnjë vendkalim për shtazët e egra në autoudhat që janë ndërtuar edhe pse infrastruktura ligjore i obligon që të kenë parasysh rregullimin e shtigjeve për vendkalimet e shtazëve të egra në ato zona ku e kanë habitatin e tyre.

3. KORNIZA INSTITUCIONALE

3.1. Organet vendimëmarrëse

- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Komisioni funksional i Kuvendit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Organet përgjegjëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e natyrës janë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - MMPH

  Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës

  Instituti i Planifikimit Hapësinor

- Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës- AMMK

  Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN

  Drejtoria e Parkut Kombëtar "Sharri"

  Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – MBPZHR

  Agjencia e Pyjeve të Kosovës

  Instituti i Pylltarisë së Kosovës

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

  Muzeu i Kosovës

- Niveli lokal - Komunat;
- Institucionet shkencore;
- Organizatat mjedisore të shoqërisë civile.

3.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitet 2011 – 2020

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin paraqet dokumentin bazë për mbrojtjen e natyrës, i cili i përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiversitetit dhe larmisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Republikës së Kosovës.

Me SPVB 2011-2020 janë përcaktuar katër Objektiva Strategjike si në vijim:

OS1: Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi efektiv i saj.

OS2: Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative në baraspeshë natyrore.

OS3: Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve.

OS4: Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin.

Këto katër objektiva strategjike janë zbërthyer në Planin e Veprimit i cili ka identifikuar listën prej 11 (njëmbëdhjetë) masave të cilat përmes projekteve konkrete, zbatohen me qëllim të arritjes së këtyre objektivave.

Masa 1. Harmonizimi dhe fuqizimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës me Direktivat dhe Rregulloret e BE–së, si dhe nënshkrimi i Konventave kryesore - kjo masë është sa i përket harmonizimit të legjislacionit (janë nxjerr 2 ligje për Parqe Kombëtare, 2 Rregullore 20 Udhëzime Administrative dhe 35 Vendime), është arritur në shkallë 80 deri 100%, varësisht prej Direktivës ndërsa sa i përket fuqizimit të legjislacionit kemi hasur në vështirësi të cilat kanë të bëjnë me mungesë të kapaciteteve për fuqizim dhe zbatim. Nënshkrimi i Konventave nuk është arritur për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet Kosova (anëtarësimi në Kombet e Bashkuara).

Masa 2. Fuqizimi dhe institucionalizimi i organeve kompetente për zbatimin e masave dhe veprimeve për ruajtjen e biodiversitetit - janë ndërmarrë veprime që përmes trajnimeve të ngritën kapacitetet humane për zbatimin e masave për ruajtjen e biodiversitetit. Programi ECRAN - Rrjeti Regjional Mjedisi dhe Klima i financuar nga Komisioni Evropian ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të institucioneve të Kosovës për çështjet e ruajtjes së biodiversitetit.

Masa 3. Shtimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të natyrës në 10% të territorit të Republikës së Kosovës dhe menaxhimi efektiv i tyre - për sa i përket kësaj mase shtimi i territorit të zonave të mbrojtura ka arrit në 11, 5%, ndërsa sa i përket menaxhimit efektiv nuk është arritur të bëhet në shkallë të kënaqshme.

Masa 4. Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe vendbanimeve natyrore - në vitin 2017 është realizuar projekti, ku është bërë inventarizimi preliminar i llojeve të bimëve, shtazëve, tipat e vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre në Republikën e Kosovës.

Masa 5. Mbrojtja Ex - situ e resurseve gjenetike bimore dhe shtazore - Banka e gjeneve për resurset bimore është funksionalizuar në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës të Universitetit Publik Hasan Prishtina" përderisa Banka e gjeneve për shtazët ende nuk është themeluar.

Ngritja e strehimores "PYLLI I ARINJVE" në Badovc nga Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve VIER PFOTEN Internacional nga Austria ka ndikuar pozitivisht në zgjidhjen e problemit me Arinjtë e murrmë.

Masa 6. Punët përgatitore për themelimin e "Natura 2000", ka përfunduar Studimi mbi gadishmerinë e Kosovës për procesin e themelimit të Natura 2000 dhe është themeluar Grupi Koordinues ndër sektorial për "Natura 2000".

Masa 7. Promovimi i vlerave ekonomike të biodiversitetit dhe ruajtja e biodiversitetit të bëhet pjesë e politikave të sektorëve tjerë kjo masë është zbatuar përmes Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Tek sektorët me ndikim gjatë hartimit të politikave është kërkuar që të marrin parasysh çështjet që kanë ndikim në ruajtjen e biodiversitetit si dhe janë aplikuar masat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për të gjitha projektet dhe ndërhyrjet në zonat me biodiversitet të lartë sikurse janë Parqe Kombëtare etj.

Masa 8. Nxjerrja e planeve Hapësinore dhe planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura të natyrës Planet Hapësinore për PK "Sharri" MNRV "Ujëvarat e Mirushës kurse në procedura të miratimit është PH për PK "Bjeshkët e Nemuna" ndërsa Plan Menaxhues ka vetëm PK "Sharri".

Masa 9. Ngritja e vetëdijes dhe bashkëpunimit tek të gjithë sektorët për biodiversitetin- kjo masë është realizuar pjesërisht përmes leksioneve në shkolla, organizimi i ditës së Biodiversitetit dhe botimi i fletëpalosjeve për këtë tematikë.

Masa 10. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e natyrës, biodiversitetit dhe peizazheve si dhe vlerave të tyre ekonomike dhe financiare – janë realizuar projekte të vogla me mbështetje të buxhetit të Kosovës por edhe donatorëve siç janë Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe Fondacioni MAVA, SIDA suedeze, GIZ gjerman i cili ka mbështet hartimin e Librit të Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës. Po ashtu janë zhvilluar edhe Projekti për menaxhimin e qëndrueshëm të Peizazhit të Mbrojtur "Gërmia" financuar nga Komisioni Evropian.

Projekti Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës dhe Konservimi i Biodiversitetit në Komunën e Dragashit financuar nga Qeveria Finlandeze dhe zbatuar nga UNDP.

Projekti nga JICA japoneze & MASHAV ka mbështetur MMPH konkretisht Komunën e Suharekës me qëllim të kontribuimit në ndërtimin e kapaciteteve humane te komuniteteve lokale për shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe zhvillimi i ekonomive rurale bazuar në përvojat japoneze dhe izraelite.

Masa 11. Fuqizimi i shkencave taksonomike dhe zbatimi i programeve në Universitet për hartat, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit – ka pasur përpjekje që me kurrikulat e reja të

zhvillohen Module specifike nëpërmjet bashkëpunimit me UP "Hasan Prishtina" Departamenti i Biologjisë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me mbështetjen e TAIEX gjatë vitit 2016 ka bërë vlerësimin afatmesëm për shqyrtimin e "Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020", është themeluar Grupi Punues për zbatimin e kësaj detyre. MMPH ka udhëhequr procesin dhe stafi i Divizionit për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë koordinimin dhe komunikimin me anëtarët e grupit punues gjatë procesit të rishikimit dhe përditësimit të këtij dokumenti strategjik, i cili është në procedurë për miratim.

Tabela 1. Hrmonizimi me Direktivat e Bashkimit Evropian në sektorin e mbrojtjes së natyrës

Nr.	Emri i direktivës	Viti i ratifikimit	Qëllimi	Hamonizimi në legj. komb. (%)
1	Direktiva 2009/147/EC për ruajtjen e zogjve të egër	Së pari është miratuar nga Shtetet Anëtarenë vitin 1979, është pjesa më e vjetër e legjislacionit të natyrës në Bashkimin Evropian	Direktiva ofron një kornizë të plotë përmbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e tëgjithë zogjve të egër që ndodhen në BE.Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të zogjve të egër që ndodhen në shtetin e BE-së (neni 2). Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe/ose ri-krijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullacione të zogjve (Neni 3)	95%
2	Direktiva 1999/22/EC ZOOs- kanëtë bëjnë me mbajtjen e shtazëve të egra në kopshte zoologjike	29 Mars 1999	Objektivat e Direktivës janë që të mbrojnë faunëne egër dhe të ruajnë biodiversitetinduke siguruar miratimin e masave nga Shtetet Anëtare për licencimin dheinspektimin e kopshteve zoologjike në komunitet, në mënyrë të forcimit të rolit të kopshteve zoologjike në ruajtjen ebiodiversitetit.	80%
3	Direktiva 92/43/ EEC për ruajtjen e vendbanimeve natyrore dhe florës dhe faunës së egër.	21 Maj 1992	Qëllimi kryesor i Direktivës së Vendbanimit është për të promovuar ruajtjen e biodiversitetit, kërkohet nga shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur ose rikthyer vendbanimet natyrore dhe llojet e egra të listuara në Shtojcat e Direktivës me një status të favorshëm të ruajtjes, duke futur mbrojtje të fuqishme për ato vendbanime dhe lloje të rëndësisë Evropiane.	96%
4	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC).	23 tetor 2000	Mirëmbajtjen e "statusit të larte ekologjik" të ujit aty ku ekziston duke parandaluar çdo keqësim të gjendjes ekzistuese të ujërave dhe arritjen e së paku "statusit të mirë" në raport me të gjitha ujërat deri në 2015.	48.8%
5	Direktiva 2004/35/EC mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe përmirësimin e dëmit mjedisor (Direktiva Përgjegjësia për Mjedisin).	Direktiva u miratua në prill 2004. Ajo trajton vetëm dëme dhe ngjarje të dëmshme të cilat ndodhin pas afatit të fundit për transpozimin në nivel të Shteteve Anëtare, 30 prill 2007.	Direktiva Përgjegjësia për Mjedisin ka për qëllim për t'i bërë ligjërisht dhe financiarisht përgjegjës të gjithë dëmtuesit për dëmtimin e mjedisit (ujit, tokës dhe të natyrës).	76%

Burimi: DMMU/MMPH

4. KLASIFIKIMI I ZONAVE TE MBROJTURA

Klasifikimi i Zonave të Mbrojtura bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L233) dhe pjesërisht është në harmoni me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Zonat e mbrojtura të natyrës sipas këtij Ligji klasifikohen në 7 kategori:

4.1. Rezervat Strikt i Natyrës

Rezervati strikt i natyrës është zonë e tokës dhe/ose ujit e pandryshuar ose shumë pak e ndryshuar dhe është i dedikuar ekskluzivisht për ruajtjen e natyrës së paprekur, hulumtime shkencore të larmisë biologjike, përcjelljen e gjendjes së natyrës si dhe arsimimin nëse nuk rrezikojnë zhvillimin e lirshëm të proceseve natyrore. Për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt duhet të merret leja nga Ministria. Në rezervatin strikt ndalohet kryerja e veprimtarive ekonomike dhe veprimtarive të tjera. Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave te mbrojtura, rezervatet strikte natyrore përfshijnë 10885.82 ha. Në Kosovë deri më tani janë të shpallura 19 Rezervate Strikte të mbrojtura

4.2. Park Kombëtar

Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës. Parku kombëtar ka rëndësi shkencore, kulturore, edukativo arsimore dhe rekreative. Në parkun kombëtar lejohen punët dhe veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet natyra burimore. Në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.

Në parkun kombëtar lejohen veprimtaritë hoteliere - turistike dhe rekreative të cilat janë në funksion të vizitave, arsimimit, të nevojave shëndetësore - rekreative dhe turistike, bujqësia ekstensive tradicionale, peshkataria nëse nuk rrezikohet ekzistenca e llojeve dhe baraspesha natyrore në pajtim me Ligjin e natyrës dhe planin e menaxhimit.

Në Kosovë ekzistojnë dy Parqe Kombëtare të shpallura nga Kuvendi i Kosovës: PK "Sharri" me sipërfaqe 53 469 ha dhe PK "Bjeshkët e Nemuna" me 62.488 ha. Parqet kombëtare përfshijnë sipërfaqen prej gjithsej 115.957 ha.

4.3. Zona e Veçantë e Mbrojtur – ZVM dhe ZVR

Zona e veçantë e mbrojtur është zonë e tokës dhe/ose ujit me rëndësi të veçantë për shkak se është unike, e rrallë - reprezentative, ose është vendbanim i llojeve të egra dhe veçanërisht është i rëndësishëm për hulumtime shkencore.

Zona e veçantë mundet me qenë: bimore, mikologjike, e vegjetacionit pyjor, zoologjike - ornitologjike, ihtiologjike, gjeologjike, paleontologjike, hidrogjeologjike, hidrologjike etj.

Në zonën e veçantë nuk lejohen ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë të cilat munden me ia prishë veçoritë për shkak të cilave është shpallë zonë e veçantë - grumbullimi dhe shkatërrimi i bimëve, shqetësimi, kapja dhe vrasja e shtazëve, futja e llojeve të reja biologjike, ndërhyrjet melioruse, llojet e ndryshme të ekonomizimit dhe shfrytëzimi tjetër e të ngjashme.

Në zonën e veçantë janë të lejuara ndërhyrjet, punët dhe veprimtaritë me të cilat mbahen ose përmirësohen kushtet të rëndësishme për ruajtjen e veçorive për shkak të cilave është shpallë zona.

Në Kosovë ekziston një Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve - Ligatina e Hencit - Radeves me sipërfaqe 109 ha.

4.4. Park Natyre

Parku i natyrës paraqet zonë të madhe natyrore ose pjesërisht artificiale të tokës dhe/ose ujit me karakteristika ekologjik të rëndësisë kombëtare e ndërkombëtare me vlera të theksuara të larmisë peizazhore, edukative-arsimore, kulturo - historike dhe turistike - rekreative.

Në parkun e natyrës lejohen veprimtarit ekonomike dhe aktivitetet tjera me të cilat nuk rrezikohet roli dhe karakteristikat e rëndësishme të tij.

Mënyra e kryerjes se aktiviteteve ekonomike dhe shfrytëzimi i të mirave të natyrës në parkun e natyrës përcaktohen me kushtet për mbrojtjen e natyrës.

Në kuadër të kësaj kategorie është vënë në mbrojtje paraprake "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës" si zonë e mbrojtur ndërkufitare Kosovë - Shqipëri, më sipërfaqe prej 5934 ha.

4.5. Monument i Natyrës

Monumenti i natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe /ose vlera turistike. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik,

strukturë gjeologjike, sediment etj, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore.

Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.

Në Kosovë janë të mbrojtura 157 Monumente të Natyrës, me sipërfaqe prej 6059.78 ha. Prej tyre 110 me karakter botanik, 20 hidrologjik, 16 speleologjik dhe 10 gjeomorfologjik.

4.6. Peizazh i Mbrojtur

Peizazhi i mbrojtur është zonë natyrore ose artificiale me vlerë të madhe peizazhore dhe larmi biologjike ose me vlerë kulturo-historike, ose peizazh me veçori të ruajtura unikale karakteristike për zonën e caktuar i dedikuar për pushim dhe rekreacion. Në peizazhin e mbrojtur nuk lejohen ndërhyrjet dhe punët të cilat prishin karakteristikat për shkak të cilit është shpallë i mbrojtur.

Në kuadër të kësaj kategorie hyjnë: Gërmia, Shkukza, Kompleksi i pishave "Strazhë", Kaçanik, dhe Pishat e Deçanit. Sipërfaqja e përgjithshme e kategorisë së Peizazheve të mbrojtura është 2059 ha.

4.7. Monument i Arkitekturës së Parkut

Monumenti i arkitekturës së parkut është hapësirë e krijuar artificialisht - kopshti botanik, arboretumi, parku i qytetit, dru radhitjet, si dhe format tjera të kopshteve dhe parqeve, përkatësisht trungje individuale ose grupe trungjesh që kanë vlerë të madhe estetike, kulturo-historike, ekologjike ose shkencore. Në monumentin e arkitekturës së parkut dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij e cila është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk janë të lejuara veprimtaritë ose punët të cilat mund të ndryshojnë ose të prishin vlerat për shkak të cilave është mbrojtur.

Në kuadër të kësaj kategorie të mbrojtjes ende nuk është klasifikuar asnjë Zonë e Mbrojtur. Në të ardhmen duhet të bëhet inventarizimi i parqeve të qyteteve në Kosovë.

5. KRONOLOGJIA E SHPALLJES SË ZONAVE TË MBROJTURA

Në kronologjinë e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë mund të veçohen tri periudha kohore të cilat lidhen me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë.

Periudha 1950 - 1970, paraqet fazën iniciale të mbrojtjes së natyrës dhe shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë e cila fillon me shpalljen e zonës së parë në vitin 1950, që ishte "Gazimestani". Deri në fillimin e viteve të 70-ta, numri i zonave të mbrojtura arrinte në 19. Në këtë periudhë nën mbrojtje vihen: Shpella e Gadimes dhe disa monumente të tjera me rëndësi botanike si: Rrapi në Marash, Trungjet në Isniq, etj.

Periudha në mes viteve 1970 - 1988, karakterizohet me shpalljen e numrit të konsiderueshëm të zonave të natyrës. Arsyeja e këtij suksesi është e lidhur me themelimin e Entit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në vitin 1974, nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë periudhë, nën mbrojtje janë vënë gjithsej 32 zona të natyrës prej të cilave duhet veçuar: rezervati "Bifurkacioni i Lumit Nerodime", Parku i parë Kombëtar "Mali Sharr"(1986), Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc (1983) si dhe disa monumente të tjera të natyrës.

Periudha pas vitit 2000, karakterizon rithemelimin e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, respektivisht Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjatë kësaj periudhe nën mbrojtje ligjore janë marrë mbi 150 zona te ndryshme dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 50 zona. Në mesin e zonave të mbrojtura duhet veçuar: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"(2013), PK "Sharri" (i zgjeruar), Ligatina e Hencit - Radevës etj., ndërsa shumicën e përbëjnë monumentet e natyrës me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik, etj.

Fig. 1. Numri i zonave të mbrojtura të natyrës 1950 - 2017



Burimi: IKMN

Gjatë periudhës 2015-2017 numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura u janë shtuar gjithsejtë 78 zona të reja të mbrojtura të natyrës nga të cilat: 18 rezervate strikte[1] (Bjeshka e Kozhnjerit /Maja e Ropsit, Maja e Arnenit, Lumbardhi, Bistra, Shutmani, Gryka, etj.), 57 monumente të natyrës (Bifurkacioni i lumit Nerodime[2], Shpella e Peshterrit në Zatriq - Rahovec, Guri i gjatë në Stagovë - Kaçanik, Shpella e Devetakut dhe Burimi në Devetak - Shtime, Trungu i dushkut (*Quercus sp*.) në Llapashticë të Epërme - Podujevë, Trungu i Bungut, *(Quercus petraea)* në Shitaricë - Vushtrri etj.), 1 park natyre (Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës) dhe 2 peizazhe të mbrojtura (Gërmia[3] dhe Kompleksi i Pishave në Strazhë - Kaçanik) etj.

6. ZONAT E MBROJTURA TË NATYRËS

Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë (2017) është 184 të cilat përfshijnë sipërfaqe prej 126,119.29 ha, ose 11.56% e sipërfaqes të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 19 Rezervate Strikte të Natyrës ("Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", "Kamilja", etj), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri", PK "Bjeshkët e Nemuna"), 157 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit", "Shpella e Gadimës", "Ujvarat e Mirushës", "Gryka e Rugovës", "Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), 1 Park i Natyrës ("Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vërmicës"), 4 Peizazhe të Mbrojtura ("Shkugëza" dhe "Pishat e Deçanit"etj) dhe 1 Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve ("Ligatina e Hencit-Radeves").

Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e përbëjnë Parqet Kombëtare: "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri", Parku i natyrës "Mali Pashtrik dhe Liqeni i Vermicës", Peizazhi i Mbrojtur "Germia" dhe MNRV "Ujëvarat e Mirushës" etj.

[1] Gjatë kësaj periudhe është realizuar ridefinimi i kufijve dhe janë nxjerrë vendime të reja për disa nga rezervatet strikte të cilat kanë qenë të shpallura edhe më herët nga vitet e '50 të shekullit të kaluar.
[2] Monumenti i Natyrës "Bifurkacioni i Lumit Nerodime" deri në vitin 2015 ishte i mbrojtur si Rezervat Special i Natyrës.
[3] Zgjerimi i sipërfaqes së mbrojtur.

Tabela 2. Zonat e Mbrojtura të Natyrës sipas kategorive (2017)

Kat. e IUCN-së	Emërtimi	Nr.	*Sipërfaqja/ha*	*Pjesëmarrja në %*
I	Rezervatet Strikte të Natyrës	19	10,885.82	0.99
II	Parqet Kombëtar	2	115,957	10.6
III	Monumentet Natyre	157	6,084.79	0.56
V	Park Natyre	1	5,934	0.54
V	Peizazh i Mbrojtur	4	2.412	0.22
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve	1	109.5	0.01
	Totali	184	126119.29[4]	11.56 %

Burimi: IKMN

6.1. REZERVATET STRIKTE

Në Kosovë janë të shpallura nëntëmbëdhjetë (19) Rezervate Strikte, nga të cilat tetëmbëdhjete (18) ndodhen brenda territorit të Parqeve Kombëtare. Në Parkun Kombëtar "Sharr" gjenden pesëmbëdhjetë (15) rezervate, siç janë: Lëndina e Shenjtë, Shutmani, Bredhiku, Pashallar, Gryka, Lumëbardhi, Luboteni, Koritniku, Kobilica, Dupnica, Bistra, Rusenica, Oshllaku, Maja e Arnenit dhe Pisha e Madhe. Ndërsa në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" janë tri (3) rezervate: Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit, Malet e Prilepit dhe Gubavci, kurse në Leposaviq gjendet rezervati i Kamiljes.

Monitorimi i Rezervateve Strikte

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) është institucion përgjegjës për monitorimin e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit. Në kuadër të planit të punës gjate periudhës 2015-2017 IKMN-ja ka realizuar vizita monitoruese me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të këtyre Rezervateve Strikte. Sa i përket çështjes së administrimit, kjo rregullohet përmes Drejtorive për Administrimin e Parqeve Kombëtare që janë përgjegjëse për administrimin e territorit të Parqeve Kombëtare dhe Rezervateve Strikte të cilat gjenden në kuadër të tyre.

[4] Sqarim: kjo sipërfaqe e zonave te mbrojtura nuk përfshinë zonat e mbrojtura që gjenden në kuadër të Parqeve Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"

6.1.1. Lëndina e Shenjët

Lëndina e Shenjët, gjendet në malet e Mushtishtit, në lartësinë mbidetare 1150-1372 metra me sipërfaqe prej 17.98 hektar. Në këtë zonë përveç llojit stenoendemik bornmullera e Dieckit (*Bornmuellera dieckii*), gjenden llojet e rralla dhe endemike si: rrobulli (*Pinus heldreichii*), dredhaku (*Pinus mugo*), sarusha e sharrit (*Stachys scardica*), poligala e Doerflerit (*Polygala doerfleri*) etj. Llojet mjekësore janë: sarusha mjekësore (*Stachis officinalis*), solidagu shufërartë (*Solidago virga-aurea*), aguliqja mjekësore (*Primula officinalis*), gencianë e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), poligonati mjekësor (*Polygonatum officinale*), salepi (*Orchis morio*), gentianë pranverore (*Gentiana verna*), etj. Në aspektin faunistik në këtë zonë veçohet prania e llojeve si: kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), shqarthi (*Martes foina*), shqiponja minjngrënëse *(Buteo buteo*), qyqja *(Cuculus canorus),* pikthi i gjelbër *(Picus viridis).*



Foto 1. Panjës së heldrahut *(Pinus heldreichii)*



Foto 2. Bornmullera e dieckit *(Bornmullera dieckii)*

6.1.2. Shutmani

Rezervati strikt "Shutmani" gjendet në shkëmbinjtë silikat dhe gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1400 deri 2658 metra dhe përfshinë sipërfaqe prej 5057 hektar. Në këto zonë gjinden llojet bimore si: *Achillea abrotanoides, Achillea chrysocoma, Achillea atrata, Alkana scardica, Allium sibiricum, Alyssum scardicum, Armeria alpina, Barbarea balcana, Cardus scardicus, Campanula albanica, Cicerbita pancicii, Crocus scardicus, Dianthus scardicus, Dianthus superbus, Discorea balcanica, Draba scardica, Draba korabensis, Gentianella bulgaria var. albanica, tj.* Llojet më të rëndësishme mjekuese janë: *Gentiana lutea, Gentiana punctata*, etj.

Zona e Shutmanit paraqet habitat të dhive të egra (*Rupicapra rupicapra*). Kushtet e mira të habitatit kanë ndikuar në zhvillimin e qëndrueshëm të dhive të egra.

Nga llojet e zogjve veçohet prania e shqiponjës së artë (*Aquila crysaetos*) e ndonjëherë edhe e shkabës (*Gyps fulvus)* që e zbukurojnë qiellin e kësaj zone gjatë stinës verore. Për identifikimin e zogjve të tjerë nevojiten hulumtimet më të hollësishme të zonës.



Foto 3. Genciana pranverore *(Gentiana verna L.)*



Foto 4. Mëlaka e maleve *(Geum montuam)*

6.1.3. Bredhiku

Rezervati Strikt "Bredhiku" gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1100 - 1450 metra dhe ka sipërfaqe 123.16 hektar. Në këtë zonë janë evidentuar llojet e vegjetacionit, si: bredhi maqedonas (*Abies borisi regis)* dhe bredhi i bardhë *(Abies alba).*

Në kuadër të kësaj zone gjinden edhe këto llojet bimore: Arunku dioik *(Aruncus dioicus), Campanula foliosa, Chyrsanthemum leucanthemum, Melampyrum bihariense* etj.



Foto 5. Arunku dioik *(Aruncus dioicus)*



Foto 6. Lulekambana gjetheshumë *(Campanula foliosa)*

Kjo zonë është habitat i kaprollit (*Capreolus capreolus*) dhe ariut të murrmë (*Ursus arctos*) i cili ka skrofullën (çerdhen) e tij dimërore në këtë zonë. Nga llojet e tjera paraqitën: ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Canis vulpes*), derri i egër (*Sus scrofa*), fishnjari (*Martes foina*), ketri (*Scirius vulgaris*) etj. Janë verifikuar edhe gjurmët e rrëqebullit (Lynx lynx) që këtë zonë e shfrytëzon për kërkim të ushqimit nga habitati i tij në Koritnik ku është i rrezikuar nga gjuetarët ilegal.

Llojet më të rëndësishme të shpendëve të identifikuara në këtë zonë janë: skifteri i përhimët (*Falco peregrinus*), minjngrënësi (*Buteo buteo*), petriti (*Accepiter gentilis*), thëllëza e gurëve (*Alectoris graeca*), qyqja (*Cuculus canorus*), huti i vogël (*Otus scops*), pikthi i gjelbërt (*Picus viridis*), qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), etj.

6.1.4. Pashallarët

Rezervati Strikt "Pashallare" gjendet në shkëmbinjtë serpentin, në lartësinë mbidetare 1280 – 2092 metra dhe ka sipërfaqe 400 hektar. Prej llojeve drunore dhe shkurrore që gjenden në këtë zonë veçohen: Rrobulli (*Pinus heldreichii*), Arneni (*Pinus peuce*), Dredhaku (*Pinus mugho*), Tisi (*Taxus bacata*), Boronica *(Vaccinium myrtillus*), Dëllinja e siberisë (*Juniperus nana*), Trendafili malor (*Rosa pendulina*), etj. Në kuadër të këtij rezervati janë prezente llojet bimore stenoendemike, burnmullera e Dieckit (*Bornmullera dieckii*) dhe cerasti i Sharrit (*Cerastium neoscardicum*), të cilat kanë rëndësi ndërkombëtare. Prej llojeve tjera endemike veçohen: *Adenostyles glabra, Anthylis vitelina, Lazerpitium sp., Lilium albanicum, Campanula moesiaca, Campanula albanica, Campanula foliosa, Campanula glomerata, Knautia dinarica, etj.*

Fauna e kësaj zone është e pasur me lloje të shumta, ndërsa më të rëndësishme janë: *Lynx lynx, Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Sus scrofa, Felis sylvestris, Martes martes, Meles meles, Apodemus silvaticus*, etj. Kohët e fundit vërehet prania e dhive të egra (*Rupicapra rupicapra*) që kanë migruar nga habitati i tyre në Oshlak.

Llojet më të rëndësishme të zogjve në zonës janë: *Aquila chrysaetos, Falco biarmicus, Accepiter gentilis, Accepiter nisus, Bubo bubo, Strix aluco, Otus scops, Alectoris graeca, Tetrastes bonasia, Loxia curvirosta, Pyrrhocorax pyrrhocorax, Lullula arborea, Parus atricapillus,* etj.

Në të kaluarën kjo zonë ka qenë habitat i pulegrës së madhe (*Tetrao urogallus*), ndërsa gjatë gjurmimeve të zonës ky lloj i rrallë dhe i rrezikuar nuk është vërejtur (konstatuar).



Foto 7. Sanëza *(Gerntina lutea)*



Foto 8. Zambaku shqiptar *(Lilium albanicum)*

6.1.5. Gryka

Rezervati Strikt "Gryka" gjendet në shkëmbinjtë serpentine, në lartësinë mbidetare 1050 – 1531 metra dhe ka sipërfaqe 103.98 hektar. Në kuadër të vegjetacionit pyjor në këtë zonë gjendet Tisi me Ahun *(Fageto-Taxetum baccata)*. Ndërsa prej llojeve bimore mundë të përmendim: lloji endemorelikt, ramonda *(Ramonda nathaliae),* si dhe llojet telekia e bukur *(Telekia speciosa),* klokëza e rëndomtë *(Silene vulgaris),* fier guri *(Asplenium trichomanes)* etj.



Foto 9. Telekia e ukur *(Telekia speciosa*)



Foto 10. Klokëza e rëndomtë *(Silene vulgaris)*

Zona paraqet habitat dhe zonë e migrimit për llojet e shumta të kafshëve të egra: *Ursus arctos, Capreolus capreolus, Felis sylvestris, Canis vulpes, Sus scrofa, Meles meles, Martes foina, Testudo graeca*. Zogjtë më të rëndësishëm të zonës janë: *Buteo buteo, Falco biarmicus, Accipiter gentilis, Bubo bubo, Strix aluco, Lanius collurio, Lullula arborea, Dryobates minor, Picus viridis, Alectoris graeca, Cuculus canorus, Turdus merula,* etj.

6.1.6. Lumbardhi

Rezervati Strikt "Lumëbardhi" gjendet në shkëmbinjtë silikat në lartësinë mbidetare 1570 - 2609 metra dhe ka sipërfaqe 304 hektar. Në kuadër të këtij rezervati përfshihen bashkësitë bimore: Pyjet e ahut (*Fagetum subalpinun*) dhe Dëllinja me boronicën (*Vaccinio-Juniperetum nanae*). Kurse prej llojeve bimore mund të veçohen: *Dinathus scardicus*, *Crocus scardicus*, *Draba korabensis, Potentilla montonegrina, Selaginella selaginoides, Pedicularis oederi, Silene waldsteinii, Salix herbacea*, *Lilium albanicum, Ranunculus incomparabilis, Pinguicula balcanica, Allysum scardicum, Anemone narcissiflora, Draba doerfleri* etj.



Foto 11. Karafili i Sharrit *(Dinathus scardicus)*



Foto 12. Barpezmi i ndarë shumë *(Achillea multifidia)*

Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat te dhive të egra dhe shqiponjës së maleve (*Aquila crysaetos*), ndërsa pyjet dhe kullosat në pjesët e poshtme të zonës shfrytëzohen nga ariu i murrmë dhe kaprojtë.

6.1.7. Luboteni

Rezervati Strikt "Luboteni" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1600 – 2514 metra dhe ka sipërfaqe 202.16 hektar. Në këtë zonë gjendet vegjetacioni: *Carex laevis-Helianthemum.* Në kuadër të llojeve bimore mund të veçohen: *Achillea ageratifolia var aizooni, Centaurea kosanini, Euphorbia glabriflora, Draba scardica, Genista hassertiana, Thlaspi bellidifolium, Salvia scardica, Stachys scardica, Thymus albanus, Thymus lykae, Dianthus microlepis, Dianthus scardicus, Silene roemeri, Ranunculus millefoliatus, Silene sendtneri, Asperula dorfleri, Fumana bonapartei,* etj.

Kjo zonë paraqet habitat i dhive të egra, ndërsa gjatë verës vërehen edhe shpendët grabiqar: shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), skifteri i përhimtë (*Falco peregrinus*) dhe shqiponja minjëngrënëse (*Buteo buteo*) të cilët këtë zonë e shfrytëzojnë për kërkim të ushqimit.



Foto 13. Burgulli *(Sempervivum hirtum)*



Foto 14. Gencianza bullgare *(Gentianella bulgarica)*

6.1.8. Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit

Rezervati Strikt "Bjeshka e Kozhnjerit - Maja e Ropsit gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror dhe serpentin, në lartësinë mbidetare 1708 - 2501 metra dhe ka sipërfaqe 1,110.57 hektar. Në këtë gjinden bashkësitë bimore si: Bashkësia e hormoqit *(Picetum excelsae),* Bashkësia e hormoqit dhe arnenit *(Piceo-Pinetum peucis)* dhe Bashkësia e arnenit *(Pinetum peucis).* Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Saxifraga stellaris, Valeriana tripteris, Malva moschata, Cirsium candelabrum, Tanacetum vulgare, Salix eleagnos, Lilium martagon, Centaurea ipecensis, Verbascum baldacii, etj.*



Foto 15. Rreqebulli në Rezervati Strikt "Bjeshka e Kozhnjerit-Maja e Ropsit" (IKMN-2017)

Pjesët më të larta shkëmbore të zonës paraqesin habitat të dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*), dhe i rrëqebullit (*Lynx lynx*,) ndërsa pyjet paraqesin habitat të ariut të murrmë (*Ursus arctos*), kaprollit *(Capreolus capreolus),* derrit të egër *(Sus scrofa)* etj.

6.1.9. Koritniku

Rezervati Strikt "Koritnik" gjendet në shkëmbinjtë gëlqëror dhe ka sipërfaqe 818 hektar. Në këtë zonë gjendet bashkësia bimore: Rrobulli *(Pinetum heldreichii).* Ndërsa në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Achillea chrysocoma Friv., Achillea holosericea, Alysum montanum, Armeria alpina, Anthylis vitelina, Asperula doerfleri Wettst., Bunium alpinum, Carex laevis, Campanula versicolor, Centaurea napulifera, Crocus veluchensis Herb., Euphrasia salisburgensis, Festuca panciciana, Daphne cneorum, Dianthus scardicus, Draba lasiocarpa, Draba corabensis Kumm. et. Deg., etj.*

Koritniku është habitat i llojeve të shumta të faunës ku më të rëndësishmet janë: *Lynx lynx*, *Felis silvestris*, *Rupicapra rupicapra*, *Ursus arctos*, *Canis lupus*, *Capreolus capreolus*, *Meles meles*, *Canis vulpes, Sus scrofa, Glis glis*, *Mustela nivalis*, *Sciurus vulgaris*, *Sorex alpinus*, etj.



Foto 16. Bashkësia pyjore e Rrobullit *(Pinetum heldreichii)*

6.1.10. Kobilica

Rezervati Strikt "Kobilica" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1800 – 2527 metra dhe ka sipërfaqe 199 hektar. Në këtë pjesë është prezentë lloji bimor stenoendemik, me rëndësi ndërkombëtare si: *Hieracium kobilicanum*, ndërsa nga llojet e tjera endemike veçohen: *Silene schmucheri, Rumex nivalis, Dinathus superbus, Viola grisebachiana, Erigeron uniflorus, Saussurea alpine; Lilium albanicum dhe Salix herbacea,* etj.



Foto 17. Habitat i llojeve të rralla të bimëve kalcifite dhe hezmofite

6.1.11. Dupnica

Rezervati Strikt "Dupnica" gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1250 – 2585 metra dhe ka sipërfaqe 494 hektar. Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore, si në vijim: Ahu *(Fagetum subalpinum)* dhe Dëlinja siberiane *(Juniperetum nanae).* Llojet më të rëndësishme në kuadër të bimëve endemike janë: Klokëz shmukeri *(Silene schmucheri),* Shelgu barishtor *(Salix herbacea)*, Karafil me balluke (*Dianthus superbus*) etj.



Foto 18. Pamje nga Rezervati Strikt "Dupnica"

Dupnica paraqet habitatin e dhive të egra. Kjo zonë posedon kushtet të volitshme për zhvillimin e faunës në PK "Sharri". Në pjesët e poshtme të zonës gjenden strofullat (çerdhet) e ariut të murrmë dhe ujkut. Gjatë stinës se verës kjo zonë vizitohet nga shpendët grabitqar si: shqiponja e maleve (*Aquila crysaetos*), shqiponja minjëgrenëse (*Buteo buteo*), skifteri i përhimtë (*Falco peregrinus*) etj.

6.1.12. Bistra

Rezervati Strikt "Bistra" gjendet në shkëmbinjtë silikat, në lartësinë mbidetare 1350 – 2651 metra dhe ka sipërfaqe 642.12 hektar. Në këtë zonë janë prezente bashkësitë bimore si: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Arneni *(Ajugo-Pinetum peucis),* Bredhi, Rrobulli dhe Arneni *(Abieti-Pinetum peucis heldreichii*), Ahu dhe Pisha e bardhë *(Fago-Pinetum silvestris*), Ahu, Bredhi dhe Arneni *(Abieto-Fageto-Pinetum peucae*), Arneni, Dëllinja siberike dhe Boronica (*Vaccinio-Junipero-Pinetum peucae*) etj. Në lartësitë më të larta mbidetare paraqitet subasociacioni (*Vaccinetum uliginosi*).



Foto 19. Pajme nga Rezervati Strikt "Bistra"

Nga llojet e rrezikuara të faunës veçojmë: *Felis silvestris, Rupicapra rupicapra, Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Spermophilus citellus, Meles meles, Glis glis, Spalax monticola, Mustela erminea, Mustela nivalis, Arvicola terrestris* etj.

Në zonën e Bistres gjenden habitatet e llojeve të rralla dhe të rrezikuara të zogjve: *Tetrao urogalus*, *Aquila chrysaetos*, *Aquila heliaca*, *Buteo buteo, Falco peregrinus*, *Accipiter gentilis*, *Bubo bubo*, *Strix aluco*, *Loxia curvirosta*, *Tetrastes bonasia*, *Lullula arborea*, *Dryobates minor*, *Monitifringilla nivalis* etj.

6.1.13. Malet e Prilepit

Rezervati Strikt "Malet e Prilepit" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1815 metra dhe ka sipërfaqe 106.04 hektar. Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore si në vijim: Panja e heldrahit *(Acer heldreichii),* Arneni *(Pinus peuce),* Pisha e bardhë (*Pinus silvestris*), Hormoqi (*Picea abies*), Bredhi (*Abies alba*), Panja malore (*Acer pseudoplatanus*), Panja gjetherrapi (*Acer platanoides*), Ahu (*Fagus moesiacae*), Mushtekna (*Betula pendula*), Plepi i egër (*Populus tremula*), Shelgu i egër (*Salix caprea) etj.*

Llojet më të rëndësishme të faunës janë: ariu i murrëm (*Ursus arctos*), shqarthi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: fëllëza e gureve (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër (*Columba oenas*), korbi (*Corvus corax*), qyqja (*Cuculus canorus*), qykapikthi i larmë malor (*Dryobates leucotos*), lauresha e pyjeve (*Lullula arborea*) etj.

6.1.14 Gubavci

Rezervati Strikt "Gubavci" gjendet në pjesën perëndimore të Pejës duke krijuar një pamje mjaft impozante rrëzë Koprivnikut. Në vitin 2016 është zgjeruar sipërfaqja e rezervatit nga 38 hektar ne 76.84 ha Në këtë zonë është prezentë bashkësia bimore e Boshtrës *(Forsythia europaea).* Në kuadër të llojeve të bimëve barishtore mund të përmendim: *Centaurea kosaninii, Fumana bonapartei* etj. Sipas te dhënave (literaturës) përmendet edhe lloji stenoendemik *Rubus ipecensis*[5].

6.1.15 Rusenica

Rezervati Strikt "Rusenicë" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 780 – 1810 metra dhe ka sipërfaqe 270 hektar. Në këtë zonë janë prezente bashkësitë bimore si: Ahu dhe Bredhi (*Abieto-Fagetum*), Ahu *(Fagetum montanum*), Mëlleza dhe Frashri i zi *(Orno-Ostryio carpinetum*), Rrobulli dhe Bornmullera (*Bornmullero-Pinetum heldreichii*), Xerxeles si ulli (*Daphne oleoides)* dhe Dëllinjës së kuqe (*Daphno-Juniperetum oxicedri*), etj.

Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Bornmullera dieckii, Potentila argentea, Pilygala doerfleri, Ramonda serbica, Achillea holosericea, Hieraceum weldsteini, Galium rupestre, Scrophularia bosniaca, Minuartia verna, Achillea ageratifolia, Erysimum silvestre, Aetionema saxatile, Eryngium palmatum, Sylibum marianum, Camapnula secundiflora* etj.

Zona e Rusenicës është e pasur me kafshë të egra. Përveç rrëqebullit i cili është lloji më i rëndësishëm, në këtë zonë gjenden edhe llojet tjera si: *Rupicapra rupicapra*, *Ursus arctos, Capreolus capreolus, Sus scrofa, Felis sylvestris*, *Meles meles*, *Lepus europeus*, *Erinaceus europaeus*, *Vipera amodydes*, *Lacerta viridis*, etj. Rusenica është habitat i shumë llojeve të lakuriqëve (*Chiroptera*) të cilët duhet më hollësisht të hulumtohen.

Llojet më të rëndësishme të zogjve në zonën e Rusenicës janë: *Milvus milvus*, *Falco peregrinus*, *Accipiter gentilis*, *Bubo bubo, Lullula arborea*, *Dryobates leucotos*, *Cuculus canorus*, *Turdus merula*, *Parus atricapillus*, *Pyrrhocorax pyrrhocorax*, *Alectoris graeca*, etj.

[5] Raport – Zonimi i Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Prishtinë, 2014



Foto 20. Rusenica - Habitat i Rrëqebullit *(Lynx lynx)*

6.1.16. Oshlaku

Rezervati Strikt "Oshlak" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1150 - 2212 metra dhe ka sipërfaqe 550.47 hektar. Në këtë zonë janë prezentë bashkësitë bimore: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Dredhaku (*Pinetum mugho*), Dredhaku dhe Mushtekna (*Betulo-Pinetum mugho*), Hormoqi (*Picetum excelsae*), Shkoza orientale (*Carpinetum orientalis*), Ahu (*Fagetum montanum*).

Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Helianthemum canum*, *Dianthus scardicus*, *Dianthus integer*, *Dianthus superbus*, *Dianthus cruenthus*, *Gencianella bullgarica*, *Thymus albanicus*, *Lilium albanicum*, *Alkanas scardica*, *Potentilla montenegrina*, etj.



Foto 21. Oshlaku-Habitat i Rrobillit *(Pinus Heldreichii) & (Rupicapra rupicapra)*

Oshlaku është habitat i llojeve të shumta të kafshëve të egra. Lloji më i përhapur është dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), e cila gjendet në pjesët më të larta të Oshakut ku dominojnë kullosat malore dhe shkëmbinjtë gëlqerorë. Nga llojet e tjera të kafshëve të egra, veçohen: *Ursus arctos, Canis lupus, Capreolus capreolus, Canis vulpes, Sus scrofa, Felis sylvestris*, *Martes foina*, *Glis glis*, *Spalax monticola*, *Talpa europea*, *Mustela nivalis*, *Sorex aranens*, *Vipera ammodydes*, *Lacerta viridis*, etj. Në Oshlak janë vërejtur (gjurmët) e rrëqebullit (*Lynx lynx*) i cili këtë zonë e shfrytëzon për kërkim të ushqimit dhe migrim nga habitatet e tij në Rusenicë, Prevallë dhe Ujërat e Humbur, por nuk përjashtohet edhe përqendrimi i tij në këtë habitat pasi që kjo zonë (pjesa veriore e Oshlakut) mbulohet me pyje të dendura ku prania dhe ndikimi njerëzor është i kufizuar.

6.1.17. Maja e Arnenit

Rezervati Strikt "Maja e Arnenit" gjendet në shkëmbinjtë gëlqeror, në lartësinë mbidetare 1100 – 1946 metra dhe ka sipërfaqe 145.48 hektar. Në këtë zonë gjinden bashkësitë bimore, si në vijim: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), edifikator i florës barishtore është (*Sesleria autumnalis*), Rrobulli (*Luzulo-Pinetum heldreichii),* edifikator i florës barishtore është *Luzula maxima),* Ahu (*Fagetum montanum*), Rrobuli dhe Ahu (*Fago-Pinetum heldreichii*), Ahu dhe Bredhi (*Abieto-Fagetum*), Hormoqi (*Picetum excelsae*). Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen këto lloje: *Verbascum nikolai*, *Vrbascum scardicolum*, *Gentianella bulgarica var. Albanica*, *Dianthus cartusonarum, Dianthus integer*, *Lazerpitium siler subsp. garganicum*, *Campanula albanica*, *Thymus albanus*, *Stachys scardica*, *Viola grisebachii*, *Ephilobium anagallidifolium*, *Lilium albanicum, Onobrychis scardica*, *Scabioza dubia*, *Potentilla speciosa*, etj.



Foto 22. Bashkësitë pyjore të Rrobullit *(Pinus heldreihii) & Ahut (Fagus montanum)*

Në këtë pjesë gjenden këto lloje të shtazëve: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhelpra (*Canis vulpes*), derri i egër (*Sus scrofa*), macja e egër (*Felis sylvestris*), shqarthi i artë (*Martes martes*), fishnjari (*Martes foina*), etj.

Ne kuadër të shpezëve mund të përmendim këto lloje: shqiponja e maleve (*Aquila chrusaetos*), shqiponja minjngrënëse (*Buteo buteo*), skifteri malor (*Falco biarmicus*), pula e pyjeve (*Tetrastes bonasia*), thëllëzës së gurit (*Alectoris graeca*), stërqoka (*Pyrrhocorax pyrrhocorax*), *Tichodroma muraria*, etj.

6.1.18. Pisha e Madhe

Rezervati Strikt "Pisha e madhe" karakterizohet me pyjet të vjetra të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të Rrobullit *(Pinus heldreichii)* në Ballkan, ku një pjesë e tyre me sipërfaqe prej 35 hektar, janë shpallur si rezervat strikt në vitin 1960, ndërsa me Vendimin e vitit 2016 është zgjeruar në 44 hektar.

Në këtë zonë gjinden bashkësitë bimore, si në vijim: Rrobulli (*Seslerio-Pinetum heldreichii*), Rrobulli dhe Hormoqi (*Piceto-Pinetum heldreichi*), Ahu, Hormoqi dhe Rrobulli (*Fageto-Piceto-Pinetum heldreichii*), Rrobulli dhe Mështekna (*Betulo-Pinetum heldreichii*), Dredahku (*Pinetum mughi*), Hormoqi (*Picetum excelsae subalpium*), Bredhi dhe Ahu (*Abieto-Fagetum*), Ahu, Bredhi dhe Hormoqi (*Abieto-Fagetum-Picetosum*), Rrobulli (*Selserio-Pinetum heldreichii*) etj

Kjo zonë është e pasur me lloje të shumta të florës kosmopolite, pra me lloje që kanë përhapje të gjerë, në kuadër të parkut. Në kuadër të vegjetacionit të bimëve barishtore dallohen lloji stenoendemik i bimës *Sedum flexiosum*, por zona është e pasur edhe me lloje të shumta mjekësore,

siç janë: badhra e bardhë (*Asphodelus albus*), ushojza pakërcell (*Carlina acaulis*), genciane e kryqëzuar (*Gentiana cruciata*), bari i ethes (*Centaurium erytrea*), rigoni i zakonshëm (*Origanum vulgare*), zorrëca e përhimtë (*Potentilla tormentilla*), etj. [6]

Pisha e Madhe paraqet habitat edhe për shumë lloje të kafshëve të egra, prej të cilave mund të veçohen: ariu i murrmë *(Ursus arctos),* kaprolli *(Capreolus capreolus),* macja e egër *(Felis sylvestris),* fishnjari *(Martes foina),* Skifteri malor *(Falco biarmicus),* shqiponja minjngrënëse *(Buteo buteo)* etj. Problem shume i madhe në këtë zone është gjuetia e paligjshme.



Foto 23. Pisha e Madhe -Shqiponja minjëngënëse *(Buteo buteo)*

6.1.19. Kamilja

Rezervati Strikt "Kamilja" është shpallur rezervat në vitin 1988 dhe ka një sipërfaqe prej 228 hektar**.** Kodra e gëlqerorëve të Kamiljes karakterizohet me vlera të veçanta natyrore të periudhës paleontologjike. Kjo zonë duhet të përfshihet në kuadër të planit për monitorim në mënyrë që të konstatohet gjendja e vlerave natyrore dhe biodiversitetit në kuadër të saj.

[6] Zonat me vlera të veçanta natyrore në Parkun Kombëtar "SHARRI"

6.1.20. Gjendja ekzistuese e Rezervateve Strikte

Gjendja e përgjithshme e rezervateve nuk është në nivelin e duhur për arsye se në territorin e tyre janë duke u zhvilluar aktiviteti të ndryshme që në aspektin ligjor nuk janë të lejuara. Ndikimet negative janë si rezultat i aktiviteteve të ndryshme që po realizohen brenda dhe në afërsi të territorit të rezervateve. Bazuar në gjendjen në terren, pjesa më e madhe e këtyre ndikimeve shkaktohen nga veprimet e faktorit njeri, si: ndërtimi i rrugëve, hidrocentraleve (në afërsi), kamp-shtëpizave, kullotja e bagëtive, eksploatimi ilegal i bimëve mjekësore, ndezja e zjarreve në pyje, gjuetia ilegale, turizmi pa kriter etj. Ndërsa ndikimet nga faktorët natyror janë: rrëshqitja e materialit shkëmbor, tharja e trungjeve brenda rezervateve si pasoje e parazitëve, ndikimeve klimatike etj.

Poashtu ndërtimet ilegale të objekteve për pushim dhe rekreacion janë dukuri në vazhdimësi dhe po ndikojnë negativisht në biodiversitetin dhe vlerat e rezervateve. Këto zona po përdoren edhe për shfrytëzohen e kullosave dhe si të tilla në shumë vende janë të mbuluar me mbeturina shtazore, të cilat janë produkt i fermave blegtorale që zhvillojnë aktivitetin e tyre brenda rezervatit. Në rezervate është shumë e shprehur edhe dukuria e eksploatimit ilegal të llojeve bimore mjekësore dhe aromatike, duke ndikuar në masë të madhe reduktimin e (individëve) biodiversitetit të këtyre zonave, për të cilin edhe janë shpallur dhe që vërtet duket ruajtur. Mandej, djegiet e vegjetacionit pyjor në rezervate kanë ndikuar në ndryshim e pamjes natyrale të tyre.

Këto veprime janë duke ndikuar negativisht në vlerat natyrore dhe biodiveristetin që përmbajnë Rezervatet Strikte. Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve gjendja e rezervateve, në disa pjesë ka filluar të ndryshoj, duke u shoqëruar po ashtu me pasoja negative në llojet, ekosistemet, si dhe pamjen natyrale të peizazheve të tyre.



Foto 24. Nderhyrjet në Rezervatet Strikte



Fig. 2. Harta e Rezervateve Strikte

6.1.21. Rekomandimet

- *Të vazhdohet studimi i vlerave natyrore dhe biodiversitetit në të gjitha Rezervatet Strikte të cilat në bazë të vendimit janë të përcaktuara si zona të kategorisë së parë të mbrojtjes;*
- *Të formohen Grupe Punuese për rivlerësimin e Rezervateve Strikte;*
- *Të ndërmerren masa për parandalimin e eksploatimit ilegal i llojit të bimës mjekësore Sanëza (Gentiana lutea L.), në Rezervatet Strikte, si dhe në të gjitha pjesët tjera ku gjendet e zhvilluar;*
- *Të ndërpritet aktiviteti i kullotjes së deleve në brendësi të Rezervateve Strikte;*
- *Inspektorati i MMPH-së në bashkëpunim me Drejtorit e Parqeve Kombëtare të rrisë numrin e inspektimeve për ndërhyrjet në rezervatet strikte;*
- *Të bëhen hulumtime shkencore për florën, faunën dhe habitatet në territorin e të gjitha Rezervateve Strikte;*
- *Të rishikohet mundësia e definimit të saktë të kufirit të gjitha Rezervatet Strikte;*
- *Të vendosen tabelat informuese në të gjitha Rezervatet Strikte.*

6.2. PARKU KOMBËTAR "SHARRI"

6.2.1. Gjendja resurseve natyrore në Parkun Kombëtar "Sharri"

Gjendja e resurseve natyrore në PK "Sharri" është e kushtëzuar nga ndikimet negative të vazhdueshme të faktorëve biotik: njeriu, insektet, sëmundjet dhe abiotik: zjarri, era, bora, ortiqet etj.

6.2.2. Ekosistemet pyjore

Pyjet paraqesin ekosistemet më komplekse, më të rëndësishme por edhe më të rrezikuara në PK "Sharri". Gjendja e vështirë në veçanti paraqitet në pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichii*) në zonat e Koritnikut dhe Pishës së Madhe si pasoj e zjarreve (2000, 2007, 2012 dhe 2015) dhe zhvillimit të insekteve dëmtues (nënlivorësve). Nga djegiet masive të pyjeve dhe zhvillimit intensiv të insekteve dëmtues (nënlivorësve) janë tharë rreth 1000 ha të pyjeve në malin Koritnik dhe rreth 100 ha të pyjeve të rrobullit në zonën e Pishës së Madhe. Masa e tharë drunore ka filluar të kalbet, ndërsa shumë prej drurëve të thara janë rrezuar nga erërat malore.

Pyjet e ahut *(Fagetum montanum, Fagetum subalpinum)* janë të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (era, bora etj.) dhe prerjet ilegale. Dëmet nga fatkeqësitë natyrore, në veçanti, kanë qenë të shprehura në vitin 2015, kur në rajonet e Prevallës dhe Brezovicës nga shiu i akullt dhe erërat e fuqishme malore janë dëmtuar (thyer dhe rrezuar) rreth 1000 m^3 të drurëve të ahut të cilët, vitin 2016 dhe 2017, të cilat kanë qenë të përfshirë në pastrimet sanitare. Dëmet pyjore nga prerjet ilegale kanë qenë më të theksuara në rajonet e Brodit dhe Firajes të komunës së Shtërpcës si dhe në rajonin Jasikës të Lubotenit në komunën e Kaçanikut. Faktorët kryesor që kanë ndikuar në prerjet e theksuara ilegale janë:

- Gjendja e vështirë socio-ekonomike e popullatës rurale në zonën kufitare të PK "Sharri";
- Mungesa e menaxhimit institucional të territorit të PK "Sharri", respektivisht mos shtrirja e autoritetit menaxhues nga MMPH në komunat e Shtërpcës, Kaçanikut dhe Dragashit (në këto komuna DAPK "Sharri" nuk ka të punësuar rojtar të natyrës dhe zyrtar përkatës për mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve natyrore).
- Zvarritja dhe mosrealizimi i fletë padive në gjykatat përkatëse (kjo ndikon në stimulimin e vjedhësve të pyjeve dhe humbjet e mëdha financiare të buxhetit shtetëror si pasoj e mos realizimit të kompensimeve për dëmet e shkaktuara në PK "Sharri").

Pyjet e tjera të pastra dhe të përziera halore dhe gjethore në PK "Sharri" kanë stabilitet të mirë shëndetësor dhe zhvillimor. Dëmet pyjore nga fatkeqësitë natyrore dhe faktorët e tjerë (sëmundjet dhe insektet dëmtues) paraqitën në mënyrë sporadike dhe nuk kanë ndikim të veçantë ekologjik dhe ekonomik në këto pyje.

Ripërtëritja natyrore është e pamjaftueshme në pyjet e ahut dhe rrobullit, ndërsa më e theksuar paraqitet në pyjet e bredhit dhe arnenit. Kjo ka ndikuar në zgjerimin e sipërfaqeve të këtyre pyjeve, në veçanti të arnenit, në zonat e Pashallarës, Prockës së Durllës dhe Ujërave të Humbur.



Foto 25. Dëmët pyjore nga zjarret në pyjet e rrobullit në Koritnik

6.2.3. Ekosistemet barishtore

Gjendja e ekosistemeve barishtore, të cilët në veçanti janë të përhapura në komunën e Dragashit, është relativisht e mirë. Një pjesë e vegjetacioneve barishtore në zonat e maleve të larta mbi vegjetacionin pyjor shfrytëzohen si kullosa nga blegtorët sezonal (maj-shtator). Koncentrimi më i madh i bagëtive gjatë sezonës verore është në rajonet e Restelicës dhe Brodit (komuna e Dragashit) për shkak së këtu gjenden sipërfaqet më të mëdha dhe më kualitative të kullosave në PK "Sharri" dhe Kosovë.

Shumica e bimëve endemike gjenden në ekosistemet barishtore të maleve të larta të PK "Sharri". Në bazë të hulumtimeve të kryera është krijuar databaza për bimët me karakter endemik që numërojnë rreth 335 lloje dhe bimët mjekuese me rreth 500 lloje. Këto të dhëna tregojnë për biodiversitetin e jashtëzakonshëm të PK "Sharri" i cili radhitet ndër 6 qendrat kryesore të biodiversitetit në Evropë.

Gjatë viteve të fundit vërehet rritja e interesimit nga popullata lokale dhe bizneseve përkatëse për mbledhjen e bimëve mjekuese dhe frutave pyjore në gjithë territorin e PK "Sharri". Nga mbledhja nuk kursehen as bimët e rralla mjekuese në veçanti sanëza (*Gentiana lutea*) e cila është e rrezikuar për zhdukje. Baza ligjore dhe planifikuese për menaxhimin e bimëve mjekuese në PK "Sharri" është duke u kompletuar, ndërsa kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë organizata Gjermane GIZ e cila ka financuar projekt të veçantë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të bimëve mjekuese në nivel të Kosovës.



Foto 26. Kullosat e maleve të larta në PK. "Sharri", Restelicës

6.2.4. Zonat e para të mbrojtjes – Zonat strikte natyrore

Sipas Planit Hapësinor të PK "Sharri" (2014) në këtë Park gjenden 15 zona të para të mbrojtjes me sipërfaqe prej 9374.18 ha ose 17.60% nga territori i përgjithshëm i PK "Sharri". Këto zona gjenden kryesisht në pjesët më të larta të PK ku janë të koncentruar vlerat më të rëndësishme natyrore. Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2016, me vendim, i ka shpallur zona strikte të natyrës. Gjendja e këtyre zonave në përgjithësi është e mirë, ndërsa rrezikun më të madh paraqesin zjarret dhe intervenimet e faktorit njeri. Gjendja më e vështirë paraqitet në Koritnik ku pyjet e rrobullit gjatë pesë viteve të fundit kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret. Zonat strikte të natyrës me ekosisteme pyjore janë të rrezikuara edhe nga insektet dëmtues (nënlivorësit) dhe sëmundjet bimore (fitopatogjenet). Në zonat e para ku mbizotërojnë vegjetacionet barishtore paraqitet shfrytëzimi ilegal i kullosave. Për evitimin e kësaj dukurie ilegale nevojitet shenjëzimi i zonave të para të mbrojtjes në terren me shenja të dukshme dhe organizimi e seminarëve vetëdijësuese me blegtorët. Shumica e zonave strikte të natyrës shfrytëzohen nga vizitorët, në veçanti nga bjeshkatarët, për ecje në natyrë. Në të ardhmen aktivitetet e bjeshkatërisë në PK "Sharri" duhet të vihet nën mbikëqyrje të plotë.



Fig 3. Harta e zoonimit të Parkut Kombëtar "Sharri" (burimi: Plani Hapësinor i PK "Sharri", 2014)

6.2.5. Resurset ujore

Gjendja e resurseve ujore është relativisht e mirë. Shumë prej burimeve të ujit në të kaluarën janë marr në shfrytëzim nga fshatrat (komunitetet) lokale për t'i plotësuar nevojat për ujë të pijshëm. Ndotje të ujërave nuk ka pasur, por në disa zona turistike, në veçanti në zonën e gjerë të Prevallës, përgjatë lumenjve, përrockave dhe burimeve ujore janë krijuar mbeturinat e llojeve të ndryshme. Kjo çështje mund të rregullohet me menaxhimin institucional të mbeturinave në territorin e Parkut dhe ngritjes së vetëdijes qytetare për përkujdesje ndaj natyrës. Lumenjtë e PK "Sharri" paraqesin habitatin e troftës së përroskave, numri i të cilëve për çdo vit është duke u zvogëluar. Andaj në të ardhmen duhet planifikuar ripopullimin e lumenjve të Parkut me këtë lloj të rëndësishëm të peshkut. Peshkimi ilegal paraqitet kohë pas kohe, në veçanti në lumin e Manastericës dhe të Brodit.

Në vjeshtë të vitit 2017 është paraqitur një dukuri negative dhe shumë e rrezikshme për ekosistemet ujore në PK "Sharri". Bëhet fjalë për tentimin e shkatërrimit të lumenjve (Përroska e Durlës, Lumi i Kallugjerit dhe Blateshtica) me të rëndësishme në zonën e Brezovicës me qëllim të ndërtimit të hidrocentraleve. Problemi është edhe më i theksuar kur merret parasysh fakti së për këto veprime shkatërruese, për vlerat burimore natyrore të PK "Sharri" janë dhënë pëlqime mjedisore.



Foto 27. Zona e veçantë "Prrocka e Durlës"



Foto 28. Nderhyrjet në Prrockës së Durlës (hidrocentrali)

6.2.6. Fauna

Gjendja e faunës është relativisht e mirë, por rreziku i përhershëm për disa lloje të kafshëve (kaprojtë dhe dhitë e egra) paraqet gjuetia ilegale e cila shfaqet kohë pas kohe (posaçërisht vikendit) në disa zona të PK "Sharri", siç janë: Shutmani, Oshlaku, Bistra, Koxha Ballkani, Rusenica dhe Liqeni i Jazhincës. Me angazhimet e vazhdueshme në terren shumica e tentimeve për gjueti ilegale evitohen. Destinimi i kafshëve të vrara nga gjuetia ilegale janë restorantet në zonën e Zhupës dhe më gjerë, andaj për ndalimin e shitjes së mishit të ndaluar duhet më seriozisht të kyçët inspektorati përkatës komunal dhe qendror.

Nga hulumtimet e kryera, posaçërisht me vendosjen e kamerave kurth (monitoruese), në zonat malore të Oshlakut, Rusenicës, Pashallarës, Vrtopit dhe Brezovicës është konstatuar prania e shumëllojshme e faunës, në veçanti të gjitarëve (ariu i murrmë, ujku, dhelpra, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, shqarthi i bardhë, shqarthi i artë, lepuri, ketri, vjedulla, gjeri i lajthive etj.) dhe shpendëve (shqiponja e artë, shqiponja mijëngrënëse, skifteri malor, skifteri i përhimet, huti i madh, huti pyjor, pula e pyjeve, shkurtëza, thëllëza e gurit, etj.). Në bazë të gjurmëve të gjetura në terren është verifikuar edhe prania e rrëqebullit ballkanik *(Lynx Lynx balcanicus)* në zonat e Rusenicës, Vrtopit dhe Oshlakut. Këto zona edhe në të kaluarën ka qenë habitat i kësaj kafshe të rrallë dhe të rrezikuar për zhdukje. Zhvillimin më të mirë e kanë ariu i murrmë dhe ujku në gjithë territorin e PK "Sharri", ndërsa të rrezikuar janë, në veçanti, dhitë e egra dhe kaprojtë për shkak së paraqesin objekt atraktiv për gjueti ilegale.



Foto 29. Ariu i murrmë dhe dhija e egër në PK "Sharri"

6.2.7. Masat sanitare për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve

Me qëllim të evitimit të përhapjes së infektimeve dhe përmirësimit të gjendjes së pyjeve janë ndërmarr prerjet dhe pastrimet e kufizuara sanitare të pyjeve të dëmtuara nga zjarret, fatkeqësitë natyrore (era dhe dëbora), insektet dëmtues dhe sëmundjet bimore. Pastrimet sanitare aplikohen në bazë të legjislacionit (rregulloret për shërbime dhe rendin e brendshëm etj.) dhe planeve përkatëse menaxhuese.

Masa e dëmtuar dhe infektuar drunore që përfshihet në pastrimet sanitare vjetore (rreth 4.000 m^3)[7] paraqet minimumin e sasisë që ka prioritet të pastrohet nga pyjet publike dhe private me qëllim të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së ekosistemeve pyjore. Kjo masë drunore që realizohet nga pastrimet sanitare paraqet një përqindje të vogël (7 %) në krahasim me etatin (masën drunore vjetore) prej 63.000 m^3 dhe kapacitetin prodhues të pyjeve të PK "Sharri".[8]

Masa drunore nga pastrimet sanitare është dedikuar për plotësimin e nevojave për dru djegëse të komunitetit lokal. Kjo ka ndikuar në zbutjen e kërkesave të mëdha për dru djegëse në zonat rurale të PK "Sharri", parandalimin e prerjeve ilegale dhe krijimin e marrëdhënieve miqësore të DAPK "Sharri" me komunitetin lokal që paraqesin grupin e interesit me rëndësi të veçantë për PK "Sharri". Dobitë e pastrimeve sanitare janë të gjithanshme në aspektin ekologjik, social dhe ekonomik.

Me aplikimin e masave sanitare janë arritur këto objektiva:

[7] Raporti i punës i DAPK "Sharri" për vitin 2017
[8] Plani i Menaxhimit i PK "Sharri" (2015)

- Evitimi i zhvillimit të dëmtuesve entomologjik dhe fitopatologjik,
- Përmirësimi i gjendjes shëndetësore të pyjeve,
- Krijimi i kushteve optimale për ripërtëritjen dhe zhvillimin e pyjeve,
- Përmirësimi i funksioneve polivalente (ekonomike, ekologjike dhe sociale) të pyjeve,
- Furnizimi i popullatës lokale me dru djegëse (zjarri) në kuadër të kapaciteteve planifikuese,
- Parandalimi i prerjeve ilegale të pyjeve,
- Sigurimi e mjeteve financiare për buxhetin e MMPH.

6.2.8. Zonat turistike dhe ndërtimet në PK "Sharri"

Në PK Sharri gjenden 9 zona turistike me sipërfaqe prej 3769.81 ha (7.1%) që i takojnë zonës së tretë të mbrojtjes në bazë të Planit hapësinor të PK "Sharri"[9]: Guri i Dellocit - 22 ha (komuna Suharekë); Gradaci - 9 ha (komuna Suharekë); Prevalla - 31 ha (komuna Prizren); Ujërat e Gropuar (Shtëpia e Malorëve mbi Skorobisht) - 3 ha (komuna Prizren); Guri i Zi (Zaplluxhe) - 35 ha (komuna Prizren/ Dragash); Restelica - 109 ha (komuna Dragash); Brodi - 44 ha (komuna Dragash); Brezovica - 3426 ha (komuna Shtërpcë); Nënahishte - 91 ha (komuna Kaçanik).

Për këto zona është planifikuar hartimi i Planeve rregulluese detaje të cilët duhet të rregullojnë ndërtimet turistike dhe zhvillimin e veprimtarive komerciale në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK "Sharri". Zonat më të njohura turistike janë Prevalla dhe Brezovica ku turizmi është duke u zhvilluar në mënyrë stihike, pa menaxhim të mirëfilltë nga MMPH. Problemin më të madh në zonat turistike paraqet mirëmbajtja e pastërtisë, respektivisht menaxhimi i mbeturinave të cilët janë të përhapura në hapësirat natyrore e gjithashtu edhe vetëdija e ulët e vizitorëve të cilit i hedhin mbeturinat pa kontroll në hapësirat natyrore.

Ndër problemet më të mëdha në zonat turistike (zonat e treta natyrore) janë ndërtimet ilegale që vazhdimisht janë paraqitur nga përfundimi i luftës së vitit 1999. Problemi i veçantë është mosdefinimi i kompetencave për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore që ka ndikuar që institucionet e ndryshme lokale dhe qendrore të japin këto dokumentacione duke anashkaluar tërësisht autoritetin menaxhues të PK "Sharri". Në Prevallë dokumentacioni mjedisor dhe ndërtimor lëshohet nga Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit i MMPH-së, ndërsa në Brezovicë lëshohet nga komuna e Shtërpcës pa kritere mjedisore dhe konsultime me DAPK "Sharri". *Dhënia e lejeve ndërtimore duhet të ndërpritet deri në hartimin e Planeve rregullative për zonat e treta që janë paraparë me Planin Hapësinor dhe Planin menaxhues të PK "Sharri"*.

[9] Vendimi i Kuvendit të Kosovës nr. Nr. 04-V-772, shkurt 2014.



Foto 30. Ski qendra "Brezovica" *(Burimi: Indeksonline.net)*

6.2.9. Sfidat dhe problemet në PK "Sharri"

Nga sfidat dhe problemet e shumta më të cilët ballafaqohet Parku Kombëtar "Sharri", veçohen:

- Struktura organizative e pa kompletuar (mungojnë resurset humane ne komunat: Dragash, Shtërpcë dhe Kaçanik, sektorët përkatës profesional, zyret lokale në komunat);
- Mungesa e buxhetit dhe investimeve për menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Sharri";
- Mungesa e shenjëzimit të kufirit të jashtëm dhe të brendshëm (zonave të parë, të dytë dhe të tretë të mbrojtjes) në PK;
- Ndërtimet ilegale dhe tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore;
- Tentimet për ndërtimin e hidrocentraleve në lumenjtë e PK "Sharri" duke rrezikuar shkatërrimin masiv të vlerave burimore natyrore të cilët kanë ndikuar që ky territor të shpallet Park Kombëtar;
- Prerjet ilegale të pyjeve në malin Luboten (zonat e fshatrave Doganaj, Dubravë, Vataj, Lamaj, Sllatin, Brod, Firajë);

- Mos definimi i pronësisë së shumicës së ngastrave të cilët janë në pronësi shoqërore të ish kooperativave bujqësore dhe ekonomive pyjore. Nevojitet që këto prona shoqërore të transferohen në pronë publike të PK Sharri;
- Zvarritja dhe mosrealizimi i fletë-padive për vepra ilegale në Gjykatat përkatëse;
- Pasiguria e objekteve të DAPK "Sharri" në Prizren dhe Brezovicë në mungesë të rojtarëve;
- Rreziku permanent për resurset natyrore nga fatkeqësitë natyrore (era dhe bora), sëmundjet bimore dhe insektet dëmtues;

Edhe përkundër sfidave dhe problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet DAPK "Sharri" shumica e vlerave natyrore të Parkut janë mbrojtur dhe ruajtur.

6.2.10. Rekomandimet

Për të siguruar mbrojtjen e mirëfilltë të resurseve natyrore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Sharri" nevojitet ndërmarrja e masave të ndryshme, ndër të cilët veçohen:

- *Të ndërmerren masa shtesë nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, zjarret, insektet dëmtues dhe sëmundjet;*
- *Të shtohen aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e gjendjes dhe mbrojtjen e florës dhe faunës (bimëve endemike dhe mjekuese) dhe ekosistemeve në territorin e parkut dhe në rezervatet strikte që shtrihen në park;*
- *Të shtohen aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e vendeve turistike, monitorimin e pronave në pronësi private si dhe monitorimin dhe inspektimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore;*
- *Të rriten aktivitetet dhe veprimet që ndërlidhen me informimin dhe vetëdijesimi i publikut për mbrojtjen e parkut dhe promovimin e vlerave natyrore të PK Sharri, si dhe të ndërtohen qendrat informative në PK "Sharri;*
- *Të rritet bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe të koordinohen aktivitetet e përbashkëta;*
- *Të vazhdohet pjesëmarrje në projekte nacionale, ndërkufitare dhe regjionale për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar "Sharri";*
- *Të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të PK "Sharri" dhe te rritet numri i stafit profesional në park, etj.;*
- *Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim shkatërrues për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e PK "Sharri";*

- *Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të PK "Sharri" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe atë për PK "Sharri", Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare, Planin Hapësinorë dhe planin menaxhues të PK "Sharri";*
- *Të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në PK "Sharri";*
- *Të gjitha veprimtaritë dhe punimet të cilat realizohen brenda territorit të PK "Sharri" të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga Inspektorati i MMPH-së dhe DPK "Sharri";*
- *Dhënia e lejeve ndërtimore duhet të ndërpritet deri në hartimin e Planeve rregullative për zonat e treta që janë paraparë me Planin Hapësinor dhe Menaxhues të PK "Sharri".*
- *Funksionalizimi i pikave hyrëse në zonat turistike Brezovica dhe Prevalla;*
- *Hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat, procedurat, kompetencat dhe kushtet e ndërtimeve në parqet kombëtare;*
- *Hartimi i Planeve rregulluese detaje për zonat e treta në territorin e PK "Sharri" të cilët duhet të rregullojnë ndërtimet turistike dhe zhvillimin e veprimtarive ekonomike në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK "Sharri;"*
- *Të definohen kompentancat për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore etj.*

6.3. PARKU KOMBËTAR "BJESHKËT E NEMUNA"

Bjeshkët e Nemuna për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristike dhe faunistike paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe më interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe të tërë Gadishullit Ballkanik.

Bjeshkët e Nemuna përbën pjesën periferike perëndimore të Kosovës, të cilat zbresin gati vertikalisht dhe përfundon ne lindje dhe verilindje në fund të Rrafshit të Dukagjinit dhe në luginë të Ibrit, kurse në perëndim e mbyllin malet (kufiri) me Shqipërinë dhe Malin e Zi.

Bjeshkët e Nemuna janë ndër masivet malore më karakteristike të Ballkanit për sa i përket llojllojshmërisë floristike dhe vegjetative. Në këtë aspekt Bjeshkët e Nemuna paraqesin masivin malor ndër më të begatshmit në Ballkan me prani të mbi 1.000 llojeve deri më tani të hulumtuara, edhe pse ky numër nuk është definitiv meqenëse hulumtimet duhet vazhduar edhe më tej. Përveç kësaj në këtë numër nuk janë të përfshira hulumtimet për myshqet, likenet dhe kërpudhat.



Foto 31. Pejzash nga PK "Bjeshkët e Nemuna"

Sipas të dhënave të deritanishme në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme 33 lloje endemike dhe 6 subendemike si dhe mjaft lloje relikte të cilat patjetër duhet të merren nën mbrojtje rigoroze duke pasur parasysh vlerat e tyre shkencore dhe ekonomike.

Në kuadër të llojeve endemike duhet të përmendet se në Bjeshkët e Nemuna vetëm në zonën alpike dhe subalpike janë prezentë 128 lloje endemike të Ballkanit. Ndër llojet endemike të Kosovës në Bjeshkët e Nemuna janë edhe *Sempervivum kosaninii* (burgulli i Koshaninit), *Cephalaria pastricensis* (Cefalaria e Pashtrikut), *Astragalus fialae* (Arrithja e Fialit),

Aconitum pentheri (Akoniti i Rusolisë), *Rubus ipecensis* (Manaferra e Pejës), *Saxifraga scardica* (Iriqëza e Sharrit), *Wulfenia blecicii* (Vulfenia e Bleçiqit); *Centaurea nervosa* (Kokoçeli), *Thlaspi cuneifolium* (Tlaspi), *Thymus rohlenae* (Listra e Rohleries) etj.

Nga llojet relikte të përhapura në Bjeshkët e Nemuna karakteristike janë: *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë) e përhapur në kuadër të pyjeve të dushkut dhe ahut. Në Grykën e Rugovës gjenden në ekspozicionin verior, ndërsa në Malin e Thatë, Bjeshkët e Sinajit dhe Lebeniq në ekspozicionin jugor. Në afërsi të Bistricës së Lloçanit së bashku me te paraqitet edhe *Carpinus betulus* (shkoza e bardhë) i cili po ashtu është relikt i tercierit. Pos llojeve endemike autoktone në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme edhe shumë lloje endemike të Ballkanit ndër të cilat edhe *Crepis albanica* (Shmanga shqiptare), *Draba korabensis* (Draba e Korabit), *Cerastium dinaricum* (Cerasti dinarik), *Sempervivum macedonicum* (Burgulli maqedonas), *Euphorbia montenegrina* (Qumështorja malazeze) etj.

Masivi i Bjeshkëve të Nemuna karakterizohet me një faunë mjaftë të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës fauna e Bjeshkëve të Nemuna përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 178 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në territorin e Bjeshkëve të Nemuna janë: Rrëqebulli ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), Ariu i murrëm (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Shqiponja perandorake (*Aquilla heliaca*), Shqiponja e maleve (*Aquilla chrysaetos*), Faikoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), Pulëegra (*Tetrao urogallus*) etj, të cilat kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është duke përcjellë në vazhdimësi gjendjen me faunën në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna ", ndërsa rezultate me gjithëpërfshirëse ne lidhje me faunën e Kosovës e në këtë kuadër edhe të masivit Bjeshkët e Nemuna pritet të dalin me përfundimin e projektit të Librit të Kuq të Faunës së Kosovës i cili është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj në fund të vitit 2018.

6.3.1. Gjendja e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Një ndër problemet më të mëdha të evidentuara gjatë kësaj periudhe në territorin e parkut kombëtar "Bjeshkëve të Nemuna" janë prerja e pyjeve, ndërtimet ilegale, hapja e rrugëve, veprimtaria e gurthyesve brenda parkut, zjarret etj.

- Prerjet ilegale janë duke u bërë pothuajse në të gjitha komunat ku shtrihet territori i PK "Bjeshkët e Nemuna" me theks të veçantë në komunën e Deçanit dhe Pejës. Prerjet e pakontrolluara të pyjeve kanë pasoja të pariparueshme që përveç humbjes së masës drunore, reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemit, shqetësimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit etj.

Tabela 3. Prerja e pyjeve në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" 2015-2017[10]

	2015	2016	2017
Kërkesat	417	311	505
Prerjet nga pyjet private	1968 m^3	2260 m^3	3387 m^3
Prerjet nga pyjet publike	2972 m^3	3307 m^3	3092 m^3
Dru teknik	7983 m^3	1344 m^3	6959 m^3
Dëmet			
Fletëparaqitjet	114	108	113
Të arsyetura me fletëparaqitje	529 m^3	1051 m^3	788 m^3
Të arsyetuara me konfiskim	399 m^3	236 m^3	200 m^3
Të pa arsyetuara	338 m^3	858 m^3	Nuk janë evidentuar

Burimi: Drejtoria e PK "Bjeshket e Nemuna"



Foto 32. Prerjet e pyjeve në PK "Bjeshkët e Nemuna".

[10] Të dhënat janë nxjerr nga raporti i Drejtorisë së Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" Raport për zjarret, ndërtimet dhe prerjen ilegale dhe legale të pyjeve 2018, i përgatitur për nevojat e raportit të Natyrës.

- Ndërtimet ilegale janë shtrirë gjerësisht në të gjitha zonat e parkut por më të atakuarat mbeten zonat potenciale turistike, si në Grykën e Rugovës, Bogë, Leqinat, Gropa e Erenikut, Lugu i Butë, Burimi i Drinit të Bardhë etj. Deri me tani në kuadër të parkut janë identifikuar mbi 3000 ndërtime pa leje duke ndikuar në degradimin e peizazhit dhe habitateve të florës dhe faunës[11].



Foto 33. Ndërtimet ilegale në Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

- Në kuadër të parkut aktivitetin e zhvillojnë e dhe dy gurthyes të cilët paraqesin degradim të vlerave të natyrës. Gurthyesi i parë ndodhet 500 m, në brendi të parkut, kurse i dyti 150 m. Gjithashtu në zonën buferike prej 100 metrash afër kufirit të parkut aktivitetin e zhvillojnë edhe dy gurthyes të tjerë. Aktiviteti i gurthyesve në park është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233), Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Nr. 04/L-086), Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare 21/2013. Prezenca e gurthesve në park ka ndikuar në shqetësimin dhe dëmtimin e florës dhe faunës.

[11] Raporti nga incizimi i gjendjes faktike, fotografimi, evidentimi i objekteve të ndërtuar dhe verifikimi i lejeve të ndërtimit në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (2014), AMMK, Nr. Prot. 45/83-2014, Prishtinë.



Foto 34. Aktiviteti i gurthyesve brenda territorit të PK “Bjeshkët e Nemuna”.

- Fragmentimi i habitateve nga infrastrukturës rrugore janë dukuri të shpeshta gjatë kësaj periudhe. Përveç akseve rrugore brenda vendbanimeve akset me ndikim më të madh janë rruga: Maja e Zezë- Peklenë - Shtupeq i Vogël - Varri i Sykyt, Junik - Livadh i gjatë - Gropat e Erenikut, Lugu i Butë - Stanet e Mehajve dhe Haxhiajve, rruga në Grykën e Lloqanit, rruga Gryk e Rugovës - Milishevc etj. Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve është nje problem shqetësues në PK. “Bjeshkët e Nemuna” Një numër i madhe i rrugëve të hapura fillojnë me para masë dhe para llogari, pa plane dhe projekte të detajuar, pa pëlqime mjedisore dhe pa studime të mirëfillta të ndikimit në mjedise. Fragmentimit të habitateve të ndryshme që rezulton me pengesa të tilla si rrugët dhe infrastruktura tjetër, mund të pengoj emigrimin e shumë llojeve shtazore, të shkaktoj ndryshime në strukturën e llojeve dhe një rënie të vazhdueshme në biodiversitetin.
- Gjithashtu hapja dhe zgjerimi i akseve rrugore është përcjell edhe me fenomene tjera negative siç është paraqitja e erozionit (rrëshqitjeve). Si pasoje e prerjeve të pjesëve anësore të rrugës, prerjes së bazës së faqeve të malit ka ardhur deri të procesi i rrëshqitjeve të masave shkëmbore që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme.



Foto 35. Rrëshqitja nga hapja e rrugëve në PK "Bjeshkët e Nemuna"

- Ndërtimi i hidrocentraleve brenda zonave të mbrojtura në përgjithësi dhe Parqet Kombëtare në veçanti, shoqërohet me ndikime të drejtpërdrejta në vlerat e përgjithshme natyrore, florën dhe faunës ujore dhe tokësore, peizazhin, habitatet specifike, e veçanërisht mbi faunën ku më të rrezikuarat janë llojet ujore, si peshqit, vertebrorët të tjerë ujorë etj.

  Rrjedha e ujit është element përcaktues i mjedisit fizik në lumenj i cili është përcaktues kryesor i përbërjes biotike: me ndikim në ndryshimin e habitateve tek bimët ujore dhe ato rreth shtratit të lumit, ndryshimin e habitateve tek invertebrorët, ndryshimin e habitateve të peshqit dhe vertebrorët të tjerë ujorë etj.

  Devijimi i ujit nga rrjedha natyrore për nevoja të hidrocentraleve ndikon në ndryshimin e lagështisë së ajrit dhe mikroklimës e që për pasojë do të sjellë reaksion zinxhirë për shumë lloje shtazore ujore, si peshq, insekte të ujit, molusqe, flutura, bretkosa, triton, shpendë ujorë, por edhe për bimët që gjenden në vet shtratin e lumit. Kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në disa habitate të rëndësishme për florën, faunën, peizazhin natyror, si dhe dukuri të tjera të lidhura me të, siç mund të jetë erozioni, apo rrëshqitjet masive të pjesëve shkëmbore të maleve përgjatë luginës së lumenjve.

  Tjetërsimi dhe devijimi i ujit në tubacione dhe tunele nga hidrocentralet do të zvogëlojë sasinë e lagështisë së ajrit që do të shoqërohet me rritjen e temperaturave në pellg, si rrjedhojë pyjet halorë rrezikohen të zhduken (hormoqi-*Picea abies*) i cili është mjaft e ndjeshme ndaj mungesës së lagështisë së ajrit. Ndikimi negativ në rastin e këtij lloji është direkt, pavarësisht se shtrihet pak më lart vendit të marrjes së ujit. Po kështu lagështia ajrore e reduktuar nga devijimi i ujit do të ndikojë edhe në vegjetacionin e Kërlekës (Pinus mugo), etj.

  Një shembull i tillë i shkatërrimit të këtyre vlerave natyrore është funksionimi i Hidrocentralit në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", në Grykën e Deçanit ku është degraduar shtrati burimor i lumit dhe mund të thuhet se është shkatërruar e gjithë fauna që lidhet më rrjedhjen e

Lumëbardhit të Deçanit. Përgjatë luginës së rrjedhave lumore të përshtatshme për ndërtim të hidrocentraleve gjenden shumë lloje bimore dhe shtazore të rralla e të rrezikuara, siç janë: *Pinus peuce, Pinus heldreichii, Abies alba, Picea excelsa, Cerastium alpinumn, Saxifraga stellaris, Saxifraga aizoides, Nartecium scardicum, Cirsium candelabrum, Tanacetum vulgare, Angelica pancicii, Achillea grandifolia, Salix eleagnos* etj. Nga llojet shtazore të pranishme në këto zona, janë edhe disa prej atyre që gjenden në Anekset e Direktivave të e BE-së për Habitatet dhe Shpendët. Vlenë të përmendim: Lundërzën (*Lutra lutra*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Ariun e murrmë (*Ursus arctos*), Kaprollin (*Capreolus capreolus*), Macën e egër (*Felis sylvestris*), Vjedullën (*Meles meles*), Rrëqebullin Ballkanik (*Lynx lynx balcanicus*), shpendët si Gjelin e egër (*Tetrao uragullus*), Thëllëzën e malit (*Alectoris graeca*), Shqiponjën e maleve (*Aquila chrysaetos*), Mëllenjën e ujit (*Cinclus cinclus*), peshqit si Troftën e përrenjve (*Salmo trutta* m. Fario), Troftën e mermertë (*Salmo marmoratus*) etj. Vlen të veçohet se Rrëqebullin (*Lynx lynx*), është vërejtur pas shumë viteve në territorin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

Nga ndërtimi i hidrocentraleve në Grykën e Deçanit janë konstatuar ndërhyrje të konsiderueshme përgjatë aksit rrugore dhe shtratin e lumit ku kompania është duke vazhduar me implementimin e projektit.

Ndërhyrjet me dëmtim të vlerave natyrore janë shkaktuar me rastin:

- zgjerimit të aksit rrugor, me që rast me prerjen e pjesëve anësore të rrugës ne shumë vende ka ardhur deri te procesi i rrëshqitjeve të masave që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme (panevojshme);
- hapjes se kanalit për vendosjen e gypave, ndërhyrje janë realizuar në brigjet e lumit dhe vet shtratin e tij;
- shfrytëzimit pa asnjë kriter të zhavorrit të Zalli i Rupës, ku janë degraduar sipërfaqe të konsiderueshme;
- si pasoje e shfrytëzimi të ujit nga hidrocentrali ka ardhur deri te zvogëlimi i sasisë së ujit në lumbardhën e Deçanit dhe shkatërrimin e biodiversitetit të lumit.




Foto 36. Ndërtimi i hidrocentrali në Grykën e Deçanit, PK "Bjeshkët e Nemuna".

Gjatë monitorimeve të zonës është konstatua gjendja jo e mirë në aksin rrugore përgjatë Grykës së Lumëbardhit të Deçanit si pasoj e shfaqjes të erozionit në një pjesë të konsiderueshme të rrugës. Ndërhyrjet përgjatë këtij aksi rrugor kanë shkaktuar paraqitjen e disa pengesave për qarkullimin e lirë në këtë pjesë të rrugës.

Gjithashtu, gjendja jo e mirë e shtratit të lumit Lumbardh është për shkak të sasisë shumë të vogël të ujit që rrjedh. Kjo gjendje vazhdon të jetë e tillë nga veprimtaria e hidrocentraleve të ngritura përgjatë rrjedhës së lumit Lumbardh. Veprimtaria e këtij hidrocentrali gjithashtu ka shkaktuar degradime edhe në shtratin dhe brigjet e lumit.

Hidrocentralet brenda Parqeve Kombëtare janë në kundërshtim edhe me Direktivat dhe Konventat ndërkombëtare si: Konventa e Bernës, Konventa e Diversitetit Biologjik, Direktiva e Habitateve natyrore, Direktiva kornizë e për ujërat (2000/60/EC), Direktiva për ruajtjen e vendbanimeve të florës dhe faunës së egër (92/43/EEC), Direktiva për ruajtjen e zogjve të egër (2009/147/EC) etj. *(Rezoluta e Parlamentit Evropian, 15 shkurt 2017, raporti nr 2016/2312 - INI, kritikon ashpër Qeverinë e Shqipërisë dhe kërkon ndalimin e menjëhershëm të ndërtimit të Hidrocentraleve në Lumin Vjosa dhe shpalljen e lumit Vjosa Park Kombëtarë).* Meqenëse Kosova së shpejti do të jetë nënshkruese e direktivave dhe konventave ndërkombëtare, duhet të respektohen këto konventa. Institucionet e Kosovës duhen të angazhohen në përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës me Direktivat e Bashkimit Evropian, kështu që tërë potenciali intelektuale duhet të fokusohet në kompletimin dhe miratimin e listës së llojeve dhe habitateve të biodiversitetit në Kosovë, që janë me interes për BE-në.

6.3.2. Hartimi i Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Instituti për Planifikim Hapësinor, (AMMK) ka hartuar Draft-dokumentin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Gjatë këtij procesi janë organizuar një mori takimesh me pjesëmarrës të fushave, profesioneve dhe strukturave të ndryshme. Bashkëpunim i rëndësishëm është realizuar në takimet me Grupin Punues Ndërministror, si dhe me anëtarë të sektorëve të rëndësishëm të Qeverisë së Kosovës.

Pjesë e veçantë e kësaj pune kanë qenë takimet me autoritetet e komunave pjesëmarrëse dhe komunitetin që jeton në brendinë e Parkut. Kontributi i të gjithëve ka qenë shumë i vlefshëm, janë mbledhë informata të shumta, janë marrë sugjerime dhe vërejtje të rëndësishme, me ndihmën e të cilave kemi arritur të përfundojmë këtë dokument shumë të rëndësishëm për Parkun tonë Kombëtar.

Aktualisht Plani Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna" me të gjitha dokumentet përcjellëse, duke përfshirë edhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor është në procedurë të miratimit në Qeverinë e Kosovës. Miratimi i tije do të bëjë të mundur zgjidhjen e shumë paqartësive, me të cilat aktualisht është duke u ballafaquar, drejtoria e PK "Bjeshkët e Nemuna" Komunat dhe Investitorët. Aprovimi i këtij dokumenti do të ndikoj në zhvillimin ekomomik, turistik të kësaj zone dhe do të ndaloj ndërtimet ilegale në park.



Fig 4. Harta e zoonimit të PK Bjeshkët e Nemuna

6.3.3. Sfidat dhe problemet në menaxhimin e PK "Bjeshkët e Nemuna"

- Mungesa e Planit Hapësinor dhe Planit Menaxhues;
- Mungesa e stafit profesional;
- Rreziku permanent për resurset natyrore nga ndikimet negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet dëmtues dhe fitopatogjenet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.);
- Mungesa e shenjëzimit të kufirit të jashtëm dhe të brendshëm (zonës së parë, të dytë dhe të tretë) të PK;
- Transformimi i pronave shoqërore të ish ndërmarrjeve shoqërore bujqësore (kooperativave) dhe pyjore (ekonomive pyjore) në pronësi të PK "Bjeshkët e Nemuna";
- Tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore;
- Ndërtime ilegale dhe pa kriter në PK "Bjeshkët e Nemuna" etj.

Edhe përkundër sfidave dhe problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet DAPK "Bjeshkët e Nemuna", pjesa e konsiderueshme e vlerave natyrore të parkut janë mbrojtur dhe ruajtur.

6.3.4. Rekomandime

Për të siguruar mbrojtjen e mirëfilltë të resurseve natyrore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Bjeshkët e Nemuna" nevojitet ndërmarrja e masave të ndryshme, ndër të cilët veçohen:

- *Të miratohet Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"*
- *Të hartohet Plani Menaxhues për PK Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të ndërmerren masa shtesë nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, zjarret, insektet dëmtues dhe sëmundjet;*
- *Të shtohen aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e gjendjes dhe mbrojtjen e florës dhe faunës (bimëve endemike dhe mjekuese) dhe ekosistemeve në territorin e parkut dhe në rezervatet strikte që shtrihen në park;*
- *Të shtohen aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e vendeve turistike, monitorimin e pronave në pronësi private si dhe monitorimin dhe inspektimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore;*
- *Të rriten aktivitetet dhe veprimet që ndërlidhen me informimin dhe vetëdijesimi i publikut për mbrojtjen e parkut dhe promovimin e vlerave natyrore të PK "Bjeshkët e Nemuna", si dhe të ndërtohen qendrat informative në PK Bjeshkët e Nemuna",*
- *Të rritet bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe të koordinohen aktivitetet e përbashkëta;*

- *Të vazhdohet pjesëmarrje në projekte nacionale, ndërkufitare dhe regjionale për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të PK "Bjeshkët e Nemuna", dhe të rritet numri i stafit profesional në park etj.;*
- *Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim shkatërrues për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda territorit të PK Bjeshkët e Nemuna", të jenë në harmoni me në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe atë për PK "Bjeshkët e Nemuna", Rregulloren për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare;*
- *Të ndalohen ndërtimet e hidrocentraleve në PK Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të gjitha veprimtaritë dhe punimet të cilat realizohen brenda territorit të PK "Bjeshkët e Nemuna", të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme nga Inspektorati i MMPH-së dhe DPK "Bjeshkët e Nemuna";*
- *Hartimi i Udhëzimit Administrativ për rregullat, procedurat, kompetencat dhe kushtet e ndërtimeve në parqet kombëtare;*
- *Hartimi i Planeve rregulluese detaje për zonat e treta në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna", të cilët duhet të rregullojnë ndërtimet turistike dhe zhvillimin e veprimtarive ekonomike në përputhje me mbrojtjen e vlerave natyrore të PK "Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të definohen kompentancat për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore;*
- *Të ndalohen operimet i gurthyeseve dhe i sharrave në Pakun kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".*

6.4. ZONAT E VEÇANTA – ZVM dhe ZVR

6.4.1. Ligatina e Hencit - Radevës, zonë e veçantë e mbrojtur e zogjve

Ligatina e Hencit - Radeves gjendet në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtare "Adem Jashari" në mes të fshatrave, Henc, Vrellë dhe Radevë dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej 109 ha 52 ari. Ligatina e Hencit - Radeves është i vetmi ekosistem i llojit të tillë në Kosovë, edhe pse i formuar në mënyrë artificiale, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogjeologjike, botanike, peizazhore etj. Për shkak të këtyre vlerave ne vitin 2014 është nxjerr Vendimi për shpalljen e saj Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.



Foto 37. Ligatina e Hencit - Radeves

Në aspektin floristik, sipas konstatimeve të bëra nga IKMN-ja, kjo zonë është e pasur me lloje bimore. Ligatina e Hencit - Radeves është zonë e pasur edhe nga aspekti i zoodiversitetit ku deri më tani është konstatuar se jetojnë një numër i madh i llojeve të faunës së egër e prej tyre numrin më të madh e përfaqësojnë shpendët e egra me rreth 80 lloje, numër ky që mendohet se të jetë shumë më i madh duke pasur parasysh se asnjëherë deri tani nuk është kryer ndonjë hulumtim sistematik në nivel të dëshiruar.

Habitatet natyrore të Ligatinës se Hencit - Radeves me rrethinë ofrojnë vendstrehim për shume lloje të shpendëve, shumë prej tyre lloje të rralla dhe me status të pafavorshëm të ruajtjes tek ne dhe Evrope.

Që nga viti 2014 në zonë janë te ndaluara të gjitha veprimtaritë ekonomike si: peshkataria, gjuetia, etj. E gjithë zona e Ligatinës së Hencit - Radeves është pronë publike dhe menaxhohet nga Agjencioni Kosovar për Privatizim (AKP).



Foto 38. Bilbilthi fushor i kallamave *(Acrocephalus arundinaceus)*



Foto 39. Gakthi *(Ixobrychus minutus)*

6.4.2. Gjendja

Meqenëse zona nuk e ka organin menaxhues pasojat e sajë vërehen çdo ditë e më tepër. Problem më i theksuar mbetet tharja e baseneve dhe zonave tjera përreth për shkak të ndaljes së rrjedhjes së ujit në to e cila shprehet me mungesë të peshqve që janë ushqim kryesor për llojet e zogjve të pranishëm në këtë zonë ku numri i tyre në krahasim me vitet e mëhershme ka rënë në mënyrë drastike.

Problem tjetër mjaftë shqetësues mbetet dukuria e djegies së kallamishteve përreth baseneve e të cilat shërbejnë si një vendstrehim për shumë lloje te shpendëve ujore e gjithashtu edhe si vend ku shumica prej atyre llojeve folenizuese i ndërtojnë foletë e tyre.

Ndikim tjetër ka edhe gjuetia ilegale dhe e pakontrolluar nga persona të pandërgjegjshëm në llojet e zogjve prezentë, e cila edhe pse me një trend shumë më të vogël nëse vazhdon kështu sigurisht që do të rrezikojë prezencën e një numri të madh llojesh posaçërisht atyre shtegtare.

Vlen të përmendet gjithashtu se në kufi të kësaj zone gjendet edhe Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”. Sipas zyrtarëve të aeroportit numër i madhe i shpendëve dhe afërsia e Ligatinës me aeroportin, paraqesin shqetësim për sigurinë në aeroport, andaj mbetet që në të ardhmen të punohet bashkërisht në mënyrë që të rritet siguria maksimale e përgjithshme në aeroport.

6.4.3. Rekomandimet

- *Autoritetet e Aeroportit Ndërkombëtare "Adem Jashari" të bëjnë monitorimin e numrit të zogjve dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e kushteve të sigurta në hapësirën e aeroportit dhe përreth tij;*
- *Të themelohet organi për administrimin dhe menaxhimin me ketë zonë;*
- *Të hartohet Plani për Menaxhimin e Ligatinës;*
- *Hartimi i një projekti për studimin e mundësive te funksionalizimit te kësaj zone;*
- *Vazhdimi i hulumtimeve me qëllim të inventarizimit të llojeve dhe habitateve;*
- *Prona që menaxhohet nga Agjencioni Kosovar për Privatizim (AKP) të bartet në përgjegjësi të MMPH -së.*

6.5. PARK NATYRE

6.5.1. Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicës

Malet e Pashtrikut, krahas atyre të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna, janë qendër e rëndësishme e biodiversitetit, jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Bazuar në hulumtimet e gjer tanishëm është konstatuar se kjo zonë është shumë e pasur në aspektin, floristik, faunistik dhe me forma të llojllojshme gjeomorfologjik ku gjenden një numër i madhe i shpellave dhe i humnerave (gjeomonumente) të cila ende nuk janë hulumtuar.



Foto 40. Kokoçel i Koshaninit



Foto 41. Kokoçel purpur i errët

Liqeni i Vërmicës është krijuar në rrjedhën e poshtme të Drinit të Bardhë në dalje të lumit, në territorin e Shqipërisë dhe karakterizohet me vlera të veçanta hidrologjike, biologjike, biogjeografike, gjeologjike dhe peizazhore. Në ketë zonë, lumi ka krijuar gryken epirogjenike e cila

paraqet monument të rëndësishëm me karakter gjeomorfologjik. Gjithashtu si zonë ndërkufitare paraqet potencial shumë të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në këtë pjesë.




Foto 42. Mali Pashtrik dhe Kanioni i Drinit të Bardh

Ministri i Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 13.11.2015 ka nxjerr Vendimin nr. 54/2015 për vënien nën Mbrojtje Paraprake të një pjese të Malit Pashtrik dhe Liqenit të Vërmicës si zone potenciale për shpallje Vlerë e Mbrojtur e Natyrës në kategorinë e Parkut të Natyrës.

6.5.2. Rekomandimet

- *Të merret vendim për mbrojtje të përhershme;*
- *Vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme floristike dhe faunistike;*
- *Mbrojtja e llojeve të rrezikuara bimore dhe shtazore;*
- *Ndalimi i ndërtimi të objekteve ilegale;*
- *Mos lejimi i grumbullimit të pakontrolluar të llojeve bimore, posaçërisht atyre mjekësore*
- *Masat për pastrimin e tërësishëm të Malit Pashtrik nga minat;*
- *Promovimi i vlerave natyrore, kulturore, turistike dhe prodhimeve tradicionale të zonës ndërkufitare;*
- *Të merren masat për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në kanionin e Dinit të Bardhë;*
- *Të bëhet pastrimi nga mbeturinat në zonë;*
- *Të realizohen projekte ndërkufitare Kosove -Shqipëri.*

6.6. MONUMENTET E NATYRËS

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës për nga numri zënë vendin e parë me 157 zona, ndërsa për nga sipërfaqja vendin e tretë me 6059.79 ha. Prej tyre 2 Monumente janë të Rëndësisë së Veçantë, (Ujëvarat e Mirushës dhe Shpella e Gadimes), 111 monumente të karakterit botanik, 20 hidrologjik, 15 speologjik, 9 gjeomorfologjik. Monumentet e natyrës në të cilat ka pas ndikime më të mëdha gjatë këtyre tri viteve të fundit janë: Shpella e Gadimes, Ujëvarat e Mirushës, Bifurkacioni i lumit Nerodime, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit, etj.

6.6.1. Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes"

Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" ndodhet në fshatin Gadime e Ulët të Komunës së Lipjanit. Është e lokalizuar në kodre e "Mërturit", ndërsa hyrja ndodhet në pjesën e poshtme të grykës së lumit (përroskës) Klysura në lartësi mbidetare 580 metra.

Pas zbulimit shpella është marrë nënë mbrojtje ligjore në vitin 1969, me sipërfaqe të përgjithshme prej 38.6 ha. Për shkak të vlerave të mëdha, kristaleve, dukurive shpellore interesante dhe pozitës së përshtatshme shpella përgatitet dhe hapet për vizitor në vitin 1976.

Me datë 13.03.2009, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin nr. 04/57, sipas të cilit "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulët të komunës së Lipjanit, vihet nën mbrojtje si Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë, me sipërfaqe prej 39 hektar.

Shpella e Gadimes paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërfutur në rreshpet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë raritet edhe me përmasa botërore.

Shpellën e bëjnë të veçantë prezenca e aragoniteve. Kristalet e këtyre stolive, në shpellë paraqiten në galerinë e Aragoniteve të cilat karakterizohen me forma dhe drejtime të ndryshme të shtrirjes të cilat shpellën e bëjnë posaçërisht interesante dhe tërheqëse.

Në aspekt hidrologjik shpella e Gadimes është e pasur me ujëra nëntokësore. Në të njëjtin horizont paraqiten të gjitha llojet e ujërave të shpellave: ujërat e kondensuar, pikues, rrjedhës dhe qëndrues duke e shndërruar shpellën e Gadimes në objekt të veçante në aspekt hidrologjik.



Foto 43. MNRV "Shpella e Gadimes"

Gjendja

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ende nuk ka arritur të themeloj drejtorin për menaxhimin dhe administrimin e monumentit të natyrës më rëndësi të veçantë "Shpella e Gadimes" duke përfshirë mbikëqyrësin, ciceronet, sigurimin, etj., kështu që menaxhimi dhe administrimi realizohet nga staf më kontratë të përkohshëm. Nga maj i vitit 2014 deri në fund të 2017 në bazë të evidencës së administratës, shpellën e kanë vizituar mbi 100 mijë vizitorë nga vendi dhe regjioni.

Tabela. 4. Numri i vizitorëve në Monumentin e Natyrës me Rendësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" 2014-2017

Viti	Numri i përgjithshëm vizitorëve	Numri i vizitorëve me pagës	Numri i vizitorëve të liruar nga pagesa
2014	17.844	14.847	2997
2015	31.355	28.240	3115
2016	28.000	25.630	2370
2017	28.800	27.434	1366
Gjithsejtë	105999	96151	9848

Burimi: MNRV "Shpella e Gadimes"

Edhe përkundër investimeve të realizuara në periudhën 2015-2017, Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçante "Shpella e Gadimes", ballafaqohet me probleme siç janë:

- Menaxhimi joprofesional i shpellës, me staf më kontratë të përkohshëm;
- Shqetësim për sigurinë në shpellë paraqesin rrëshqitjet e ndryshme të cilat vinë nga oxhaqet të shpellës sidomos në periudhat e lagështa kur ka lëvizje të argjilës;
- Rreziku i shembjes dhe rënies së copave të shkëmbinjve në korridoret që frekuentohen nga vizitorët;
- Edhe pse ka pasur intervenime dhe përmirësime, problemi në shpellë mbetet ndriçimi;
- Nga monitorimi në terren dhe njoftimi nga stafi i shpellës është konstatuar se kablloja kryesore e rrjetit elektrik nuk është ndërruar dhe në disa raste paraqet rrezik për vizitor;
- Gjithashtu vlen të theksohet se ndriçimi në shpellës nuk është i instaluar në mënyrë profesionale, me qenë se një numër i madhe i dritave janë orientuar drejt stazës së vizitorëve;
- Ndriçimi në shpellë nuk fiket automatikisht pas largimit të vizitorëve nga galeria, por shpella është e ndriçuar gjatë gjithë kohës së prezencës së vizitorëve në shpellë, e që gjithashtu paraqet problem për shpellën;
- Paraqitja e myshqeve dhe kërpudhave si pasojë e ndryshimeve mikroklimatike, të kushtëzuar me mbylljen hermetike të hyrje-daljes si dhe ndriçimi afatgjatë dhe jo adekuat;
- Mbishkrimet dhe grafitet nëpër korridoret e shpellës, dëmtojnë imazhin dhe origjinalitetin e shpellës etj.

Rekomandimet:

- *Themelimi i organit për menaxhimin dhe administrimin e MNRV "Shpella e Gadimes";*
- *Të ndermirën masa urgjente për sigurinë e vizitorëve nga rrëshqitja e argjilës dhe materialeve tjera me vendosen e rrjetave mbrojtëse;*
- *Të ndermirën masa urgjente për përmirësimin e rrjetit elektrik në shpellë me qëllim të rritjes së sigurisë për vizitor;*
- *Të përgatitet plan menaxhues për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes";*
- *Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) dhe rregulloren (MMPH, Nr 23/2014);*
- *Inspektorati i MMPH të merr masa ndaj ndërtimeve ilegale dhe objekti i cili ka qenë pronë e shpelle ti kthehet organit menaxhues;*

- *Të hulumtohen korridoret dhe galeritë tjera në shpellën e Gadimes;*
- *Të bëhet monitorimi i përhershëm i parametrave gjeo-klimatik;*
- *Të bëhet promovimi i shpellës së Gadimes si pikë gjeoturistike në Kosovë dhe regjion;*
- *Të sigurohen mjete financiare për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes".*

6.6.2. Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës"

Monumenti i natyrës "Ujëvarat e Mirushës" është një ndër zonat më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës, i cili shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec.

Ujëvarat e Mirushës janë shpallur Park Regjional i Natyrës në vitin 1982/83 nga Komuna e Klinës dhe Rahovecit, tanimë e trashëguar nga Komuna e Malishevës me sipërfaqe prej 555.80.70 ha. Qeveria e Republikë së Kosovës në vitin 2012 ka nxjerr vendim për shpalljen e Ujëvarave të Mirushës, Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë me sipërfaqe prej 598.4 ha. Lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Në këtë pjesë të kanionit janë 16 liqene me ujëvara të cilat së bashku krijojnë një fenomen morfo-hidrologjik që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanionit.

Forma karakteristike në përbërjen e relievit përveç ujëvarave dhe liqeneve janë edhe shpellat me forma dhe madhësi të ndryshme (Shpella e Dushit, Shpella e Kishës së Madhe dhe të Vogël, Shpella të liqeni i dhjetë).

Lokaliteti i Ujëvarave të Mirushes është mjaftë i pasur me lloje bimore, në të cilin dallojmë 330 lloje të bimëve vaskulare dhe 44 lloje të kërpudhave të larta (makromicetet).

Llojet e bimëve endemike që janë konstatuar në kete zone janë: Petriku i Grojterit (*Aristolochia merxmuelleri*), Ylli shqiptar (*Aster albanicus*), Kokoçeli i Albertit *(Centaurea albertii),* Kokoçeli i Koshaninit *(Centaurea kosaninii*), Boshtra europiane *(Forsythia europaea),* Fumana e Bonopartit *(Fumana bonopartei),* Gjineshtra e Hasertit *(Genista hassertiana),* Halaqi i Sentnerit *(Halacsya sendtneri),* Knaucia maqedonase *(Knautia macedonica),* Liri i hijshëm *(Linum elegans)*, Poligala e Doerflerit *(Polygala doerfleri)*, Zorrëca e Visianit *(Potentilla visianii*), Lulekomishti shqiptar (*Sanguisorba albanica*), Pendëkaposhi i Majorit *(Stipa mayeri*), *(Moltkia doerfleri)*. Prej tyre lloji (*Aristolochia merxmuelleri*) dhe (*Stipa mayeri*) janë lloje stenoendemike.

Në aspektin faunistik ky territor është shumë i pasur me lloje të veçanta të shtazëve, të cilat janë të lidhura për biotope specifike dhe i përkasin llojeve endemike. Në park janë vërejtur këto lloje të shtazëve: Ujku (*Canis lupus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Vjedulla (*Meles meles*), Maca e egër (*Felix silvestris*), Sqarthi (*Martes martes*), Miu bizam (*Ondata zibethica*), Miu i verdhë malor (*Apodemus flaviocollis*), gjarpri i gurit (*Vipera amodytes*), etj.



Foto 44. Ujëvarat e Lumit Mirusha

Gjendja

Edhe pse Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Planin Hapësinore për zonën e mbrojtur "Ujëvarat e Mirushes" (2014) qëllimi i të cilit është të ndikojë në ndalimin e zhvillimeve të pa planifikuara që dëmtojnë zonën, dukurit negative kanë vazhduar edhe gjatë viteve 2015-2017. MMPH ende nuk e ka themeluar organin menaxhues për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës", e paraparë sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

Në MNRV "Ujëvarat e Mirushës" edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar këto probleme:

- Mungesa e legjislacionit për rregullimin e menaxhimit të përhershëm të zonës;
- Mungesa e organit menaxhues;
- Mungesa e burimit të qëndrueshëm financiar për organin e mbikëqyrës dhe investimet;
- Ndërtimet ilegale në zonën e mbrojtur;
- Mungesa e shenjave informuese.




Foto 45. Ndërtimet ilegale në MNRV "Ujëvarat e Mirushës"

Rekomandimet

- *Të themelohet organi menaxhues për MNRV "Ujëvarat e Mirushes";*
- *Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MNRV "Ujëvarat e Mirushës" të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Planin Hapësinore për zonën e mbrojtur Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushes";*
- *Të rrënohen të gjitha ndërtimet ilegale në këtë zonë;*
- *Të ndërtohet qendra informuese turistike në MNRV "Ujëvarat e Mirushes";*
- *Të vendosen tabelat informuese.*

6.6.3. Bifurkacioni i Lumit Nerodime

Bifurkacioni i Lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy dete. Lumi i Nerodimës buron në Bjeshkët e Jezercit; në afërsi të Ferizajt ndahet pakthyeshëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega e majtë derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega e djathtë përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në Detin Egje.

Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për shumë studiues (gjeograf, gjeolog, hidrolog, biolog, historian) etj., dhe ka rëndësi të madhe edukativo-arsimore, shkencore rekreativ dhe turistike.

Bazuar në vlerat e larta shkencore, edukative, turistike etj., Bifurkacioni i Lumit Nerodime është shpallur zonë e mbrojtur - Rezervat special i natyrës në vitin 1979 nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, me sipërfaqe prej 12. 78, 71 ha[12].

Me qëllim të harmonizimit me legjislacionin në fuqi në vitin 2015, Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerr Vendimin me nr. 55/2015, datë 13.11. 2015 për vënie nën Mbrojtje Paraprake të Zonës së Bifurkacionit të Lumit Nerodime, si zonë potenciale për shpallje, Vlerë e Mbrojtur e Natyrës në kategorinë e Monumentit të Natyrës të Rëndësisë së Veçantë (nr. prot. 5743/15), me sipërfaqe prej rreth 15 hektarëve.

Kuvendi Komunal i Ferizajt ka shfuqizuar vendimin e mbrojtjes të vitit 1979 (Vendimi nr. 633/1,), ndërsa në vitin 2016, IKMN-ja, ka hartuar Arsyeshmërin profesionale, për mbrojtjen e Zonës së Bifurkacionit të Lumit Nerodime në kategorinë Monument i Natyrës i cili ende nuk është aprovuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajt.



Foto 46. Bifurkacioni i lumit Nerodime

Gjendja

IKMN-ja, nga monitorimi i vazhdueshme në terren, konstaton si në vijim :

- Në zonën e Bifurkacionit të Lumit Neodime ka ndërhyrje të shumta si në periferi ashtu edhe në vet fenomenin e bifurkacionit;
- Intervenimi dhe investimet në Bifurkacionin e lumit Nerodime me projektin të ndryshme nuk e ka zgjedhe problemin e funksionalizimit të bifurkacionit etj.

[12] Vendimi nr. 633-1, datë 24 janar 1979, GZK nr. 43/75



Fig. 5. Zona e propozuar për mbrojtur *(Bifurkacionit i lumit Nerodime)*

Rekomandimet

- *MMPH në bashkëpunim me komunën e Ferizajt sa më parë të harmonizojnë qëndrimet për kategorinë e mbrojtjes dhe definohen të kompetencave sipas Ligjit për mbrojtjen e të Natyrës;*
- *MMPH në bashkëpunim me komunën e Ferizajt dhe donatorë të ndryshëm të përgatis projekt për funksionalizimin e bifurkacionit;*
- *Të mirëmbahet rrjedha e lumit Nerodime me qëllim të funksionimit të vazhdueshëm të bifurkacionit (meqenëse në periudhat me zhvillim të hovshëm të vegjetacionit dhe rritjes së kërkesave për ujitje mundë të krijohen pengesa dhe zvogëlim sasisë së ujit përgjatë rrjedhës;*
- *Të gjitha ndërhyrjet në zonë të jenë profesionale dhe sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;*
- *Të monitorohet dhe inspektohen zona në vazhdimësi me qëllim të përcjelljes së gjendjes dhe të ndërpriten urgjentisht të gjitha ndërtimet ilegale në zonën e mbrojtur të Bifurkacionit;*
- *Të përgatitët një plan rregullues për zonën me të cilin do të mundësohej, rregullimi dhe menaxhimi më i mirë i zonës.*

6.6.4. Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën e Radavcit

Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit janë vënë nën mbrojtje në vitin 1983, si monumente natyrore me sipërfaqe prej 89.94 ha. Shpella e Radavcit është shpellë tipike e burimeve. Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe punën kimike të ujërave nëntokësor të Drinit të Bardhë. Deri me tani janë hulumtuar 2100 m kanale nëntokësore, por hulumtimet vazhdojnë akoma. E njohur edhe si "Bukuroshja e fjetur" është hapur për vizitor në vitin 2015. Për vizitor janë të hapura vetëm galeria hyrëse, qendrore dhe ajo e vaskave. Shpella e Radacit është edhe monument i trashëgimisë kulturor - Lokalitet Arkeologjik, ku janë gjetur shenja të popullimit të lashtë nga koha e neolitit. Me shpalljen e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ne vitin 2013 pjesa më e madhe e zonës është përfshirë në kuadër të parkut.




Foto 47. Drini i Bardhë dhe Shpella e Radacit

Gjendja

Bazuar në monitorimin e vazhdueshme të gjendjes në terren në Monumentin e Natyrës "Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit", është konstatuar se ka pasur ndërhyrje nga faktori antropogjen. Ndërhyrjet kryesisht janë realizuar në Burimin e Drinit të Bardhë rreth Ujëvarës të cilat konsistojnë me ndërtimin e shtigjeve për vizitor, shkallëve, vendosjen e kioskave, ndërhyrjet në rregullimin e rrjetit për nevojat e hidrocentralit dhe furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm dhe shfrytëzimi i ujit nga ana e hidrocentralit i cili ndikon drejtpërdrejt në uljen drastike të sasisë së ujit në ujëvarë. Me hapjen për vizitor të shpellës (2015) dhe rritjes së numrit të vizitorëve, presioni dhe ndikim në këtë zonë është rritur dukshëm. Komuna e Pejës shpellën e Radevcit e ka dhënë në menaxhim Shoqatës Spelologjike "Aragoniti", por nuk janë të definuara saktë përgjegjësit dhe kompetenca ligjore në menaxhimin e shpellë.

Rekomandimet

- *Të gjitha aktivitetet në brendësi të Shpellës se Radavcit dhe pran Burimit të Drinit të Bardh të realizohen me projekte konkrete dhe me pëlqim nga MMPH-ja;*
- *Të ndalohen të gjitha aktivitetet qe bien ndesh me qëllimin e mbrojtjes;*
- *Të themelohet organi për administrimin e monumentit të natyrës "Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit" ose të administrohet nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna";*
- *Vendimi për shpalljen e "Burimi të Drinit të Bardh dhe Shpella e Radevcit" të harmonizohet me ligjin për mbrojtjen e natyrës;*
- *Të ndërtohet një qendre informuese turistike;*
- *Burimi i Drinit të Bardh dhe Shpella e Radavcit të përfshihen në kuadër të guidave turistike të Kosovës;*
- *Të definohen përgjegjësit në menaxhimin e shpellës së Radavcit në mesë Komunës së Pejës dhe Shoqatës Speleologjike "Aragoniti", sipas ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe ligjeve tjera.*

6.6.5. Muzeu i kristaleve

Miniera e "Trepçës" në Stantërg është e njohur me bukuri mahnitëse të kristaleve e mineraleve të llojeve të ndryshme.

Duke pasur parasysh këtë fakt në vitin 1964 themelohet Muzeu i kristaleve të mineraleve në të cilin janë të vendosura mbi 1300 eksponate të llojeve të ndryshme të kristaleve duke e shndërruar Muzeun në një objekt me rendësi të madhe kombëtare për Kosovën si në aspekt të vlerave po ashtu edhe në aspekt turistik. Përveç kristaleve në Muze janë të ekspozuara edhe mjete të vjetra pune me të cilat janë shërbyer xehetarët ne fillimet e punimeve në minierë.

Në vitin 1970 Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës i vënë në mbrojtje 512 kristale të ekspozuara në muze duke e rritur edhe më shumë rendësin e Muzeut. Që nga themelimi, Muzeu ishte i vendosur në një objekt i cili për shkak të vjetërsisë nuk i plotësonte kushtet për ekspozimin dhe ruajtjen e kristaleve.

Në vitin 2012 me fonde të Qeverisë së Republikës së Kosovë, përkatësisht, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe ndërmarrjes është ndërtuar objekti ri i muzeut të kristaleve. Përveç kristaleve nga miniera "Trepça", në Muze janë të ekspozuara edhe mbi 100 lloje të kristaleve nga vendet të ndryshme të botës si: Gjermania, Italia, Franca, Spanja, Brazili, të cilat Muzeu i ka marrë në këmbim me kristalet nga miniera e Trepçës".



Foto 48 Objekti i Muzeut



Foto 49. Kristalet në Muze

Gjendja

Me ndërtimin e objektit të ri, gjendja e përgjithshme në Muzeun e Kristaleve është përmirësuar dukshëm. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka themeluar organin menaxhues të muzeut që ka ndikuar në përmirësimin e kushteve dhe menaxhimin më efikas të muzeut duke e kthyer në një atraksion turistik.

Rekomandimet

- *Muzeu i Kristaleve të përfshihen në kuadër të guidave turistike të Kosovës;*
- *Të harmonizohet vendimi për mbrojtjen e 512 kristaleve me ligjin e ri të natyrës;*
- *Të merren nën mbrojtje të gjitha kristalet qe gjenden në muze (ato që janë nxjerre në Trepçë;)*

6.6.6. Gryka e Rugovës dhe Shpella "Gryka e Madhe"

Gryka e Rugovës është një ndër zonat me vlera më të veçanta gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, biodiversitet dhe vlera turistike dhe rekreative. Është krijuar me punën e erozionit vertikal fluvial, kryesisht në gëlqeroret e triasikut, para dhe pas periudhës glaciale. Gryka e Rugovës, me 1985 është shpall monument i natyrës me rëndësi hidro-gjeomorfologjik, me sipërfaqe prej 4.302 ha. Pas shpalljes se Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" kjo zonë tani gjendet në kuadër të parku. Përveç vlerave në aspektin e florës dhe faunës (biodiversitetit), Gryka e Rugovës, prezanton bukuri të peizazhit, gjeodiversitetit si dhe karakteristikave hidrologjike.

Gryka e Rugovës është e njohur me burime uji, ujëvara dhe shpella prej të cilave më të njohurat dhe më atraktivet janë dy ujëvarat (të tuneli dhe ajo e kilometrit të gjashtë) dhe shpella Gryka e Madhe.



Foto 50. Gryka e Rugovës

***Shpella Gryka e Madhe**,* ndodhet në kilometrin e 8-të të Grykës së Rugovës, në anën e majtë, rreth 60 m mbi lumin Lumbardhë, në lartësi 637 m. Hulumtimi në këtë shpellë ka filluar në vitin 1993, kur u zbulua. Megjithatë, shpella ishte e njohur nga banorët vendas shumë kohë më parë. Deri me tani nga grupe të ndryshme Speleologësh janë hulumtuar rreth 13 km galeri nëntokësore. Shpella tjera janë edhe shpella e Karamakazit, shpella e Kallabes (ku janë zbuluar mbetjet arkeologjike të njerëzve të lashtë) etj. Gjatë vitit 2015 - 2017 në shpellën e Gryka e Madhe kane vazhduar hulumtimet për zbulimin e korridoreve dhe galerive te reja si dhe është punuar profili i shpellës. Me shpalljen e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" në vitin 2013, monumenti i natyrës "Gryka e Rugovës" është përfshirë në kuadër të parkut.



Foto 51. Hulumtimi i korridoreve dhe i galerive të reja në shpellën "Gryka e Madhe"

Gjendja

Gjatë monitorimit të vazhdueshme të gjendjes në terren në Monumentin e Natyrës "Gryka e Rugovës", është konstatuar se në këtë monument ka pasur disa ndërhyrje nga faktori antropogjen sidomos në pjesën e mesme (afër tunelit) dhe të epërme të saj me ndërtimin e disa lokaleve afariste, gjithashtu në hyrje të grykës është ndërtuar edhe Via Ferrata. Po ashtu përgjatë Grykës së Rugovës gjendet një numër i madh i ndërtimeve ilegale.

Rekomandimet

- *Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MN "Gryka e Rugovës", të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligjin e PK Bjeshkët e Nemuna;*
- *Të monitorohet nga drejtoria e PK. Bjeshkët e Nemuna";*
- *Të ndërpritet ndërtimi i objekteve ilegale;*
- *Të vazhdohet hulumtimi i korridoreve dhe i galerive në shpellën Gryka e Madhe;*
- *Të bëhet largimi i mbeturinave etj.*

6.6.7. Ndërhyrjet në Monumentet e Natyrës

Gjatë periudhës 2015-2017, nën ndikimi e kushteve atmosferike dhe faktori antropogjen, dëmtime të konsiderueshme, kanë pësuar disa monumente të natyrës (*tebela 5*)

Dëmtime të konsiderueshme ka pësuar Monumenti i Natyrës Shpella e Temeqinës në Komunën e Malishevës. Deri të dëmtimi i këtij monumenti ka ardhur si pasoj e shfrytëzimit të pakontrolluar të gurëve në zonën e shpellës nga banorët vendas. Brengosës është fakti se Komuna e Malishevës nuk ka ndërmarr asnjë hapë në pengimin e shkatërrimit të kësaj shpelle.

Komunave përkatëse u janë propozuar masat për shfuqizimin e vendimeve me të cilin këto monumente largohen nga lista e zonave të mbrojtura.




Foto 52. Trungu i Qarrit (Quercus cerris L) në Drenovc




Foto 53. Shkatërrimi i hapësirës mbi Shpellën e Temeqines *Foto 54. Dëmtimi i Trungut të Plepit në Gërdoc*

Bazuar në Ligjin për Mbrojtën e Natyrës, komunat janë të obliguara:

- çdo dy (2) vjet t`i dërgojnë raport Ministrisë për gjendjen e mbrojtjes së natyrës si dhe në çdo kohë tjetër nëse atë e kërkon Ministria (neni 149, pika 4),
- sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente (neni 143 pika 2.3),
- përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në periudhen 2015-2017 ka realizuar vizita monitoruese në monumentet e natyrës, konkretisht lokacionet ku janë vendosur shenja informuese me qëllim të verifikimit të gjendjes së tyre. Në disa vende janë vërejtur dëmtime e tabelave informuese.



Foto 55. Dëmtimi i tabela informuese

Tabela 5. Zonat e mbrojtura qe i kanë humbur vlerat nayrore

Monumenti i natyrës	Vendndodhja	Komuna	Viti i mbrojtjes
Trungu i blirit të kuqë (Tilia sp)	Istog të Poshtëm	Istog	2009
Trungu i blirit të argjend (Tilia sp)	Kaliqan	Istog	2009
Trungu i rrënjës (Quercus robur	Gurrakocë	Istog	2009
Trungu i Qarrit (Quercus cerris L)	Caravranë	Malishevë	2014
Trungu i Qarrit (Quercus cerris L)	Drenovc	Malishevë	2014
Shpella e Temeqinës	Temeqinë	Malishevë	2014
Plepi i Bajqinës	Bajqinë	Podujevë	1959
Trungu i plepit	Gërdoc	Podujevë	2015

Burimi: IKMN

Rekomandimet

- *Kërkohet nga komunat përkatëse në të cilën ndodhen monumentet e natyrës të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm dhe të raportojnë për gjendjen e tyre në MMPH/IKMN;*
- *Të merren masa fitosanitare për mbrojtjen e biomonumenteve që kanë statusin e zonës së mbrojtur.*

6.7. PEIZAZHET E MBROJTURA

6.7.1. Peizazhi i mbrojtur "Gërmia"

Masivi malor i Gërmisë paraqet një pasuri natyrore shumë të rëndësishme jo vetëm për Prishtinën, rrethinën por edhe tërë Kosovën. Shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës (Prishtinës) dhe përfshinë një sipërfaqe prej 62 km^2.

Ne vitin 1987 Kuvendi Komunal i Prishtinës ka shpallur një sipërfaqe prej 1.126 hektarësh ne kategorinë e Parkut Regjional dhe sipas IUCN (Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) Gërmia bën pjesë në kategorinë e V-të, të mbrojtjes si Peizazh i Mbrojtur.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233 të GZRK Nr. 85/9 nëntor 2010 kategoria e Parkut Regjional Natyror nuk ekziston më në ligj, andaj është paraparë që Parku Regjional Natyror "Gërmia" të ri-kategorizohet në kategori të re sipas ligjit në fuqi.

Kuvendi Komunal i Prishtinës në vitin 2016 merr vendim për shpalljen e Gërmis Peizazh i Mbrojtur, me sipërfaqe prej 1949 ha.

Gërmia është një masiv malor i pasur me lloje bimore e shtazore, dhe në përgjithësi i ka ruajtur vlerat e veta natyrore, Mirëpo në vitet e fundit nga faktori njeri, disa lloje bimore e shtazore janë zhdukur përgjithmonë, disa janë para zhdukjes, ndërsa sipërfaqe të dukshme pyjore janë degraduar ose janë në rrezik permanent të degradimit[13].

[13] Raporti për stutimin e vlerave të Gërmisë, Universiteti i Prishtinës, 2014

Flora dhe Vegjetacioni

Në saje të pozitës fiziko-gjeografike, veçorive gjeologjike, pedologjike, kushteve klimatike etj. masivi malor i Gërmisë është mjaft i pasur si në pikëpamje floristike ashtu dhe vegjetative. Nga hulumtimet e deritashëm, në masivin e Gërmisë janë të evidencuara: 610 lloje të florës vaskulare të grumbulluara në 82 familje duke mos numëruar taksonet ruderale, 88 lloje të kërpudhave, 14 lloje të myshqeve, 51 lloje të likeneve. Në sipërfaqe të caktuar janë të pranishme pyjet me lloje halore (të kultivuara) të pishës së zezë, të pishës së bardhë si dhe 1 ha me akacie.



Foto 56. Bashkësia pyjore e ahut (*Fagetum moesiacum montanum)*

Llojet e bimëve të rralla dhe që janë në rrezik të zhdukjes

Në bazë të hulumtimeve është vërtetuar se në rrezik të zhdukjes janë 23 lloje bimore si: Vingjra lulemadhe (*Lathyrus grandiflorus*), Vingjra pyjore (*Lathyrus sylvestris),* Koeloglosi i blertë (*Coeloglossum iride*), Ptilostemi i pirpiktë (*Ptilostemen strictus*), Qarrziu (*Quercus trojana*), Qumështorja gjethengushtë (*Euphorbia exigua*), Pedikularia tufore (*Pedicularis comosa*), Haraqina mjekësore (*Valeriana officinalis*), Lajthia e egër (*Corylus colurna*), Zhabinorja iliriane (*Ranunculus illyricus*), Liri (*Linum gallicum*), Haplofili *(Haplophyllum suaveolus*) etj.

Në Gërmi si lloje mjaft të rrezikuara dallohen vingjra pyjore (*Lathyrus sylvestris*), koeloglosi i blertë (*Coeloglossum iride*), vetëm në një lokalitet, ndërsa vingjra lulemadhe (*Lathyrus grandiflorus)* gjendet në një lokalitet me vetë disa individ, ndërsa në një lokalitet veç është zhdukur. Lloj shumë i rrezikuar është dhe Haraqina mjekësore (*Valeriana officinalis*) që në Gërmi është konstatua vetëm në një lokalitet me disa individ në bashkësinë e ahut afër përroit nën kodrën e Butovcit.



Foto 57.Vingjra lulemadhe (*Lathyrus grandiflorus)*



Foto 58. Koeloglosi i blertë *(Coeloglossum viride)*



Foto 59. Ptilostemon

Fauna

Fauna e Kosovës në tërësi dhe ajo e Gërmisë në veçanti është pak e studiuar. Biotopet e ndryshme të Gërmisë si dhe lartësitë e ndryshme u ofrojnë kushte të mira për jetesë llojeve të ndryshme shtazore. Fauna e Gërmise e cila i përket faunës se Evropës së Mesme, sipas hulumtimeve të kryera deri më sot përbëhet nga: 5 lloje ujëtokësorësh, 7 lloje rrëshqitësish, 32 lloje shpendësh, 19 lloje gjitarësh.
Gjithashtu në këtë masiv malor janë hulumtuar një numër i madh i insekteve nga rendet Orthoptera, Homoptera, Coleoptera, Diptera, Himenoptera dhe Lepidoptera që paraqesin grupin më të madh të organizmave.



Foto 60. Kokëzogëza *(Anguis fragilis)*



Foto 61. Bilbili *(Luscinia megarhynchos*)

Gjendja

Duhet theksuar se gjendja e sotme e florës, faunës dhe ekosistemeve në masivin e Gërmisë është rezultat i veprimit të tre faktorëve të rëndësishëm: zhvillimi i saj në të kaluarën, ndikimi i tashëm i kushteve ekologjike dhe ndryshimeve të mëdha nga veprimi i faktorit njeri.

Është shqetësues fakti se sot në bashkësitë pyjore të Gërmisë veçmas në ato të dushkut kemi dukurinë e tharjes së shumë drunjtëve nga veprimi i insekteve të caktuara si dëmtues të njohur të pyjeve. Prandaj shtrohet nevoja urgjente për një pastrim sanitar dhe dezinsektimi të këtij masivi malor, veçmas zonës së mbrojtur

Po ashtu, pa respektim të mendimin paraprak të IKMN-së ka pasur ndërhyrje me qëllim të ndërtime të objekteve private, projekte për zgjerimin e rrugëve si dhe aktivitete tjera në prerje dhe dëmtim të masës drusore. Gjuetia e paligjshme është prezentë gjatë gjithë vitit duke mos respektuar faktin se në këtë zonë është rreptësisht e ndaluar.

Edhe pse Gërmia tani gëzon status të Peizazhit të Mbrojtur (ndryshim i kategorisë nga Park Regjional) ajo ende nuk ka një Plan Menaxhues dhe Rregullues, mungojnë shenjëzimet e nevojshme përreth dhe brenda parkut etj

Gjatë viti 2016-2017 Komuna e Prishtinës ka fituar një projekt nga WWF Adria i cili synon, përveç tjerash hulumtimet e nevojshme të vlerave të biodiversitetit, hartimin e një Plani Rregullues, etj.

Rekomandimet

- *Hartimi i planit menaxhues dhe rregullativ për peisazhim e mbrojtur "Germia";*
- *Aplikimi i masave sanitare për sanimin e pyjeve të dëmtuara nga faktorët biotik dhe abiotik;*
- *Vazhdimi i hulumtimeve me qellim te inventarizimit të llojeve dhe habitateve;*
- *Inspektimi i vazhdueshëm nga Inspektorati i MMPH -së dhe komuna;*
- *Të menaxhohet i gjithë territori i Peizazhit të Mbrojtur;*
- *Të ndalohen ndërtimet ilegale në peisazhin e mbrojtur "Germia";*
- *Të bëhet shenjëzimi i zonës së mbrojtur;*
- *Të vendosen tabela informuese etj.*

6.7.2. Peizazhi i Mbrojtur “Shkugza”

Shkugza gjendet në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës i shtrirë mes dy kodrave të ndara nga lumi i vogël Shlepica, në lartësi mbidetare prej 410-460 m. Kjo zonë është e pasur me vlera të biodiversitetit, turistike, rekrative dhe edukativo - arsimore. Me propozimin e MMPH-së, në vitin 2011, komuna e Gjakovës ka shpallur të mbrojtur Shkukzën “ Peizazhit të Mbrojtur” me sipërfaqe prej 70 hektar.



Foto 62. Peizazhi i mbrojtur “Shkugza”

Flora dhe vegjetacioni

Në vitin 1960, Shkugza ishte pyllëzuar me Pishë të Zezë (*Pinus nigra*). Një vlerësim i përafërt fillestar i shumëllojshmërisë bimore rezulton në rreth 280 lloje. Prej tyre mund të hasen: *Festuca ovina agg*. (*bishtpelëza e deleve*), *Agrostis capillaris*, *Poa pratensis, Bromus sterilis (bartheku), Achillea millefolium (bari mijëfletësh), Trifolium sp. (tërfili), Euphorbia cyparisias (qumështorja), Plantago lanceolata (gjethe heshtorja), Teucrium chamaedrys, Thymus spec. (lisra), Stachys spec (sarusha), Hieracium pilosella (kamashna), Hypochoeris radicata* dhe të tjera. Bimët kacavjerrëse si *Humulus lupulus (sumbullaria) dhe Clematis vitalja (kulpra e egër)* e bëjnë të vështirë qasjen në pyll.

Drunjtë dominues, në varësi të vendeve të veçanta, janë *Pinus nigra* (pisha e zezë), *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë), *Acer campestre* (panja), *Ulmus spekulim*., *Fraxinus ornus* (frashëri), *Coryllus avellana* (lajthia), *Crataegus monogyna* (murrizi njëbërthamësh), *Cornus mas* (thana) dhe lisi (quercus cerris (qarri), *Quercus pubescens* (bungëbuti) dhe *Quercus frainetto* (shpardhi). Pishat e Zeza nuk janë pjesë e vegjetacionit fillestarë dhe ato nuk riprodhohen në mënyrë të natyrshme në këtë zone.

Fauna

Pylli korije (zabeli) shquhet me vegjetacionin më të larmishëm në "Parkun e Shkugzës" dhe është një habitat i rëndësishëm për lloje të ndryshme të fluturave (Lepidoptera), brumbullin e rrezikuar *Lucanus cervus* (kaçadremi), hardhucën e mureve (*Lacerta muralis*), breshkën (*Testudo hermanni*) etj. Biodiversiteti i shtratit të lumit Shlepica është i kufizuar për shkak të ndotjes. Janë regjistruar llojet si tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkoca barkverdhë (*Bombina variegata*), *Rana esculenta* agg., gjarpri i ujërave (*Natrix natrix*) etj. Në sasi të mëdha gjendet specia ujore *Micropterna lateralis* (nga rendi Trichoptera), e rrezikuar në disa vende evropiane dhe e regjistruar për herë të parë në Kosovë si dhe popullatat e pilivesave. Nga llojet e zogjve më të pranishmet janë *Picus viridis* (qukapiku i gjelbër), *Lyscinia meganchynchos* (bilbili) dhe disa lloje tjera.



Foto 63. Micropterna lateralis



Foto 64. Triturus vulgaris

Gjendja

Problem në zonën e peizazhit të mbrojtur "Shkukëza" mbeten ndërtimet e restoranteve pa pasur një miratim paraprak nga organet kompetente si dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse si: kënde lojërash dhe vend parkime të cilat janë të vendosura edhe në mes të drunjve të pishës së zezë.

Problem tjetër është edhe menaxhimi me mbeturina si dhe rreziku nga zjarret të cilat janë evidente në disa pjesë të Parkut. Mbeturinat e hedhura shpeshherë digjen dhe në të njëjtën kohë paraqesin rrezik permanent për përhapjen e zjarrit edhe në pjesët tjera të pyllit.

Prerjet ilegale, shkarkimi i ujërave të zeza, aktivitete të pakontrolluara pikniku, menaxhimi i pamjaftueshëm i mbeturinave (pronarët e restoranteve, publiku i cili viziton zonën, banorët lokal të fermave në rrethinë) janë disa nga problemet tjera shqetësuese për zonën që pritet të zgjidhen në të ardhmen me aprovimin e Planit Rregullues për këtë zone.

Rekomandimet

- *Të përgatitet Planit Rregullues për zone me qellim të shmangies së ndërtimeve ilegale;*
- *Të bëhet menaxhimi me i mirë i mbeturina (të ndalohet rreptësisht djegia e tyre;);*
- *Të ndërpriten prerjet ilegale të pyjeve dhe të bëhet pastrimi sanitar i zonës;*
- *Pasi që zona është shndërruar në qendër rekreative nga banoret, zona të pajiset me infrastrukturë përkatëse;*
- *Të bëhet shenjëzimi i peizazhit të mbrojtur;*
- *Të gjitha aktivitetet në zonën e mbrojtur të kenë karakter edukativo arsimore, turistikë dhe rekreative.*

7. ZONAT E PROPOZUARA PËR MBROJTE

Në periudhën 2015-2017 IKMN, ka përgatitur aryeshmërinë profesionale dhe janë marr nën mbrojtje vlerat e natyrës, si në vijim: 18 Rezervate Strikte, 12 monumentet të natyrës në Kaçanik, 10 në Shtime, 7 në Podujevë, 7 në Vushtrri, 10 në Rahovec, 12 në Ferizaj dhe Parku i Natyrës "Mali i Pashtrikut dhe Liqeni i Vërmicë".

Gjatë vitit 2017 më iniciativën e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, janë përgatitur arsyeshmëritë profesionale për marrjen nën mbrojtje ligjore edhe të 10 objekteve /zonave të reja të natyrës, prej tyre: 9 monumentet dhe 1 Peizazhe të Mbrojtura në komunën e Gjakovës.

Tabela 6. Objektet e trashëgimisë natyrore në Komunën e Gjakovës

Emërtimi		Vendi/ lokacioni	Kategoria e propozuar për mbrojtje
1	Trungu i dushkut *(Quercus petraea)*	Bec	Kategoria III (Monument i natyrës më karakter botanik)
2	Trungu i dushkut *(Quercus pubescens)*	Herec	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter botanik)
3	Kompleksi i trungjeve	Shqiponjë (Jabllanicë)	Kategoria VI (Peizazh i mbrojtur me karakter botanik)
4	Kompleksi i trungjeve	Zhabel	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter botanik)
5	Trungu i dushkut *(Quercus pubescens)*	Rrypaj	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter botanik)
6	Kompleksi i trungjeve	Molliq	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter botanik)
7	Burimi i ujit	Molliq	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter hidrologjik)
8	Kompleksi i shpellave	Kusar	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter speleologjik)
9	Burimi i ujit	Kusar	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter hidrologjik)
10	Trungu i qarrit *(Quercus cerris)*	Vogovë	Kategoria III (Monument i natyrës me karakter botanik)

Burimi: IKMN

8. ZONAT TJERA TË MBROJTURA

8.1. Zonat Natyra 2000

Për inkurajimin e menaxhimit më të mirë të trashëgimisë natyrore të Evropës, nevojitet që të bëhet implementimi i politikave të konservimit të natyrës në territorin e caktuar. Evropa ka bërë përshtatjen e dizajnit të legjislacionit, për të mbrojtur habitatet dhe llojet më të rrezikuara dhe ky legjislacion quhet Direktiva e Zogjve 2009/147/EC, 30 Nëntor 2009, për Zogjtë e Egër (version i kodifikuar i Direktivës 79/406/EEC), dhe Direktivën e Habitateve 92/43/EEC, 21 Maj 1992 për Ruajtjen e Vendbanimet Natyrore të Florës dhe Faunës së Egër. Si bazë e këtyre Direktivave është rrjeta e Zonave të Mbrojtura e quajtur NATYRA 2000. Aspekti shumë i rëndësishëm i saj është që të jetë në linjë të plotë me objektivat e Konventës së Llojllojshmërinë Biologjike dhe Konventës së Bernit.



Fig 6. Natyra 2000 bazë e Direktivës së Zogjëve dhe Direktivës së Habitateve

Përgatitja e Kosovës për përzgjedhjen e zonave NATYRA 2000 me tregues për të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe mjetet e nevojshme, paraqet një bazë të mirë në përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Kosovës drejtë Integrimit në Bashkimin Evropian. Qëllimi i përgjithshëm është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor duke sjellë Kosovën më pranë standardeve Evropiane për mjedisin. Kjo arrihet përmes forcimit të strukturave administrative dhe përafrimit me kërkesat mjedisor të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivat.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në Mars të vitit 2016 deklaron se transpozimi i Direktivave të Bashkimit Evropian për fushën e mbrojtjes së natyrës në

legjislacionin kombëtar pothuajse është arritur dhe dispozitat tjera do të transpozohen gradualisht. Dokumenti gjithashtu përfshin disa aktivitete përgatitore për krijimin e rrjetit të Natyra 2000 të cilat janë prioritete afatshkurtra dhe afatmesme, si ajo për përcaktimin e kufijve të qartë në mes të regjioneve Bio-gjeografike, krijimi i hartave të terrenit, inventarizimi i llojeve, etj. Në vitin 2008, është hartuar raporti preliminar për zonat e "Natyrës 2000", në kuadër të "Projektit të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve". Përzgjedhja e këtyre zonave është bërë duke u bazuar në kriteret shkencore si madhësia dhe dendësia e popullatës së llojeve, si dhe sipërfaqja e habitatit në të cilin ato gjenden.

Andaj në këtë drejtim do të punohet deri në realizmin e përgjithshëm të synimeve dhe objektivave që lidhen me këtë çështje.

Më qellim të fillimit të implementimit të rrjetit ekologjik "Natyra 2000" në Kosovë, MMPH-ja, në vitin 2016 ka themeluar grupit koordinues ndër-institucional për koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve qe lidhen me "Natyra 2000".

Rekomandimet

- *Inventarizimi i florës dhe faunës;*
- *Identifikimi i të gjitha zonave të rëndësishme për Natyra 2000;*
- *Krijimi i hartave me të dhënat për habitatet e florës dhe faunës;*
- *Sigurimi i fondeve për realizimin e Natyra 2000.*

8.2. Vendgjuetitë me rëndësi të veçantë

Aktivitetet e Agjencisë Pyjore të Kosovës, përkatësisht Drejtoratit për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko-Turizëm në VGJRV zhvillohen duke u bazuar në Strategjinë e menaxhimit të kafshëve të egra dhe gjuetisë në Kosovë (2012-2022). Ky dokument është një bazament për ruajtjen e tërësisë se ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtjen adekuate të kafshëve të egra, sigurimin e mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të tyre.

Edhe gjatë periudhës 2015-5017 fokusimi në menaxhimin e qëndrueshëm të kafshëve të egra dhe gjuetisë ka qenë në VGJRV Blinaja dhe Duboçaku me theks të veçantë në:

- Ruajtjen e habitatit,
- Arritjen e numrit optimal për të gjitha kafshët e gjuetisë,
- Mbajtjen e strukturës optimale të popullacionit sipas gjinisë dhe moshës,
- Gjendjen e mirë shëndetësore e kafshëve për gjueti,
- Mbrojtjen dhe ruajtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara,
- Arritjen e objektivave të planifikuar në menaxhimin e vend-gjuetisë në harmoni me programin e menaxhimit dhe planin afatgjatë dhjetë vjeçar.

8.2.1. Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë "BLINAJA"

Shtrihet në tri Komuna, atë të Lipjanit, Drenasit dhe Shtimes dhe ka një sipërfaqe prej 2795/ha. Kjo Vend gjueti e tipit te mbyllur ka 40/ha livadhe, 32 liqe artificial, 88 ulëse te larta (vëzhgimore), 12 kurthe për nxënien e derrave kurse zona ushqyese për kafshë të mëdha posedon 150 depo ushqimi, 26 tarraca nga betoni për derra, 2 për riprodhim, 32 zona për ujë, 15 për kripë, 1 zonë trajnimi për qenët e gjuetisë etj. Në total janë 2100/ha pyje shtetërore si dhe 600/ha pyje në pronësi private. Pjesa tjetër prej 95/ha i takon sipërfaqes bujqësore(livadhe) dhe diku 5/ha sipërfaqe ujore.
Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe funksionalitet në këto tri vitet e fundit janë bërë investime të konsiderueshme për renovimin dhe rivitalizimin e infrastrukturës si: renovimin e rrugëve pyjore, renovimin e rrethojës së jashtme, renovimin e Objektit të Gjuetisë dhe atij për trajnime, sigurimin e ushqimit për kafshët e egra gjatë sezonit dimëror, ngritjen e koritave për ushqim dhe kriporeve etj.
Gjendja e këtij habitatit është e mirë falë angazhimit dhe përkushtimit në vazhdimësi të stafit me qëllim mbrojtjen, kultivimin dhe kujdesin për ushqim për kafshët e egra.
Llojet kryesore të faunës së egër në Blinajë janë: Derri i egër (Sus scrofa) - aktualisht llogaritet se janë rreth 500 krerë, Dreri i kuq (Cervus elaphus) - rreth 150 krerë, Dreri i murrmë (Dama dama) - rreth 100 krerë, Kaprolli (Capreolus capreolus) - rreth 170 krerë.
Përveç këtyre llojeve në Blinajë janë prezentë edhe Vjedulla (Meles meles), Shqarthi i ahut (Martes sp.), Shqarthi i pishës evropiane (Martes sp.), Lepuri (Lepus europeus), Korbi (Corvus corax), Laraska (Pica pica), Shqiponja minj ngrënëse (Buteo buteo), Rosa e egër (Anas querquerdula), Macja e egër (Felis sylvestris), Ketri (Sciurus vulgaris), etj. Sipas Planit Menaxhues me Pyje 2014-2023, në VGJRV në Blinajë volumi i masës drusore aktuale është 332325 m3, me një rritje vjetore prej 2.93% përkatësisht 9737 m3/vit.
VGJRV në Blinajë është nën menaxhim të APK-së dhe nuk ka veprime ilegale përkundër tentimeve të herë pas hershme për gjueti ilegale të cilat parandalohen me kohë nga Stafi për mbrojtje të Pyjeve dhe gjahut i mbështetur shpesh herë edhe nga Policia e Kosovës.



Foto 65 Fauna në vendgjuetin "Blinaja" *(APK)*

8.2.2. Vend Gjuetia me Rëndësi të Veçantë "Duboçaku"

Sipërfaqja e kësaj Vend Gjuetie shtrihet në tri Komuna, atë të Skenderajt, Zubin Potokut dhe Mitrovicës me një sipërfaqe prej 6805.05 ha, ku prej tyre 2470 ha janë pronë shtetërore kurse pjesa tjetër pronë private. Kjo vend gjueti është e tipit të hapur. Sipas Planit Menaxhues me Pyje Duboçak 2011-2021, ka një vëllim të masës drusore prej 46954.40 m^3, me një rritje vjetore 2.2% përkatësisht në sasi prej 1693.00 m^3. Shtrihet në lartë si mbidetare prej 320 deri në 1050 mld. Kushtet hidrologjike janë të volitshme pasi që është e pasur me shumë përrenj dhe burime uji të cilët janë të përhapur në tërë sipërfaqen e vend gjuetisë dhe nuk shterojnë gjatë tërë vitit, që d.m.th se problemi i ujit për nevoja të faunës së egër nuk ekziston.

Nuk është bërë ndonjë inventarizim i numrit kafshëve të egra prezentë por bazuar në incizimet që janë bërë me kamera fiks dhe gjurmëve të tyre dihet se ekzistojnë lloje të ndryshme të tyre si Ariu i murrmë (*Ursus aretos*), Ujku (*Canis lupus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dreri i kuq (*Cervus elaphus*), Lepuri (*Lepus europeus*), Ketri (*Sciurus vulgaris*) etj.

Gjatë këtyre dy viteve janë bërë investime infrastrukturore si në: renovimin e objektit dhe zyrave, sigurimin e ushqimit shtesë gjatë sezonit dimëror (misër kokërr dhe kripë guri), ngritjen e koritave për ushqim shtesë dhe kriporeve, etj.

Në këtë Vend gjueti janë prezentë tentimet e veprimeve ilegale të prerjes së pyjeve dhe gjahut ilegal me një trend në rënie dy vitet e fundit falë angazhimit të stafit të VGJRV në Duboçak, kurse problem në vete paraqet edhe qasja e kufizuar në sipërfaqet që shtrihen në Komunën e Zubin Potokut.

Në këtë Vend gjueti vështirësi paraqesin edhe kushtet e pa favorshme infrastrukturore pasi që objekti aktualisht është pa energji elektrike dhe nuk posedon rrjetin e furnizimit si dhe rrugët që shpijnë deri tek objekti po thuajse aktualisht janë të pa kalueshme.

Rekomandimet

- *Parandalimi i veprimeve ilegale në prerjen e pyjeve dhe gjuetinë në VGJRV në Duboçak;*
- *Nxjerrja e një Rregulloreje për menaxhimin dhe tarifat e shërbimeve në VGJRV në Blinajë dhe Duboça;*
- *Vazhdimësi në riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve pyjore;*
- *Ndërtimi i objekteve ndihmëse për deponimin e ushqimit shtesë për kafshë të egra;*
- *Ndërtimi i një objekti për trajtimin sanitar të kafshëve të egra pas sëmundjeve eventuale të paraqitura;*
- *Pajisja me makineri adekuate për mirëmbajtjen e rrugëve pyjore, hapjen e kanaleve kulluese të ujit dhe rrjedhjes së ujit tepricë nga liqenet;*
- *Ndërtimi i ri i rrethojës së jashtme të VGJRV-së në Blinajë meqë e vjetra ka pësuar dëmtime serioze gjatë luftës së fundit dhe është amortizuar në shkallë të lartë;*
- *Zhvillimi i eko-turizmit në një shkallë më të avancuar duke u pajisur me mjete për rekreacion malor (biçikleta për terrene malore, pajisje për kalërim të kuajve, karrocë për kuaj, sajë për tërheqje nga kuajt në sezonin dimëror etj.) në VGJRV në Blinajë;*
- *Vazhdimi i hulumtimit të vlerave të biodiversitetit.*

8.2.3. PYLLI I ARINJËVE – Prishtina

Fondacioni për mirëqenien e kafshëve FOUR PAWS International është organizatë ndërkombëtare e angazhuar në luftën për sigurim të një çasje më humane të njeriut në raport me kafshët në përgjithësi (shtëpiake dhe të egra). Që nga viti 2012 kjo organizatë ka themeluar PYLLIN E ARINJVE Prishtina në partneritet me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe me Komunën e Prishtinës. Në PYLLIN E ARINJVE Prishtina tani jetojnë 19 arinj të shpëtuar në periudha të ndryshme nga jeta e tyre në kafaze pranë restoranteve të ndryshme në Kosovë (16) dhe në Shqipëri (3).

Gjatë periudhës 2015 - 2017, veprimet kryesore të cilat organizata VIER PFOTEN i ka ndërmarrë për të zbatuar programet e saj janë:

- ***Kujdesi për arinjtë të cilët janë të strehuar në Pyllin e arinjve Prishtina***

Gjatë gjithë periudhës 2015 – 2017, Fondacioni VIER PFOTEN është përkujdesur të siguron kushte sa më të mira për arinjtë e strehuar e sidomos aktivitetet siç janë: sigurimi i sasisë së mjaftueshme të ushqimit për arinjtë, kujdesi shëndetësor, trajnimi i stafit, siguria e kafshëve etj

- ***Aktivitetet edukative mjedisore (joformale) me fëmijë dhe të rinjtë***

Gjatë gjithë kësaj periudhe Organizata ka vazhduar zbatimin e programit edukues-vetdijësues për fëmijë, të rinjë dhe të rritur duke përfshinë aktivitete siç janë bashkëpunimi me kopshte dhe shkolla fillore, shfrytëzimi i metodave të ndryshme siç janë përgatitja e filmave të shkurt për problematika të veçanta, përgatitja dhe shpërndarja e doracakëve për rëndësinë e mbrojtjes së kafshëve nëpër shkolla, vizite në teren nga fëmijët dhe arsimtarët etj.

- ***Organizimi dhe promovimi i punës vullnetare përmes aksioneve vetdijësuese***

Fondacioni VIER PFOTEN Kosova që nga vitit 2015 është akreditуar nga Programi ERASMUS + për të pritur dhe organizuar punën me vullnetar përmes organizimit të kampeve verore për punë vullnetare ku pjesëmarrësit zhvillojnë aktivitete të ndryshme siç janë rregullimi i shtigjeve për vizitor, aksionet e pastrimit, debate edukuese mjedisore, aktivitete sportive dhe kulturore etj.

Fondacioni VIER PFOTEN Kosova ka krijuar një grup të vullnetarëve vendor (afër 30), të cilët përkrahin Fondacionin në të gjitha aktivitetet siç janë; aksionet e pastrimit të mbeturinave, kampanjat vetdijësuese, organizimi i eventeve etj.

- ***Investimet e reja***

Në periudhën 2015 - 2017, Fondacioni VIER PFOTEN Kosova, me përkrahjen financiare të Fondacioni FOUR PAWS International nga Austria ka vazhduar investime siç janë: zgjerimi i hapësirat e reja për arinj, hapja e Klinikës veterinare, dhomat për ruajtje dhe përgatitje të ushqimit, gropa për deponim të fekaleve të arinjve, hapja e qendrës për edukim mjedisor “Thesaret e natyrës“ etj.

- ***Bashkëpunim me Institucione dhe organizata partnere***

Gjatë periudhës 2015 – 2017 nga Fondacion FOUR PAWS janë investuar afër 1 (një) milion Euro në projekte. Me përfundimin e Qendrës për edukim mjedisor investimet në dy vitet e fundit arrijnë vlerën 1.5 milion Euro. Nga hapja e Pyllit të arinjëve, Prishtina me 2013 dhe deri me tani vlera totale e investimeve nga FOUR PAWS kap vlerën prej 2.5 milion Euro. Vlen të theksohet se gjate periudhë 2015-2017 parkun e kane vizituar 76.500 vizitor nga vendi dhe regjioni.




Foto 66. Përkujdesja për Arinjtë

9. BIODIVERSITETI

Biodiversiteti paraqet larminë biologjike të florës dhe faunës në planetin tonë dhe është një burim i të mirave dhe shërbimeve të ekosistemit që janë të nevojshme për jetën e njeriut. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve dhe i të gjitha llojeve të mikroorganizmave, kërpudhave, bimëve dhe shtazëve, si dhe e tërë llojshmëria e ekosistemeve, në të cilat qeniet e gjalla janë bartësit aktiv të jetës. Diversiteti i llojeve përfshinë tërë numrin e llojeve organike në tokë, kurse diveristeti i ekosistemeve nënkupton llojshmërinë e tërësishme të vendbanimit dhe biocenozës, si dhe të proceseve ekologjike, me të cilat është realizuar funksionimi i ekosistemeve.

9.1. Gjendja e Biodiversitetit

Duke pasur parasysh rendësin që ka biodiveristeti është e qartë se ruajta dhe ndërmarrja e masave parandaluese është detyrë shumë e rëndësishme dhe që ndikon direkt në mbrojtjen e tij. Në disa raste kemi humbje të vlerave të biodiversitetit që ndodh si pasojë e veprimit të faktorit njeri për shkak të pakujdesit, mos interesimit ose mos dijes. Si pasojë e kësaj në vendin tonë janë shkatërruar habitate të ndryshme me ç'rast janë zhdukur edhe llojet bimore dhe shtazore që deri tani janë të panjohura për shkencën.

9.1.2. Flora

Krahasuar me sipërfaqen që ka Kosova në kuadër të Gadishullit Ballkanik, afër 2.3%, fitodiversiteti ynë paraqet rreth 25% të florës së Ballkanit dhe rreth 18% të florës së Evropës. Florën e vendit tonë e përbëjnë algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat, të cilat janë bazë e jetës dhe formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejt në jetën e organizmave shtazor dhe vet njeriun. Edhe pse janë bërë hulumtime të florës nga autor të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar, ende nuk është bërë një inventarizim i tërësishëm dhe nuk dihet numri i saktë i taksoneve bimore. Bazuar në hulumtimet e deritanishme janë inventarizuar rreth 2000 lloje të florës vaskulare, mirëpo sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet se në vendin tonë janë prezent afro 2.800-3.000 lloje të florës vaskulare[14]. Llojllojshmëria e tyre karakterizohet me prezencën e llojeve të rralla, endemike dhe stenoendemike, të cilat radhiten në dy grupe: endemik lokal apo stenoendemik dhe endemik të Ballkanit.

[14] Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikes të Kosovës - Prishtinë, 2013

Përveç grupit të bimëve endemike të Ballkanit, një grup tjetër i rëndësishëm i bimëve janë edhe bimët relikte. Prej numrit të përgjithshëm afro 2000 lloje të bimëve vaskulare të evidentuara, në Malet e Sharrit, 86 lloje janë shpallur të rëndësishme në aspektin ndërkombëtar, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës, ndërsa sipas kritereve të IUCN-së, 32 lloje janë në Listën e Kuqe të Bimëve të Kërcënuara.



Fig. 7. Llojet bimore me status ndërkombëtar në PK "Sharr"

Në Bjeshkët e Nemuna janë evidentuar 797 lloje të bimëve vaskulare, ku 128 prej tyre konsiderohen me karakter endemik *(Millaku, F. 1999).* Flora e Kosovës është e përfaqësuar edhe me lloje që kanë areal të ngushtë e që konsiderohen si lloje bimore të rralla e të rrezikuara. Këto pasoja negative janë si rezultat i përdorimi ilegal dhe keqpërdorimit të llojeve bimore që njëkohësisht ndikon në reduktimin e tyre.





Foto 67. Keqpërdorimi i bimëve mjekësore

Ruajtja e diversitetit floristik dhe ndërmarrja e masave parandaluese është detyrë shumë e rëndësishme që ndikon direkt në mbrojtjen globale të mjedisit.

Fig 8. Rezikshmëria e llojeve bimore



Burimi: Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës

9.1.3. Vegjetacioni

Vegjetacioni i vendit tonë klasifikohet në: 139 asociacione apo firocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa, të cilat paraqesin ekosisteme karakteristike, të cilat janë gjithashtu habitate për shumë lloje shtazore. Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në: 4 asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Ndërsa vegjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në: 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa. Pyjet më të zhvilluara gjendet në kuadër të Parqeve Kombëtare: "Sharr", "Bjeshkët e Nemuna" dhe vegjetacioni i tyre përbëhet nga tre breza vegjetativ: brezi i ulët, i mesëm dhe i lartë malor.

Këto bashkësi pyjore paraqesin ekosisteme shumë të rëndësishme, që si të tilla duhet të ruhen sepse me ruajtjen e këtyre resurseve krijohen kushte për ruajtjen edhe të llojeve bimore dhe shtazore. Mirëpo në disa raste janë shkaktuar ndërhyrje në vegjetacionin pyjor, si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në mjedis, si për shembull ndërtimi i rrugëve, prerja ilegale, djegia, aktiviteti i gurthyesve etj. Prandaj, këto dukuri kanë shkaktuar ndikime negative në vlerat natyrore dhe të ekosistemeve në përgjithësi.



Foto 68. Dëmtimet e vegjetacionit pyjor në kuadër të zonave të mbrojtura

9.1.4. Gjendja e faunës

Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një llojshmëri të madhe edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar.

Gjendja e faunës në përgjithësi është e mirë edhe atë si rezultate i zgjerimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, kryesisht në të dy Parqet Kombëtare që përbëjnë rreth 10% të tërë sipërfaqes së zonave të mbrojtura të natyrës. Llogaritet se në Kosovë jetojnë mbi 250 lloje të kurrizorëve, ku prej tyre vetëm shpend janë mbi 220 lloje, rreth 20 lloje reptilësh, mbi 10 lloje të amfibeve, gjithashtu mbi 30 lloje të peshqve, 176 lloje të fluturave dhe numër ende i papërcaktuar i faunës së insekteve dhe makroinvertebrorëve të ujërave. Numri i saktë i llojeve të faunës do të përcaktohet me rastin e inventarizimit të sajë që planifikohet të zbatohet gjatë projektit të hartimit të Librit të Kuq për faunën (projekt i filluar në vitin 2017 e do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2018), e po ashtu edhe në kuadër të projekteve tjera.

Presioni më i madh që i bëhet faunës në Kosovë ndodhë kryesisht nga gjuetia ilegale që paraqitet kohë pas kohe edhe brenda hapësirave të zonave të mbrojtura.

Nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë dhe dhitë e egra, ndërsa zhvillim të mirë kanë ariu i murrmë, dhelpra, ujku etj. Të rrezikuara gjithashtu janë edhe llojet e shpendëve grabitqar e posaçërisht simboli kombëtar - shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*). Për shkak të shqetësimit nga njeriu dhe mungesës së një organi menaxhues, sidomos gjatë periudhës së folenizimit, shume lloje shpendësh që dikur ishin prezentë sidomos në Ligatinës e Hencit tani më shihen shumë rrallë.



Foto 69. Shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos)



Foto 70. Hardhuca e mureve (Podarcis muralis)



Foto 71. Aglais urticae



Foto 72. Calopteryx splendens

9.1.5. Monitorimi i llojeve të rrezikuara të gjitarëve në Parqet Kombëtare

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit në zonat e mbrojtura të natyrës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës - IKMN-ja, që nga viti 2015 ka filluar së realizuari aktivitetin e monitorimit të faunës së egër përmes vendosjes së kamerave kurth në zonat e mbrojtura të natyrës, me theks të veçantë në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Kjo metodë e monitorimit dhe studimit të faunës së egër, është metodë jo-intenzive pasi gjeneron informacion në lidhje me praninë e llojeve të ndryshme, pa i shqetësuar ato.



Foto 73. Mmonitorimi i faunës me kamera kurth

Gjatë këtij aktiviteti të përbashkët me zyrtarët e Parqeve Kombëtare e në disa raste në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e OJQ Environmentally Responsible Action group - ERA me seli në Pejë, është bërë vendosja e kamerave kurth kryesisht në pjesët ku besohet se janë zona të mundshme të lëvizjes së numrit më të madh të kafshëve të egra.



Foto 74. Vendosja e kamerave kurthe

Gjatë kësaj periudhe janë siguruar të dhëna për praninë e llojeve të gjitarëve si: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), vjedulla (*Meles meles*), Lepuri (*Lepus europaeus*) si dhe disa lloje tjera të zakonshme. Pas një periudhe bukur të gjatë të përcjelljes së gjendjes së faunës përmes kësaj metode, për herë të parë me 18 dhjetor 2016 u konstatua se ishte fotografuar lloji i rrallë dhe shumë i rrezikuar i Rrëqebullit ballkanik (*Lynx lynx ssp. balcanicus*).

Ky lloj më parë është konstatuar në kamerat kurth të vendosura nga ana e OJQ ERA ne rajonin e Rugovës por është hera e parë që haset në kamerat e vendosura nga ekipa e IKMN-së në këtë pjesë të Parkut Kombëtar. Meqenëse secili rrëqebull ka gëzof të ndryshëm, në fotot nga kamerat kurth është vërtetuar qe individi i Deçanit dhe i Rugovës kane gëzof të ndryshëm. Kjo na jep të kuptojmë qe individët nuk janë te njëjtë.

Gjithashtu gjatë muajit Mars 2017, kamerat e vendosura në këtë pjesë përsëri kanë kapur Rrëqebullin në lëvizje por nga kualiteti i dobët i fotografive nga kamerat kurth sikurse edhe ne rastin e parë nuk vërehet gjinia e individit e as ajo se a është kapur individi i njëjtë apo bëhet fjalë për më tepër se një individ.

Zona e Kozhnjerit tani më llogaritet një strehë e shumë kafshëve të egra e ndër to edhe e Rrëqebullit të Ballkanit, si lloj i rrallë dhe i rrezikuar në mënyrë kritike si në vend ashtu edhe më gjerë.

Prania e një numri të konsiderueshëm të llojeve të shtazëve me të cilat ushqehet ky lloj i rrallë dhe autokton i faunës sonë, pra i gjahut të tij siç janë lepuri, kaprolli, ketri, derri i egër etj, tregon për kushtet e volitshme për ekzistencën e tij në këtë zonë të Parkut.



Foto 75. Fotot e Rrëqebullit ballkanik të hasura me kamerën kurth





Foto 76 Nga regjistrimet e kamerave kurth

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me OJQ-në ERA, ka propozuar për Rezervat Strikt, zonën me rreth 550 hektar, në të cilën është evidentuar prania e rrëqebullit ballkanik gjatë viteve 2016 dhe 2017, në kuadër të territorit të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".



Foto 77. Zona e propozuar për rezervat të Rrëqebullit

Rekomandimet

- *Finalizimi i Librit të Kuq të Faunës;*
- *Fillimi i aktiviteteve për monitorimin e llojeve të rrezikuara të florës;*
- *Hartimi i Planeve të Veprimit dhe Programeve për disa nga llojet e rrezikuara të florës dhe faunës;*
- *Monitorimi i vazhdushem i habitateve të llojeve të llojet e rrezikuara të florës dhe faunës;*
- *Inventarizimi i plotë i llojeve dhe i habitateve në territorin e Republikës së Kosovës;*
- *Të ndalohet gjuetia ilegale në zonat e mbrojtura.*

10. PYJET E KOSOVËS

Sipërfaqja pyjore në Kosovë është rreth 481 000 ha (44.7% e sipërfaqes totale) dhe në krahasim me periudhën 2002-2012, sipërfaqja pyjore është rritur për 5% (20 200 ha). Duhet theksuar së sipërfaqja pyjore është përcaktuar si tokë me drurë me kurorë që mbulon më shumë se 10% dhe sipërfaqe prej më shumë se 0.5 ha. Drurët duhet të jenë në gjendje të arrijnë lartësinë minimale prej 5 metër në pjekuri në vend, që është përkufizim ndërkombëtar FAO-s.

Sipërfaqja prej 180 800 ha (38%) e pyjeve të Kosovës është në pronësi private, dhe 295 200 ha (62%) janë pyje publike. Pyjet cungishte mbulojnë 84% të sipërfaqes pyjore totale që është rezultat i shfrytëzimit intensiv të vazhdueshëm të pyjeve për prodhimin e drurëve zjarri. Pyjet kryesisht rigjenerohen në mënyrë natyrale ku veçohen ahu (*Fagus spp.*), të përziera ahu dhe halorët, pyjet halore etj.

Pyjet e Kosovës janë të dominuar nga pyjet fletorë, duke mbuluar 93% (449 400 ha), ndërsa pyjet halore mbulojnë 5% (23 800 ha) të sipërfaqes pyjore. Në total, 50% e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

Vëllimi në këmbë i drurëve me diametër në lartësi të gjoksit > = 7 cm mbetet në 40.5 milion m^3, afërsisht njëjtësi dhjetë vjet më parë. Në mesin e drurëve, specie *Fagus* kontribuojnë 46% të vëllimit, ndërsa speciet *Quercus* përfaqësojnë 23%. Mesatarja e vëllimit në këmbë në Kosovë është 84 m^3/ha. Në Evropë në përgjithësi, vëllimi në këmbë mesatar është 105 m^3/ha, i cili është më i ulët se mesatarja botërore prej 130 m^3/ha. Disa vende të Evropës Qendrore kanë pyjet me produktivitet të lartë me vëllim në këmbë deri në 250 m^3/ha. Në të gjitha rajonet e Evropës, vëllimi në këmbë është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë 20 viteve të fundit.

Rritja vjetore mbi lëvore të drurëve me diametër (DLG) > = 7 cm është llogaritur në 1.55 milion m^3, 1.32 milionm^3 fletorë dhe 0.23 milion m^3 e drurëve halore. Maksimumi prerjes vjetore afat-

gjatë në mënyrë rigoroze nganjë pikë e produktivitetit të parë është në rendin e 1.45 milion m^3. Kjo është një shifër bruto dhe duhet tëreduktohet për shkak të humbjeve me prerje, humbjet natyrore dhe konsideratat mjedisore. Neto maksimumi i nivelit të prerjeve afat-gjatë për Kosovën është në nivelin prej 1.2 milion m^3. Ky vlerësim duhet të reduktohet më tej për shkak të sipërfaqeve të pa mjaftueshme për furnizim me dru, duke përfshirë Parqet Kombtare.

Pyjet e Kosovës janë të pasura me specie druri, ku sipërfaqja pyjore prej 132 000 ha (27.5%) është e përbërë nga katër ose më shumë specie. Pothuajse të gjithë sipërfaqet pyjore (99%) tregon një lloj të ndikimit njerëzor.

Një pjesë e rëndësishme e pyjeve (rreth 24%) të Kosovës gjenden në parqet kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna".[15] Në PK "Sharri" dominojnë pyjet e fletorëve (kryesisht të ahut: Fagetum montanum dhe F. subalpinum), ndërsa në PK "Bjeshkët e Nemuna" dominojnë pyjet halore të bredhi, hormoqit, arnenit dhe rrobullit. Pyjet e parqeve kombëtare veçohen me biodiverzitet të pasur dhe praninë e shumë llojeve të rralla endemorelikte, gjë që ka ndikuar qëkëto zona malore pyjore të marrin statusin e veçantë të zonës së mbrojtur si parqe kombëtare.



Foto 78. Pyjet e ahut dominojnë në Sharr



Foto 79. Pyjet halore në Bjeshkët e Nemuna

10.1. Gjendja e ekosistemeve pyjore në Kosovë

Pyjet paraqesin ekosistemet më të rëndësishme por njëkohësisht janë edhe më të rrezikuara nga faktorët biotik (njeriu, sëmundjet dhe insektet dëmtues) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.). Posaçërisht janë të rrezikuara pyjet e llojeve halore (pishat, bredhi dhe hormoqi) nga zjarret pyjore dhe insektet dëmtues nënlivorësit (*Ips sp., Blastophagus sp., etj.)* që zakonishtë paraqitën në masë të madhe pas zjarreve si pasoj e dëmtimeve të drunjëve dhe dobësimit të sistemit imunitar të tyre. *Z*jarret paraqesin dëmtuesin më shkatërrues të pyjeve, ndërsa insektet dëmtues (nënlivorësit) ndikojnë në zgjerimin e dëmeve pyjore dhe përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes së pyjeve.

[15]MBPZHR-Departamenti i Shërbimeve dhe Këshillimeve: Pyjet dhe Ekoturzimi (fq.2), Prishtinë

Në zonat e djegura pyjore zakonisht zhvillohen llojet pionere drunore shelgu i egër (*Salix caprea*), plepi i egër (*Populus tremula*) dhe mushtekna (*Betula pendula*), ndërsa nga llojet barishtore në masë të madhe është përhapur epillobi (*Epilobium angustipholium*). Sipas raportit të Agjencisë pyjore gjatë periudhës 2015-2017 në Kosovë janë evidentuar gjithsejtë 460 raste të zjarreve, të cilat kanë përfshirë pyjet private dhe publike në sipërfaqe prej 3928 ha. Në bazë të hulumtimeve rreth 99% e zjarreve në pyje shkaktohen nga faktori njeri, vetëm një përqind e tyre, mund të shkaktohen nga faktorët abiotik. Në vendin tonë zakonisht zjarret shkaktohen në periudhën e thatësirës, gjatë muajve të verës (qershor, korrik , gusht).

Tabela 8. Zjarret në pyje 2015-2017

Nr.	Vitet	Nr. Rasteve	Sipërfaqja në ha		Total sip. ha
			Publike	Private	
1	2015	134	800	444	1 244
2	2016	88	435	194	629
3	2017	238	1 031	1 024	2 055
∑		460	2 266	1 662	3 928

Burimi: MBPZH

Pyjet e fletorëve, në veçanti të ahut dhe dushkut si më të përhapura në territorin e Kosovës, janë të rrezikuara nga prerjet ilegale të pyjeve që shkaktohen nga popullata rurale të cilit drunjët i përdorin për nevojat e ngrohjes dhe njerëzit e papërgjegjshëm për interes të përfitimeve materiale. Kjo dukuri negative ka ndikuar në degradimin e konsiderueshëm të pyjeve në gjithë territorin e Kosovës, duke mos u kursyer as parqet kombëtare. Në shfaqjen e prerjeve ilegale të pyjeve kanë ndikuar shumë faktor, ndër të cilët veçohen:

- Kërkesat e mëdha për dru zjarri si burim kryesor për ngrohje
- Gjendja e vështirë socio-ekonomike (papunësia dhe varfëria) e popullatës rurale
- Mungesa e strategjisë nacionale dhe investimeve për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale
- Mosrealizimi i fletëparaqitjeve për prerje ilegale në organet e drejtësisë
- Mungesa e burimeve alternative ekologjike për ngrohje
- Mungesa e kontrollës së tregjeve të asortimenteve drunore në gjithë territorin e Kosovës

Nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës për menaxhimin e pyjeve (APK dhe Njësitë Komunale Pyjore) dhe parqeve kombëtare (drejtoritë e PK “Sharri” dhe PK “Bjeshkët e Nemuna”)

gjatë periudhës 2015-2017 në organet e drejtësisë janë dorëzuar 17.237 fletëparaqitje (pylltaria - 16.737 fletëparaqitje[16], parqet kombëtare - 500 fletëparaqitje) për prerje ilegale të pyjeve për sasinë drunore prej 48,243.35 m^3 (pylltaria - 45,032.82 m^3, parqet kombëtare 3,210.53 m^3).



Foto 80. Pasojat e prerjeve ilegale në zonën e Firajës



Foto 81. Dëmët pyjore nga fatkeqësia natyrore, në Sharr

Prerjet e paligjshme të pyjeve paraqesin problemin kryesor në menaxhimin e resurseve pyjore në Kosovë sepse shkaktojnë dëmtime të konsiderueshme ekologjike dhe humbje të mëdha ekonomike (financiare). Pasi që ky problem është të nivelit nacional (shtetëror), për zgjidhjen e tij nevojitet angazhimi i të gjitha institucioneve relevante qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës. Në qoftë së urgjentisht nuk ndërmerren masat adekuate për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve, në të ardhmen do të nevojiten mjetet e mëdha për sanimin e gjendjes, por suksesi nuk do të jetë i garantuar.

Në gjitha pyjet e Kosovës paraqitën dëmet pyjore me intensitet të ndryshëm nga fatkeqësitë natyrore (erërat, dëbora etj.), sëmundjet bimore (fitopatogjenet) dhe insektet dëmtues. Dëmet nga era dhe dëbora shkaktohen në veçanti gjatë sezonës dimërore, ndërsa dy faktorë të tjerë (sëmundjet dhe insektet) janë aktivë gjatë zhvillimit të vegjetacionit në stinën e pranverës, verës dhe vjeshtës.

Sëmundjet bimore, që kryesisht shkaktohen nga kërpudhat, të shumica e llojeve drunore kanë karakter sporadik. Pasojat më të rënda në të kaluarën janë shkaktuar nga tumorit i livorës të gështënja(*Cryphonectria parasitica*) dhe ashtuquajtura sëmundja holandeze (*Ophiostoma ulmi*) të vidhi. Nga sëmundjet tjerë bimore veçohen:

- tumori i lëvorës të ahu (*Necctria ditissima*),
- shkaktari i kalbjes të ahu (*Fomes fomentarius*),

[16] APK: Raport për gjendjen e pyjeve 2015 - 2017.

- tumori i lëvorës te bredhi (*Melamsporella caryophyllacearum*),
- shkaktarët e kalbjes (*Armilaria mellea dhe Heterobasidion anosun*) në trungjet e bredhit dhe hormoqit,
- tumori i lëvorës të shkoza (*Taphrina carpini*) etj.

Nga llojet e shumta të insekteve si dëmtuesit më të mëdhenj të pyjeve veçohen nënlivorësit (*Scolytinae*) që në mënyrë masive paraqitën pas zjarreve në pyjet e halorëve. Nga përhapja dhe intensiteti i dëmeve pyjore veçohen edhe vemja e pishës (*Thaumatopoea pityocampa*), molë e dushkut (*Lymantria dispar*) etj. Shumica e llojeve të tjera të insekteve kanë karakter sekondar dhe kryesisht paraqitën të drunjtë e vjetëruara me imunitet të dobësuar.

Një gjysëm parazit specifik që paraqitet në pyjet e bredhit është veshtulla (Viscum album) që njihet si bimë me vlera të veçanta mjekësore. Ky lloj bimor nga druri, ku është i vendosur, e shfrytëzon ujin ndërsa vet e prodhon ushqimin nëpërmjet fotosintezës.



Foto 83. Insekti dmtues vemja e pishës



Foto 84. Veshtulla (Viscum album) në bredhin

Duhet theksuar së pyjet e pastra dhe njëmoshare janë më të ndijshme ndaj ndikimeve negative të faktorëve biotik dhe abiotik. Zhvillimin më të qëndrueshëm e kanë pyjet e përziera të llojeve të ndryshme të fletorëve dhe fletorëve me halorët. Ripërtërirja natyrore e pyjeve është relativisht e mirë, që konfirmohet edhe me zgjerimin e pyjeve prej rreth 5% (20 200 ha) gjatë 10 viteve të fundit (2002-2012)[17].

Gjatë dy dekadave të fundit në përkeqësimin e gjendjes së resurseve natyrore (florës, faunës dhe ekosistemeve) kanë ndikuar ndryshimet globale klimatike të cilët karakterizohen me zvogëlimin e reshjeve vjetore, temperaturat e larta ekstreme dhe thatësirat e theksuara gjatë verës dhe vjeshtës.

Për shkak të ngrohjes globale në të ardhmën duhet llogaritur në rritjen e dëmeve pyjore, në veçanti nga zjarret, insektet dhe fatkeqësitë natyrore.

Institucionet relevante, me qëllim të mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së pyjeve dhe furnizimit të tregut (popullatës) me dru zjarri dhe asortimente tjera drunore, kanë aplikuar prerje të pyjeve me karakter

[17]MMPH (2013): Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës (2012).

sanitar dhe kultivues. Nga APK-ja dhe Njësitë Komunale Pyjore gjatë periudhës 2015-2017 është prerë masa drunore me vëllim prej 528,907.25 m^3. [18] Prerjet dhe pastrimet e kufizuara sanitare të drunjve të dëmtuara nga zjarri, fatkeqësitë natyrore, sëmundjet dhe insektet dëmtues janë aplikuar edhe në parqet kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna". Gjatë periudhës 2015-2017 vëllimi i prerjeve dhe pastrimeve sanitare në PK "Sharri" ka qenë 9,803.02 m^3 [19], ndërsa në PK "Bjeshkët e Nemuna" ka qenë 32,496.31 m^3. [20]

Me qëllim të shtimit të sipërfaqeve me pyje, çdo vit Agjencia pyjore bën pyllëzimin e rreth 250-350 ha të tokave të zhveshura pyjore. Zbatimi i kësaj mase ka për synim rritjen e prodhimtarisë të tokave të zhveshura, dhe kthimin e tyre në funksion prodhues. Në këto pyllëzime kanë kontribuar dy organizata të huaja si FAO dhe German GIZ. Agjencia pyjore ka planifkuar mirëmbajtjen e pyllëzimeve në tokat e zhveshura në sipërfaqe rreth 737 ha, por ka arritur të realizoj 468 ha[21].

10.2. Menaxhimi i ekosistemeve pyjore dhe sfidat

Çështja e menaxhimit të pyjeve ndërlidhët me statusin e zonës pyjore, andaj ekzistojnë dy qasje menaxhuese: menaxhimi i pyjeve të zonave të mbrojtura (parqeve kombëtare) dhe menaxhimi i pyjeve jashtë parqeve kombëtare (që nuk kanë status të mbrojtur).
Menaxhimi i ekosistemeve pyjore në zonat e mbrojtura, respektivisht në parqet kombëtare, bazohet në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (nr. 03/L-233), Ligjet për PK "Bjeshkët e Nemuna" (nr. 04/L-086) dhe PK "Sharri" (nr. 04/L-087) dhe aktet e tjera nënligjore (Udhëzimet Administrative, Rregulloret, Vendimet etj.) që përgatitën nga MMPH dhe e rregullojnë menaxhimin e gjitha resurseve natyrore të parqeve kombëtare. Në menaxhimin e zonave dhe llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës zbatohet edhe legjislacioni ndërkombëtar (konventat dhe direktivat) nga fusha e mjedisit natyror, ndërsa prioritet kanë: Rrjeti Ekologjik "Natura 2000", Direktiva e BE-së për habitate, Direktiva e BE-së për zogjtë etj.

Planet për menaxhimin e parqeve kombëtare, që hartohen nga MMPH dhe drejtoritë përkatëse, janë: planet hapësinore të parqeve kombëtare, planet menaxhuese afatgjata, planet vjetore menaxhuese dhe planet operative.

MMPH është kompetente për politikat dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, respektivisht të parqeve kombëtare, ku janë të koncentruar pyjet më të rëndësishme të Kosovës nga aspekti i

biodiversitetit dhe kualitetit. Menaxhimin e drejtpërdrejtë të parqeve kombëtare e bëjnë drejtorit përkatëse: Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar (DAPK) "Sharri" me seli në Prizren dhe Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me seli në Pejë, të cilët funksionojnë në kudër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Këto drejtori menaxhojnë me të gjitha resurset natyrore në gjithë territorin e parqeve kombëtare që shtrihet në disa komuna.

[18] APK: Raport për gjendjen e pyjeve për periudhën 2015 - 2017.
[19] DAPK "Sharri": Raportet e punës për vitet 2015. 2016 dhe 2017.
[20] DAPK "Bjeshkët e Nemuna": Raport për zjarret, ndërtimet dhe prerjen e pyjeve legale dhe ilegale 2015-2017
[21] APK: Raport për gjendjen e pyjeve për periudhën 2015 - 2017.

Menaxhimi i pyjeve dhe tokave pyjore në posedim publik dhe privat, që janë jashtë parqeve kombëtare, është i rregulluar me Ligjin për pyjet e Kosovës (2003/3) dhe aktet tjera nënligjore që përgatiten nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Përveç lëgjislacionit vendor, menaxhimi i ekosistemeve pyjore është ngushtë i lidhur edhe me legjislacionin nga fusha e mjedisit dhe konventën ndërkombëtare e Rio de Zheneiros (1992) mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Bazën kryesore planifikuese për menaxhimin e pyjeve jashtë parqeve kombëtare, që përgatitet në kuadër të MBPZHR, e përbëjnë: Politika dhe strategjia e zhvillimit të sektorit të pylltarisë 2010-2020; Planet menaxhuese afatgjata për njësitë ekonomike, Planet vjetore menaxhuese dhe Planet operative. Në bazë të Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, synohet që çdo vit të mbulohen me plane menaxhuese afatgjatë rreth 30.000 ha sipërfaqe pyjore. Agjencia Pyjore e Kosovës për vitet 2015-2017 ka përmbyllur me sukses hartimin e 19 planeve të menaxhimit për njësi menaxhuese pyjore, që përfshin sipërfaqen rreth 73,410.40 ha.

MBPZHR është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave mbi pyjet e Kosovës. Pjesë integrale e MBPZHR është Departamenti për Pyjet, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave dhe infrastrukturën ligjore. Agjencia e Pyjeve të Kosovës është organ i themeluar në vitin 2003 nën ombrellën e MBPZHR i cili menaxhon me tokat pyjore publike dhe private, ndërsa është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve nga fusha e pylltarisë, lëshimin e lejeve për grumbullim të prodhimeve pyjore jo drusore, monitorimin e prerjes së pyjeve dhe zhvillimin e resurseve pyjore. Agjencia e Pyjeve ka gjashtë drejtori në 6 qytete të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj). Në Pejë është themeluar edhe Instituti për Pylltari i cili kryen hulumtime nga kjo fushë. Nga viti 2010, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), komunat kanë edhe kompetenca të deleguara nga ana e Agjencisë e të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e pyjeve dhe lëshimin e lejeve për prerjen e pyjeve publike dhe private.

Burimi kryesor për financimin e menaxhimit të pyjeve, duke nënkuptuar edhe parqet kombëtare, është buxheti shtetëror, ndërsa nga burimet tjera veçohen të hyrat vetanke nga shërbimet dhe shfrytëzimi (shitja) i produkteve natyrore dhe donacionet.

Menaxhimi i pyjeve ballafaqohet me sfida dhe probleme të shumta, ndërsa veçohen:

- Mungesa e investimeve në menaxhimine pyjeve, e cila në veçanti është e shprehur në parqet kombëtare. Drejtoritë e parqeve kombëtare nuk kanë buxhet të veçantë por financohen në kuadër të buxhetit të AMMK-së që është të jet i kufizuar;
- Mungesa e punëtorëve (stafit profesional dhe rojtarëve) në DAPK “Sharri”. Kësaj drejtorie, në bazë të Planit menaxhues të PK “Sharri” (2015), i mungojnë 66% të resurseve humane (mungojnë punëtorët në komunat e Dragashit, Shtërpcës dhe Kaçanikut). Institucionet pyjore (Departamenti i Pyjeve, APK dhe Njësitë Pyjore Komunale) dhe DAPK “Bjeshkët e Nemuna” në masë të madhe i kanë kompletuar kapacitetet humane menaxhuese.

- Legjislacioni i pakompletuar që nënkupton ekzistimin e mangësive ligjore dhe mosdefinimin (përzierjen) e kompetencave menaxhuese mbi pyjet e zonave të mbrojtura (parqet kombëtare). Përveç mangësve ligjore problem të madh paraqet mos zbatimi i dispozitave ekzistuese ligjore.
- Mungesa e një strategjie nacionale dhe përkrahjes politike për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale si dhe mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, sëmundjet dhe insektet dëmtues. Kjo ka ndikuar në pasojat e mëdha negative ekologjike dhe socio-ekonomike në gjitha pjesët e Kosovës duke përfshirë edhe zonat pyjore të parqeve kombëtare.
- Gjuetia dhe shfrytëzimi pa kontroll i resurseve pyjore jo drunore (bimëve mjekuese, frutave pyjore, mineraleve, kapaciteteve turistike etj.). Kjo ka ndikuar në dëmtimin e këtyre resurseve dhe humbjen e mjeteve të konsiderueshme financiare.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes të grupeve të ndryshme të interesit.

10.3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Pyjet paraqesin ekosistemet më komplekse dhe më të rëndësishme në mjedisin natyror. Rëndësia e pyjeve shprehet nëpërmjet funksioneve: ekonomike (prodhimi i biomasës), sociale (ndikimi në shëndet dhe mirëqenien e popullit) dhe ekologjike (ndikimi në mjedis). Pyjet e Kosovës, duke marr parasysh së e mbulojnë gjysmën e territorit (rreth 45%) të vendit dhe janë faktor kryesor për barazpeshën ekologjike, paraqesin resurse kombëtare.[22]

Gjendja e pyjeve të Kosovës është e vështirësuar si pasoj e ndikimit negativ të faktorëve biotik dhe abiotik. Dëmet më të theksuara pyjore shkaktohen nga faktori antropogjen (njeriu) nëpërmjet prerjeve ilegale dhe zjarreve. Faktorët tjerë (sëmundjet, insektet dëmtues dhe fatkeqësitë natyrore) shkaktojnë dëme pyjore me intensitet të ndryshëm, kryesisht sporadike, ndërsa nga niveli i lartë i dëmeve veçohen nënlivorësit që zakonisht zhvillohen në masë të madhë pas zjarreve në pyjet halore. Sipërfaqja pyjore në Kosovë gjatë periudhës 2002-2012 është rritur për 5% (tani është rreth 45% të sipërfaqes totale), por dëmtimet dhe degradimet e vazhdueshme të pyjeve kanë ndikuar negativisht në cilësinë dhe sasinë e masës drunore. Përveç humbjeve ekonomike janë dobësuar edhe funksionet sociale dhe ekologjike të pyjeve.

Menaxhimi i pyjeve është i vështirësuar si pasojë e shumë sfidave dhe problemeve më të cilët ballafaqohen institucionet përkatëse pyjore dhe të parqeve kombëtare. Sfidat janë të natyrave të ndryshme: politike (mungesa e autoritetit menaxhues në veri të vendit), ligjore (përzierja e kompetencave menaxhuese), ekonomike (mungesa e mjeteve financiare), organizative (mungesa e punëtorëve) etj.

Për të rregulluar menaxhimin e pyjeve duhet të zgjidhen sfidat dhe problemet që kanë shkaktuar gjendjen e vështirë të pyjeve dhe institucioneve menaxhuese pyjore dhe të praqeve kombëtare. Për

[22] Ligji për pyjet e Kosovës nr. 2003/3, neni 1.paragrafi 1.2.

t'i evituar sfidat dhe problemet dhe për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve nevojitet ndërmarrja e masave të gjithanshme, ndërsa veçohen:

- Shtrirja e autoritetit menaxhues të pyjeve në veriun e Kosovës nga APK-ja;
- Kompletimi i legjislacionit për menaxhimin e pyjeve brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura (parqeve kombëtare) që nënkupton përshtatja me legjislacionin e BE-së dhe definimin e të gjitha aspekteve menaxhuese dhe kompetencave të përgjegjësive midis institucioneve pyjore dhe parqeve kombëtare;
- Plotësimi i strukturës organizative, respektivisht plotësimi i kapaciteteve njerëzore në institucionet menaxhuese;
- Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, me theks të veçantë në parqet kombëtare ku mungesa e financimit është më shprehur;
- Hartimi i një strategjie për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale. Kjo strategji duhet të jetë gjithëpërfshirëse e cila përveç masave direkte të mbrojtjes, duhet të përmbaje edhe projekte edukative për vetëdijesimin ekologjik të komuniteteve dhe socio-ekonomike për përmirësimin e gjendjes së popullatës rurale;
- Vendosja e menaxhimit institucional mbi gjuetinë dhe shfrytëzimin e resurseve pyjore jo drusore (bimët mjekuese, frtuat pyjore, mineralet, ekoturizmi). Nevojitet hartimi i strategjisë dhe planeve adekuate menaxhuese për këto resurse pyjore që do të mundësojnë shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të tyre dhe sigurimin e burimeve alternative financiare për institucionet pyjore dhe të parqeve kombëtare. Kontributin e veçantë për sigurimin e bazës planifikuese për shfrytëzimin e resurseve pyjore jodrusore ka dhënë organizata Gjermane GIZ;
- Rritja e bashkëpunimit me gjitha grupet e interesit, në veçanti me institucionet e sigurisë, drjetësisë financiare dhe OJQ-të. Menaxhimi i pyjeve dhe resurseve natyrore në përgjithësi funksionon si një sistem zinxhiror që ndërlidh shumë institucione (menaxhuese, financiare, të sigurisë, drejtësisë, inspektuese, monitoruese dhe arsimore). Në qoftë se një hallkë (institucion) i këtij zinxhiri dështon në pyetje vihet funksionimi i gjithë sistemit. Andaj me rëndësi të veçantë është bashkëpunimi dhe koordinimi i gjitha institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në Kosovë;
- Sigurimi i burimeve alternative (gazit, energjia solare etj.) për ngrohje që i plotësojnë kushetet ekologjike dhe ekonomike për t'i zvogëluar kërkesat e mëdha për dru zjarri dhe presionin për prerje të tepruar të pyjeve;
- Vendosja e inspektimit dhe kontrollit efikas ligjor mbi tregun e produkteve drunore në gjithë Kosovën, ku për momentin mbizotëron anarki totale;
- Ndalimi i uzurpimeve të pyjeve dhe tokave pyjore në pronësi publike dhe ndërmarrja e masave për kthimin e pronave të uzurpuara.

11. EKOTURIZMI

11.1. Ekoturizmi në Zonat e Mbrojtura

Në Kosovë ekoturizmi është një dukuri e re por në shumë vende të botës ky lloj turizmi është shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Kosova shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peizazhet, grykat e kanionet, bota e pasur bimore dhe shtazore janë parakushte ideale dhe potencial i lartë për zhvillimin e ekoturizmit. Kosova veçanërisht ka mundësi të mira të zhvillimit të ekoturizmit të shpellave, ekoturizmit malorë, ekoturizmit rekreativ-sportiv, ekoturizmit verorë, ekoturizmit rural dhe atij edukativ arsimor.

Ekoturizmi i shpellave - Për opinionin e gjerë janë të njohura bukuritë natyrore të Shpellës së Gadimes, e cila njëherit është edhe ndër atraksionet më të mëdha turistike në vend. Në vitet e fundit eshte hapur për vizitor edhe shpella e Radavcit e cila eshë shpella e dy e përgatitur për vizitorë në Kosovë. Mirëpo Kosova ka edhe disa shpella të tjera dhe përmirësimi i infrastrukturës së tyre do të ofronte kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit të shpellave, si për shembull Shpella Gryka e Madhe, Shpella e Panorcit, Shpella e Dushit, Shpellat e Zatriqit etj.

Ekoturizmi malor dhe ecja në natyrë - Në zonat e thella malore të Kosovës ekzistojnë shumë shtigje malore të cilat paraqesin mundësi reale për zhvillimin e ecjes në natyrë, shëtitjeve malore me biçikleta por edhe të ekspeditave dhe kampingjeve. Përveç Maleve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna, ky lloj i turizmit mund të zhvillohet edhe në Bjeshkët e Shalës së Bajgores, Vargmalet e Berishës, Malet e Jezercit etj.

Ekoturizmi veror dhe njëditorë-klima e përshtatshme, burimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske janë parakusht i mirë edhe për zhvillimin e turizmit veror dhe kampingut; Liqeni i Batllaves, Kanioni i Mirushës, Gryka e Rugovës, Bifurkacioni i Lumit Nerodime, Muzeu i kristaleve në Stan Tërg, Burimi i Drinit të Bardh, Shpella e Radavcit dhe Liqenit i Breznes, janë vetëm disa nga zonat që gjatë stinës së verës mund të jenë destinacion i përhershëm i shumë turistëve dhe adhuruesve të natyrës që dëshirojnë të kalojnë një ditë në natyrë.

Ekoturizmi rural - Në shumë zona rurale të Kosovës, e sidomos në ato malore ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra, këngë, veshje e ushqime tradicionale. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë një mundësi e mirë e zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Në veçanti për këto vlera shquhen fshatrat malore që shtrihen në Malet e Sharrit e sidomos ato që i takojnë komunës së Dragashit si dhe rajoni i Novo Bërdos.



Foto 85. Tturizmi malor gjatë dimrit (*foto Hiking njeri)*

Turizmi rekreativ dhe sportiv - Në Malet e Sharrit, në Bjeshkët e Nemuna por edhe në zona tjera malore të Kosovës, gjenden shumë terrene të përshtatshme për zhvillimin e skitarisë. Kapaciteti i terreneve të skijimit të këtyre qendrave mund të pranojnë me mijëra vizitorë gjatë sezonit të dimrit. Ndërsa gjatë verës në Malet e Sharrit dhe në Bjeshkët e Nemuna ka plot maja të cilat janë shumë atraktive për zhvillimin e alpinizmit dhe bjeshkatarisë. Kosova përveç dy rezervateve të veçanta të gjuetisë (Blinaja dhe Duboçaku), ka edhe shumë zona tjera rekreative të pasura me lloje të gjitarëve dhe zogjve të egër, që ofrojnë kushte ideale për zhvillimin e ekoturizmit të gjuetisë. Të tilla janë Bjeshkët e Nemuna, Malet e Sharrit, Bjeshkët e Berishës, Bjeshkët e Jezercit etj. Ndërkohë që disa lumenj e përroska malore ofrojnë kushte ideale edhe për zhvillimin e peshkimit sportiv. Drini i Bardhë, Drenica, Lumëbardhi, Mirusha, Llapi, Ibri e Lepenci përveç peizazheve piktoreske janë edhe zona të rëndësishme peshkimi. Në këta lumenj mundë të peshkohet trofta malore, mlyshi, krapi, ngjila etj.

Ekoturizmi edukativ dhe shkencor - Ekosistemet e paprekura malore, prania e llojeve të rralla bimore e shtazore, shpellat e pa hulumtuara, kanionet, rrjedhat e shumta ujore dhe pasuritë nëntokësore të Kosovës kanë potencial edhe për zhvillimin e aktiviteteve edukative e kërkimore me nxënës, studentë dhe shkencëtareve nga Kosova por edhe për ekspedita të huaja hulumtuese

Destinacionet ekoturistike në Kosovë - Padyshim se destinacionet më interesante dhe më tërheqëse për ekoturizem ne Kosovë janë zonat e mbrojtura te natyrës. Aktualisht numri i Zonave të Mbrojtura të Natyrës është 184 dhe përfshinë sipërfaqen prej 126119.29 ha (11.55 % të territorit të Kosovës). Destinacionet më të rëndësishëm ekoturistike në Kosovë janë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna", Ujëvarat e Mirushes, Blinaja, Shpella e Gadimes, Burimi i Drinit të Bardh dhe Shpella e Radavc, Shpella Gryka e Madhe, Liqeni i Batllaves, etj.



Foto 86. Turizmi rekreativ dhe sportiv *(hiking njeri*)

11.2. Gjendja

Përkundër këtyre vlerave të jashtëzakonshme dhe mundësive ideale për zhvillimin e ekoturizmit, mungesa e infrastrukturës, mungesa e shtigjeve malore, mungesa e guidave turistike, mungesa e investimeve, mungesa e planeve dhe projekteve konkrete ka penguar zhvillimin e kapaciteteve ekoturistike.

Problem i veçantë është qasja që institucionet qeveritare dhe shoqëria kosovare ka ndaj shfrytëzimit të këtij potenciali. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, dëmtimi i ekosistemeve, gjuetia ilegale, zgjerimi i vendbanimeve në zonat e mbrojtura, janë kërcënim i vazhdueshëm për këto vlera dhe pengesë për zhvillimin e ekoturizmit.

11.3. Rekomandimet

- *Zhvillimi i sektorit të ekotuzimit në Kosovë varet shumë nga investimet e mëtejshme dhe përmirësimi i infrastrukturës e cila duhet të jetë në harmoni me konceptin e ekoturizmit;*
- *Promovimi më profesional i zonave ekoturistike, rritja e investimeve, hartimi i projekteve dhe programeve si dhe përgatitja e një strategjie kombëtarë për zhvillimin e ekoturizmit do të ndihmonte që Kosova të jetë një destinacion atraktiv ekoturistik;*
- *Rendësi të veçantë t'i kushtohet vetëdijesimit të komunitetit për rendësin e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë natyrore dhe informimi i tyre për mundësitë e përfitimit qe munde të kenë nga ky lloj turizmi;*
- *Implementimi i përvojave dhe praktikave të mira të dëshmuara në vendet që e kanë të zhvilluar këtë lloj turizmi është një mundësi që mundë të bartët edhe në Kosovë.*

12. PROJEKTET NACIONALE DHE TË FINANCUAR NGA DONATORËT

12.1. Shënjezimi i Monumenteve të Nnatyrës

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në vitin 2016, ka realizuar projektin për shenjëzimin e Zonave të Mbrojtura -Monumenteve Natyrore, në 17 komunat në të cilat gjenden këto objekte. Gjatë realizimit të këtij projekti që është financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, (MMPH) janë shenjëzuar 124 Monumentet Natyrore, tri (3) Monumente Natyrore me Rëndësi të Veçantë dhe një (1) Peizazh i Mbrojtur.



Foto 87. Shenjëzimi monumenteve të natyrës

12.2. Libri i Kuq i Faunës

Në kuadër të Programit Mjedisor i Kosovës (PMK) financuar nga Qeveria Suedeze - SIDA, është duke u realizuar projekti (komponenta e dytë) Inventarizimi i biodiversitetit përmes Librit të Kuq të Faunës.

Në periudhën 2016-2017, në kuadër të projektit për hartimin e Librit të Kuq të Faunës janë realizuar një numër i madhe i aktiviteteve si: Përgatitja e metodologjisë së punës për hartimin e librit të Kuqë të Faunës (sipas kritereve të IUCN) , hartimi i planit të punës, përgatitja e termave të referencave për ekspertet, përgatitja e përmbajtjes së librit të kuq të faunë, angazhimi i 5 ekspertet vendor (në të ardhmen do të angazhohen edhe eksperte ndërkombëtar), organizimi dhe mbajtja e punëtorisë së parë (2017) me ekspertët (qëllimi i punëtorisë ishte njohja më metodologjinë e punë), përgatitja e listës per blerjen e e pajisjeve të nevojshme për realizmin e librit të kuqë të Faunës.

Realizimi i këtij projekti ka rendësi të madhe për MMPH, MBZHR, UP, QJQ ,etj, se për herë të parë në Kosovë behet inventarizimi i faunë dhe në baze të dhënave të librit te kuq të faunës do të hartohen politikat dhe strategjitë për mbrojtjen dhe konservimin e faune në Kosove. Përfundimi i këtij projekt dhe botimi i Librit të Kuq të Faunë parashihet të përfundoj në fund të vitit 2018.

12.3. Rritja e Menaxhimit të Zonave Ndërkufitare Natyrore

Komponentit 3 e Programit Mjedisor i Kosovës (PMK), synon të mbështesë Drejtoritë e Parqeve Kombëtare (PK) për të ndërtuar një strukturë të përshtatshme për menaxhimin e parqeve dhe forcimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale për të promovuar një zhvillim të qëndrueshëm të PK. Ky komponent është një nga tetë komponentët teknik të Programit Mjedisor të Kosovës (PMK) i propozuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), financuar nga Sida dhe i menaxhuar nga Ambasada Suedeze në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti do të bëhën katër plane rregullues për zonat e treta: dy në Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Bogë dhe gropa e Erenikut) dhe dy në Parkun Kombëtar "Sharri" (Prevalla dhe Zaplluzhë) po ashtu do të hartohet edhe plani menaxhues për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna si dhe qendra e informacionit ne dy parqet kombëtare.

12.4. Inventarizimi i llojeve të bimëve, shtazëve, tipat e vendbanimeve natyrore dhe paraqitja hartografike e tyre

Të dhënat për habitatet prioritare sipas Aneksit I të Direktivës së BE për habitatet dhe ndërlidhja me kategoritë korresponduese sipas klasifikimit të EUNIS të prodhuara në kuadër të këtij projekti të shërbejnë si baza fillestare e bazës së të dhënave për habitatet në MMPH, mbi të cilat të shtohen të dhënat e ardhshme.

Bazuar në thirrjen, term detyrë si dhe në bazë të pritjeve të MMPH-së për produktet e projektit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të materialeve, dokumenteve dhe raporteve të dorëzuara nga ana e kompanisë janë realizuar këto studime dhe aktivitete:

- Llojet e habitateve natyrore me interes për komunitetin, për konservimin e të cilave kërkohet dizajnimi i zonave të veçanta për konservim.
- Lista e llojeve bimore dhe shtazore të identifikuara nga literatura duke përfshirë të dhënat sistematike, prezencën në dokumentet përkatëse si anekset e Direktivës së BE për habitatet dhe dokumentet tjera relevante si dhe statusi sipas IUCN.
- Lista e llojeve të bimëve dhe shtazëve me të dhënat relevante nga baza e të dhënave EUNIS, përfshirë të dhëna për prezencën në dokumente relevante, kodi sipas NATURA 2000, shtrirja në Kosovë, habitati i preferuar etj.
- Kodet përkatëse të cilat i ndërlidhin llojet e bimëve dhe shtazëve me paraqitjen e tyre në harta, gjeodatabaza, MDB dhe data bazën DB. Hartat: bimët, habitatet, kurrizorët, shpendët dhe pakurrizorët.
- Udhëzuesi për përdorimin e klasifikimit të tipeve të vendbanimeve sipas EUNIS. Manuali interpretues për habitatet (sipas Aneksit I të Direktivës së BE-së për Habitatet) dhe trajnimi për stafin e MMPH-së për "Klasifikimin e tipeve të vendbanimeve natyrore".

12.5. Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Biodiversiteti (ORF-BD)

Ky projekt i filluar në vitin 2016 financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Objektivi i projektit: Rritja e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore për të kontribuar në zbatimin e Strategjisë së BE-së për Biodiversitetin 2020.

Evropa Juglindore është jashtëzakonisht e pasur në aspekt të biodiversitetit duke filluar nga zonat bregdetare, zonat e lumenjve, pyjeve e deri në masivet e larta malore. E veçantë është posaçërisht shumëllojshmëria e florës dhe faunës endemike në Ballkanin Perëndimor.

Me gjithë rëndësinë e llojeve dhe diversitetit të ekosistemit si në nivel rajonal, e po ashtu edhe në nivel kombëtar dhe lokal, ajo nuk mbulohet në mënyrë të mjaftueshme prandaj mungon një mënyrë adekuate e mbrojtjes së integruar siç parashihet në planet zhvillimore.

Aderimi në Bashkimin Evropian (BE) është një qëllim i përbashkët për të gjitha vendet e rajonit të Evropës Juglindore andaj zbatimi i legjislacionit mjedisor evropian, si mjaft kompleks dhe ndër sektorial, e vë bashkëpunimin mes vendeve përballë sfidave të mëdha. Projekti është i dizajnuar të mbështes dhe promovojë bashkëpunimin rajonal të organizatave të lidhura me biodiversitetin - në veçanti ministritë e mjedisit dhe agjencitë mjedisore që merren me, apo ndikojnë në biodiversitetin dhe ekosistemet, duke përfshirë pylltarinë dhe bujqësinë, administratat komunale, institucionet akademike dhe institutet kërkimore si dhe organizatat joqeveritare mjedisore.

Kjo bëhet përmes zbatimit të nën-projekteve rajonale që përfshijnë së paku organizata nga tre vende të përfshira në këtë projekt. ORF BD bashkëpunon ngushtë me iniciativat dhe rrjetet ekzistuese rajonale dhe mbështet formimin e partneritetit për të arritur efektet e synuara dhe për të rritur qëndrueshmërinë.



Fushat kryesore të angazhimit të projektit të GIZ janë:

- Task Forca e Biodiversitetit (BDTF),
- Rrjeti Rajonal për Menaxhimin e Informacionit të Biodiversitetit dhe Raportimin (BIMR),
- Rrjeti Rajonal i Organizatave të Shoqërisë Civile në lidhje me Biodiversitetin (BioNET),

- Vlerësimi i Shërbimeve të Ekosistemit në kuadër të veprimeve të ardhshme në EJL (ESAV) dhe
- Menaxhimi i Ekosistemeve Ndërkufitare në nivel lokal (TEM).

Arritjet e deritanishme të projektit janë:

- Formimi i Task Forcës Rajonale për Biodiversitetin brenda Këshillit Rajonal të Bashkëpunimit (RCC –Regional Cooperation Council);
- Vlerësimet kombëtare për Rrjetin Rajonal për menaxhim dhe raportim të informacionit të biodiversitetit (BIMR) në të gjitha vendet e EJL;
- Formimi i Rrjetit Rajonal të Shoqërisë Civile në fushën e biodiversitetit (BioNET),
- Rrjetëzimi i ekspertëve të biodiversitetit në rajon duke përfshirë mbështetjen e rrjetit të ri të ruajtjes së natyrës (BalkaNatureNet);
- Janë realizuar trajnime mbi konceptin e shërbimeve të ekosistemit dhe vlerësimin për të rritur kapacitetet e burimeve njerëzore nga organizatat qeveritare dhe ato joqeveritare;
- Janë njoftuar Grupet dhe Komisionet parlamentare në rajon lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit;
- Nisja e mbështetjes për zbatimin e Vizionit të Përbashkët të biodiversitetit në Zonën Ndërkufitar Mali Sharr në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal, etj.;

Faza e parë e këtij projekti pritet të përfundoj ne Maj të vitit 2018 për të vazhduar me fazën e dytë që si objektiv i propozuar është forcimi i bashkëpunimit rajonal për të zbatuar detyrimet ndërkombëtare dhe atë të BE për ruajtjen e biodiversitetit;

12.6. Projekti BORN - BORderless Nature (Mbrojtja dhe Zhvillimi i Biodiversitetit të Parqeve Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Prokljetije”)

Ky projekt i realizuar gjatë viteve 2016-2017 u zbatua nga organizata italiane “Trentino Con il Kosovo” dhe Komuna e Plavës në bashkëpunim me Agjencionin e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Qendrën për Zhvillim Rajonal në Rozhajë. Projekti u financua nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Kosovë-Mali i Zi.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit ishte mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit në zonat e projektit dhe në veçanti në Parqet Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” (Kosovë) dhe “Prokletije” (Mal të Zi), duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar në mes institucioneve. Përfituesit e drejtpërdrejtë në këtë projekt kanë qenë Parqet Kombëtare Bjeshkët e Nemuna dhe Prokletije, Komunat: Pejës, Istog, Petnjice, Plavë,

Administratat lokale, Shkollat, Universitetet, Organizatat e Shoqërisë Civile, fermerët, operatorët turistikë, restorantet, hoteleritë dhe udhëheqësit lokal.

Aktivitetet kryesore të parapara në kuadër të projekti BorN kanë qenë:

- Krijimi i komitetit drejtues dhe krijimi i hartave të akterëve;
- Hartografimi i biodiversitetit;
- Krijimi i një Rrjeti Ekologjik Ndërkufitar;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi vlerën e burimeve natyrore në sistemin arsimor.;
- Projekte konkrete zhvillimore mbi energjinë e ripërtëritshme, pylltarinë, burimet natyrore dhe bulmeti;
- Rritja e ofertave turistike në natyrë.

Rezultatet e këtij projekti janë:

- Krijimi i hartës së partnerëve në zonën aktive ndërkufitare me qëllim të mbrojtjes së mjedisit, biodiversitetit dhe promovimin e turizmit;
- Identifikimi i biodiversitetit ndërkufitar në Kosovë dhe Mal të Zi si dhe hartografimi i tij në platformë Web GIS;
- Krijimi i Rrjeti Ekologjik Ndërkufitar;
- Përgatitja e Paketa Edukative (mbi edukimin mjedisor në Shkolla);
- Përgatitja e broshurës rreth menaxhimit të mirëfillt të pyjeve në Kosovë dhe Mal të Zi;
- Realizimi i hulumtime ndërkufitare për bimët mjekësore;
- Realizimi i vizitave studimore në Itali për krijimin e një pakete edukative për mjedis dhe menaxhim të pyjeve;
- Krijimi i ofertave turistike në Rugovë:
- Përgatitja dhe rehabilitimi i Shtigjeve si: Shtegu i Çobanëve (108 km), Shtegu i Çiklizmit malor me dy nënshtigje “Rekë e Allagës” (4.26 km) dhe “Shtupeqi i Madh” (5.39 km), Shtegu i ngjtjes në shkëmbinjë “Vip Balcony” me 15 zona të ngjitjes.



Fig. 9. Harta e Web-GISit e realizuar në kuadër të projektit Rrjeti ekologjik ndërkufitar

12.6. Bashkëpunimi me Shoqatën Evropiane "Brezi i Gjelbër"

Nisma për Brezin e Gjelbër Evropian është iniciuar që nga viti 2003, mandej me 24 shtator 2014, në Sllavonice të Republikës Çeke, u themelua Shoqata Evropiane "Brezi i Gjelbër", ndërsa regjistrimi zyrtar i saj është bërë në muajin shkurt të vitit 2015. Deri më tani në të janë anëtarësuar njëzeteshtatë organizata qeveritare dhe joqeveritare me gjithsej katërmbëdhjetë shtete evropiane dhe është themeluar Bordi i saj në të cilin marrin pjesë shtatë organizata dhe është vendosur që kryesuese të jetë EuroNature nga Gjermania. Në këtë Shoqatë përveç 16 shteteve anëtare të Bashkimit Evropian bëjnë pjesë edhe disa shtete jo anëtare të saj, siç janë: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Turqia, Rusia dhe Norvegjia.



Fig.10. Harta e Brezit të Gjelbër

Kosova përfaqësohet përmes Institutit të Kosovë për Mbrojtjen e Natyrës, si anëtar e rregullt e saj. Ndërsa zonat të cilat përfshinë në kuadër të Brezin e Gjelbër Evropian janë: Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Parku Kombëtar "Sharri", dhe Parku i Natyrës "Pashtriku".

EuroNatura nga Gjermania organizon takimet të rregullta me përfaqësues nga vendet anëtare të saj. Njëherit është angazhuar në zhvillimin e përkufizimit të mundësisë së shtrirjes hapësinore të Brezit të Gjelbër, në kuadër të projektit "Brezi i Gjelbër Evropian si pjesë e Infrastrukturës së Gjelbër". Ky projekt është përkrahur nga Agjencia Federale Gjermani për Konservimin e Natyrës, me fondet e Ministrisë Federale Gjermane për Mjedisin, Konservimin e Natyrës, Ndërtimit dhe Sigurimit Nuklear.

12.7. Bashkëpunimi me Univerzitetin e Konstanzës

Që nga vitin 2015 kur është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Departamenteve të Biologjise të Universitetit të Prishtinës dhe atij të Konstanzës në Gjermani si dhe Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit-AMMK (gjejeni të bashkangjitur) me qëllim të mbledhjes së materialeve shkencore dhe koleksionimin e tyre në Qendrën Kosovare për Edukim dhe Hulumtim Mjedisor në Junik, deri më tani janë realizuar disa aktivitete.

Me iniciativën e Qendrës për Edukim dhe Hulumtim Mjedisor në Kosovë – KEERC ka filluar bashkëpunimi mes Universitetit të Konstanzes në Gjermani, së bashku me Institutitin MaxPlanck për Ornitologji, Uni. të Prishtinës – Departamentit të Biologjisë dhe Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar disa aktivitete me qëllim të hulumtimit dhe inventarizimit të faunës jo vetëm brenda zonave të mbrojtura por edhe jashtë tyre.

Këto aktivitete kishin të bëjnë kryesisht me mbajtjen e tri Shkollave Verore (2015-2017) si kurseve për unazimin e shpendëve të egra. Gjatë këtyre aktiviteteve MMPH-së i janë dorëzuar të dhëna për praninë e shumë llojeve të faunës disa prej tyre ende të pakonfirmuara për Kosovë.

AMMK gjatë kësaj periudhe është munduar t`i mbështes këto aktivitete kryesisht përmes sigurimit të të dhënave si harta, listën e llojeve ekzistuese të faunës, aktivitete të përbashkëta në teren etj.

12.8.1. Shkolla Verore 2015-2017

Në vitin 2015 ka filluar realizimi i Shkollës Verore, një aktivitet i përbashkët dy javorë mes institucioneve të lartëpërmenduara i cili ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016 dhe 2017. Në kuadër të këtij aktiviteti të vazhdueshëm me pjesëmarrje të studentëve kosovarë dhe gjermanë të universiteteve përkatëse janë përparuar / konzervuar një sasi e konsiderueshme e materialit për

kolleksionin zoologjik dhe është filluar përgatitja e një databaze të faunës ku deri më tani janë evidentuar mbi 1000 gjetje të llojeve të ndrshme të kurrizorëve (veçanërisht zvarranikë, amfibe dhe peshqi) dhe jovertebrorë (veçanërisht Lepidoptera, Saltatoria, Coleoptera, Hymenoptera, Gastropoda, Crustacea, Arachnida etj).



Foto 88. Punë në terren

12.8.2. Unazimi i Shpendëve

Me iniciativën e Qendrës për Edukim dhe Hulumtim Mjedisor ne Kosovë - KEERC, ekspert të Institutit MaxPlanck për Ornitologji nga Gjermania në bashkëpunim me Universitetin e Konstantes në Gjermani, Universitetin e Prishtinës - Fakultetin e Shkencave Matmatike - Natyrore dhe me Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës për herë të parë në Kosove kanë realizuar trajnimin për unazimin e shpendëve të egra dhe hulumtimin e lakuriqëve.

Ky kurs, i realizuar gjatë vitit 2016 dhe 2017, kishte për qëllim të jepte një hyrje në teknikën e unazimit të shpendëve, metodën e zënies së shpendëve dhe lakuriqëve, unazimin e shpendëve si dhe përcjelljen e shtegëtimit të kafshëve të egra. Në këtë trajnim kishte përfaqësues jo vetëm nga Kosova por edhe nga shtetet fqinjë si Shqipëria dhe Maqedonia dhe ishte e dedikuar si për amatorë ashtu edhe profesionistë. Gjithsej gjatë vitit 2016-2017, për herë të parë tek ne janë unazuar 55 individ të zogjve me ç`rast u janë vendosur unazat e sjella nga Instituti Max Planck meqenëse Kosova ende nuk posedon kodin e saj kombëtar për unazim të shtazëve të egra por mendohet që shumë shpejt do të fillojnë procedurat për certifikim me këtë kod nga Unioni Evropian për Unazim -EURING.

Gjatë këtyre aktiviteteve me sukses është realizuar puna praktike në unazimin e tetë lejlekëve (Ciconia ciconia) si dhe vendosjen e pajisjeve (GPS) për përcjelljen e lëvizjeve te tyre - migrimin në pesë individ të këtij lloji i cili gëzon status të mbrojtjes kombëtare. Gjatë përcjelljes së këtyre individëve është konstatuar rruga e shtegëtimit të lejlekëve nga Kosova (Shtator) e cila shkon

përmes Bosforit deri në Afrikë ku lejlekët e kalojnë periudhën e dimrit për tu kthyer sërish (Mars) në po të njejtën rrugë. Lokalitetet në të cilat është realizua ky aktivitet janë kryesisht përgjatë pellgut të lumit Sitnica, që njihet për në numër të konsiderueshëm të foleve të lejlekëve.



Foto 89. Unazimi i llojeve të ndryshme të shpendëve të egër

12.8. Projekti i Zonës së Pyjeve të Ahut të Vjetër

"Ahu i vjetër - Trashëgimi Botërore"

Në vitin 2007, pyjet e ahut të vjetër të Karpateve, në Sllovaki dhe Ukrainë, janë përfshirë si pjesë e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-së, kurse në vitin 2011 kjo trashëgimi botërore është zgjeruar edhe me "Pyjet e Ahut Antik të Gjermanisë". Gjatë fazës së zgjerimit Komiteti i Trashëgimisë Botërore ka rekomanduar fazën e ardhshme në këtë proces. Pas kësaj janë organizuar tri takime, fillimisht me ekspertët dhe mandej takimet në nivel qeveritar dhe kombëtar, me qëllimi që ky projekt të vazhdojë tutje, në mënyrë që të identifikohen edhe zonat me pyje të ahut të vjetër në regjionet tjera të Evropës dhe botës. Gjermania ka filluar procesin e shqyrtimit të mëtejshëm në hulumtimin dhe zhvillimin e projektit, për të vlerësuar potencialin, për emërtimin e Trashëgimisë Botërore në Evropë.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është përfshirë në këtë projekt që nga muaji prill i vitit 2014, kur në Vjenë, është organizuar takimi i nivelit të ekspertëve, për të identifikuar zonat potenciale të pyjeve të ahut të vjetër në Evropë. Në takim morën pjesë pjesëmarrësit nga nivelet dhe organizatat e ndryshme, prej 20 shteteve dhe janë prezantuar gjithsejtë 37 projekte. Kosova është prezantuar me zonën e pyjeve të ahut të vjetër në kuadër të PK "Bjeshkët e Nemuna".



Foto 90. Nga takimi i Nivelit Kombëtar në Ministrin e Mjedisit, Bon

Në regjionin e katër Moesian-Balcanic, bëjnë pjesë këto shtete: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Greqia dhe Bullgaria. Kriteret e përdorura për procedurat e emërtimit të Trashëgimisë Botërore janë: zona buferike, madhësia, mosha dhe koha jashtë përdorimit të pyjeve. Ndërsa procedurat e hyrjes në Trashëgiminë Botërore të UNESCO-së përfshijnë përcaktimin e vlerave përgjithësisht të shquara.

12.10. Ekspeditë Hulumtuese Speleologjike

Gjatë vitit (2017) Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me Shoqatën Speleologjie të Bullgarisë kanë realizuar ekspeditën hulumtuese në terrenet gëlqerorë në Malin Akovan në fshatin Zatriq të komunës së Rahovecin. Gjatë kësaj ekspeditë janë hulumtuar 5 shpellat si: Shpella e Peshterrit, Shpella e Bali Agës, Shpella e Plumbave, Shpella e Mbretëreshës se Bardhë dhe Shpella e Banuar (Gërgavica) po ashtu janë përgatitur edhe profilet e secilës nga shpellat e hulumtuara.



Foto 91 Ekspedita hulumtuese Speleologjike

13. MASAT E NDERMARRA PËR MBROJTJEN E NATYRËS

13.1. Inspektimi i Zonave të Mbrojtura

Gjatë periudhës 2015-2017 Inspektorati i MMPH-së, ka inspektuar një numër te madh të ndërhyrjeve që janë zhvilluat në zonat e mbrojtura dhe janë proceduar sipas ligjeve në fuqi. Në mungesë të dhënave për vitet 2015/2017 në tabelën nr. 9, janë prezantuar inspektimet (gusht – dhjetor 2017).

Tab. 9. Zonat e Inspektuara gjatë vitit 2017

Nr.	Zona e Mbrojtur/operatori	Komuna	Lloji i Aktiviteteve	Vendimi
1	PK "Bjeshkët e Nemuna"	Pejë	Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës "Milishevc-Lumbardhë"	Urdhëresë për t'u pajisur me pëlqim mjedisor.
2	MNRV "Ujëvarat e Mirushës"	Malishevë	Ndërtimi i rrugës "Llapqevë - Ujëvarat e Mirushës"	Urdhëresë për t'u pajisur me pëlqim mjedisor.
3	"Ajani" Sh.p.k	Shtërpcë	Shfrytëzues i gurit gëlqeror në lokacionin: Izhancë, Shtërpcë (paraqitja e elementeve për "Shpellë Mermeri" në gëlqeroret në këtë lokacion)	Ndërprerje e aktivitetit te operimeve deri sa është bërë vlerësimin nga Institucionet relevante si: MMPH, KPMM, MZHE dhe të cilat kanë konstatuar se nuk ka elemente të mjaftueshme për tu shpallur "Shpellë Mermeri".
4	Ura e Fshajtë	Gjakovë Rahovec	Gërmim terreni afër Urës së Fshajtë (supozohet për qellim ndërtimi)	Është shirituar vendi - terreni i gërmuar dhe është urdhëruar Inspektorati komunal i K. Gjakovës që të përcjell gjendjen.
5	PK "Bjeshkët e Nemuna"	Pejë	Asfaltimi i rrugëve Maja e zezë - Peklenë - Shtupeq i Vogël dhe Shtupeq i Madh - Rugovë. Nga komuna e Pejës.	Ndalim/urdhëresë e ndërprerjeve të punimeve dhe urdhëresë për t'u pajisur me pëlqim mjedisor.
	OIQ "Shqiponja" Kopsht zoologjik	Prizren	Kopshtit zoologjik, mbajtja e shtazëve te egra vendore ose të huaja në internim.	Është urdhëruar qe të aplikoj për leje për mbajtjen e shtazëve në internim dhe shfaqjen e tyre për publikun.

Burimi: Inspektorati i MMPH-së

13.2. Procedurat kundërvajtës në fushën e mbrojtjes së natyrës 2015-2017

Në periudhën 2015-2017 në sektorin e mbrojtjes së natyrës në kuadër të kërkesave për fillimin e procedurave kundërvajtës të bazuara në Ligjin e Natyrës dhe Ligjit për Parqe Kombëtare si dhe legjislacionin relevant, AMMK/ Drejtoritë për Administrimin e Parqeve Kombëtare, ka parashtruar gjithsejtë: 460 Kallëzime penale; 84 Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse; dhe 3 Kërkesa për inicimin e propozim padive për kontest civil.

Përmes inicimit të këtyre 547 procedurave pretendohet realizimi i dëmit në vlerë totale prej 1.251.592 € për institucionin të shkaktuar përmes veprave të kundërligjshme nga persona të pandërgjegjshëm (tabela).

Tabela 10. Inicimet e procedurave kundërvajtës në fushën e mbrojtjes së natyrës 2015-2017

	Kallëzime penale		Kërkesa për fillimin e procedurës civile		Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtësve	
	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit në €	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit në €	Numri i lëndëve	Shuma e dëmit në €
2015	148	367280	1	48356	63	56056
2016	83	192616	1	68466	6	1332
2017	229	441364	1	62355	15	15765
Gjithsej të	460	1001260	3	177179	84	73153

Burimi: AMMK

13.3. Rajonet BIO-GJEOGRAFIKE

